



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë

**Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit
në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”**

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Evis Trandafili
2. Dr. Elva Leka

Evis Trandafili
ELVA LEKA

Mars / 2025

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”

1	IAL aplikues:	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Informatikës së Biznesit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMAS Nr. 584, datë 04.10.2022
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike/4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	14 PAE / 1 PAK v.a. 2023-2024 11 PAE / 1 PAK v.a. 2022-2023
18	Numri i studentëve:	91 studentë v.a. 2023-2024 96 studentë v.a. 2022-2023
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, (UMSH) është një Institucion jopublik i Arsimit të Lartë liçencuar me VKM Nr. 177, datë 19.02.2009 e emertimin "Shkolla e lartë private mesdhetare e shqipërisë". UMSH është riorganizuar me Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 268, datë 16.05.2022 dhe është riakredituar për herë të fundit me Akreditim të pjesshem me Vendim BA Nr.54, datë 13.01.2024 me afat vlefshmërie deri me 17/12/2026.

UMSH përbëhet nga katër njësi kryesore:

- Fakulteti i Shkencave Ekonomike;
- Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane;
- Fakulteti i Informatikës;
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore.

Fakulteti i Informatikës, njësi kryesore ku ky program studimi ofrohet, është i përbërë nga tre njësi bazë, përkatësisht:

- Departamenti i Informatikës së Biznesit;
- Departamenti i Teknologjisë së Informacionit;
- Qendër Kërkimore: Qendra e Inovacionit dhe Teknologjive Digjitale.

Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Informatikë me profile a) Inxhinieri Software b) Sisteme Informacioni në Biznes" ofrohet nga Departamenti i Informatikës së Biznesit, Fakulteti i Informatikës (FI), në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë (UMSH).

Hapja e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Informatikë me profile a) Inxhinieri Software b) Sisteme Informacioni në Biznes" është miratuar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë Nr. 352, datë 17.09.2021, pasi ka kaluar të gjitha fazat e propozimeve dhe miratimit brenda Institucionit.

Programi i studimit është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nevojat e tregut rajonal për specialistë në fushën e Informatikës, Inxhinierise Software dhe Sistemeve të Informacionit.

Ky program realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Master i Shkencave" në "Informatikë me profile a. Inxhinieri Software b. Sisteme Informacioni në Biznes" në Fakultetin e Informatikës, të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Programi i studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Informatikë me profile a. Inxhinieri Software b. Sisteme Informacioni në Biznes", është ofruar për herë të parë në vitin akademik 2022 – 2023. Në vitin akademik 2022 – 2023 në Programin MSc Informatikë me Profile: Sistemet e Informacionit në Biznes janë regjistruar 51 studentë për herë të parë, ndërsa në vitin akademik 2023 – 2024, 30 studentë. Ndërsa në Programin MSc Informatikë me Profile: Inxhinieri Software, në vitin 2022-2023 janë regjistruar 40 studentë, ndërsa në vitin 2023-2024, 66 studentë.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Mbështetur në VKM nr.109/2017, ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit të jashtëm, për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Informatikë me profile “Inxhinieri Software” dhe “Sisteme Informacioni në Biznes”. Bazuar në Urdhër nr 98, datë 30.09.2024 për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programit të studimit, aplikuar nga Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”, grupi i vlerësimit përbëhet nga:

- Prof. Asoc. Evis Trandafili
- Dr. Elva Leka

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, Msc. Muhamed Prezja. Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i hartuar nga vetë institucioni. Raporti siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH) për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. UMSH po ashtu, vuri në dispozicion të GVJ një numër dokumentesh shtesë në plotësim e përditësim të elementëve të paraqitur të RVB, dokumentacioni i paraqitur edhe në sistemin AMS të ASCAL. Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 “Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, VKM Nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, në Udhëzimin Nr. 31 datë 29.12.2017 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. Gjatë vizitës së kryer në institucion, në datat 31 Tetor dhe 1 Nëntor 2024, u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, Fakulteti i Informatikës, Departamenti i Informatikës së Biznesit. Këto takime u shoqëruan me diskutime intensive dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi. GVJ u ndal në detaje të funksionimit të Sekretarisë Mësimore si dhe në detaje të administrimit të procesit mësimor. GVJ vizitoi me përparësi lehtësitë për studentët si sallat e internetit dhe të kompjuterëve, bibliotekën, mjediset e studimeve, laboratorët etj. U zhvilluan bashkëbisedime me një grup studentësh duke u njohur me mendimin e tyre për një sërë çështjesh në lidhje me mësimdhënien dhe aspektet e tjera të jetës studentore. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet e ndryshme që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave. Në fund të raportit ekspertët kanë hartuar disa rekomandime, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit.

Me datë 04.03.2025, GVJ dërgojë nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL draft raportin për programin e studimit Msc në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”. Pasi Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë u njoh me përmbajtjen e draft raportit dhe me datë 11.03.2025, dërgojë komentet e saj në lidhje me draftin si dhe një sërë evidencash për të



provuar gjetjet e saj. GVJ thekson se draft-raporti është hartuar duke u bazuar tek dokumentacioni i ngarkuar në sistem dhe tek ai i kërkuar nga ne. GVJ shprehet s më poshtë në lidhje me komentet e IAL-së:

1. Në *Standardin II.3*, GVJ ka vlerësuar në tërësi nëse programi është i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të tij.

Në *Kriterin 4, Standardi II.3*, GVJ ka vlerësuar paraqitjen e informacioneve të nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar.

GVJ vlerëson punën e stafit akademik të FI. Konkretisht, gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi që shumica e orëve mësimore zhvillohen totalisht në sallat e laboratorëve të FI duke përcjellë tek studentët kompetenca praktike shumë të rëndësishme për tipologjinë e këtij programi studimi. Megjithatë, sipas vlerësimit përkatës të bërë në *Kriterin 4, Standardi II.3*, GVJ nuk gjen të reflektuar në syllabuset e lëndëve dhe në planin mësimor kredite/orë të dedikuara për laboratorët dhe detyrat e kursit. Gjithashtu, konstatohet që në syllabuset e lëndëve në sesionin “Forma e vlerësimit të dijeve”, detyrat e kursit janë pjesë e vlerësimit përfundimtar të lëndës, por ky komponent formues nuk është i parashikuar në planin mësimor të programit. Rekomandimi i GVJ lidhet me saktësimin e komponentëve formues dhe unifikimin e tyre në planin mësimor dhe në syllabuset e lëndëve.

Për sa më sipër, vlerësimi i standardit II.3 **nuk ndryshon**.

2. Në *Standardin II.4*, GVJ ka vlerësuar në tërësi strukturën dhe organizimin e programit të studimit, përputhjen me objektivat formuese, rezultateve të të nxënës, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve

Sipas vlerësimit përkatës të bërë në *Kriterin 5, Standardi II.4*, GVJ nuk gjen të reflektuar në syllabuset e lëndëve përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit apo evidencë nga planifikimi i buxhetit për pasurimin e literaturës. GVJ vlerëson dakordësimin nga ana e institucionit dhe gatishmërinë institucionale për përditësimin e literaturës.

Për sa më sipër, vlerësimi i standardit II.4 **nuk ndryshon**.

3. Në *Standardin IV.3*, GVJ ka vlerësuar në tërësi literaturën në mbështetje të mësimdhënies dhe përdorimin nga studentët dhe aksesueshmërinë e ambienteve të bibliotekës.

Sipas vlerësimit përkatës të bërë në *Kriterin 2, Standardi IV.3*, GVJ nuk gjen të reflektuar në syllabuset e lëndëve përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit apo evidencë nga planifikimi i buxhetit për pasurimin e literaturës.

GVJ vlerëson punën e UMSH mbi informimin e studentëve për shërbimet e ofruara nga Biblioteka nëpërmjet a) pajisjes se studenteve të regjistruar me Udhëzuesit e Studentit b) nga stafi gjatë javës së orientimit. Rekomandimi i GVJ në *Kriterin 3, Standardi IV.3* në lidhje me funksionimin dhe shërbimet e ofruara nga biblioteka dhe ndërthurjen e këtyre shërbimeve në procesin mësimor lidhet

me aksesueshmërinë online të këtij informacioni. Udhëzuesi i Studentit përmban informacion të permblendhur shkurtimisht në lidhje me shërbimet e bibliotekës ndërsa në faqen online të UMSH ky informacion mungon.

Për sa i përket rekomandimit të bërë në *Kriterin 8, Standarti IV.3*, GVJ nuk gjen evidence të raportimit në analizat vjetore të njësisë bazë, asaj kryesore apo institucionale në lidhje me shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online të bibliotekës, pasurimin me literature apo problematika/nevoja të ndryshme.

Për sa më sipër, vlerësimi i Standartit IV.3 **nuk ndryshon**.

4. Në *Standardin V.1*, GVJ ka vlerësuar në tërësi procedurat për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

GVJ, gjatë hartimit të draft raportit të vlerësimit të jashtëm ka konsultuar me kujdes të gjithë informacionin e publikuar online në faqen web institucionale të UMSH (www.umshe.al) dhe ka marrë në konsideratë informacionin e publikuar në rubrikën PRANIMET dhe nënrubrikat Kriteret e Pranimi, Dokumentacioni, Fituesit, Transferimet, Bursat, etj. Megjithatë, rekomandimi lidhet me faktin që ky informacion është i përgjithshëm dhe nuk i referohet kriterëve të pranimi për programin e studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software” sipas përcaktimeve të kriterëve të pranimi në rregulloren e këtij programi studimi.

Për sa më sipër, vlerësimi i Standartit V.1 **nuk ndryshon**.

5. Në *Standardin V.5*, GVJ ka vlerësuar në tërësi procedurat institucionale të UMSH që garantojnë angazhimin e studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese.

GVJ, gjatë vlerësimit të Standartit V.5 ka konsultuar me kujdes rregulloret institucionale të UMSH. Sipas vlerësimit përkatës të bërë në *Kriterin 1, Standardit V.5*, studentët përfaqësohen në Senatin Akademik (*Statuti - Neni 11, Rregullore e organizimit UMSH - Neni 11.2*) dhe kanë të drejtë të organizohen në Këshillat Studentore (*Statuti - Neni 83, Rregullore e organizimit UMSH - Neni 59*). GVJ vlerëson vëmendjen që UMSH i kushton përfshirjes së studentëve në organet vendimmarrëse dhe komunikimit të ndërsjelltë shumë të mirë student-institucion gjë që u konstatua edhe gjatë vizitës në UMSH në takimin me studentët. Bazuar në kuadrin rregullator të UMSH, studentët përfaqësohen në Senatin Akademik, Këshillat Studentore dhe Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, në lidhje me të cilat gjendet informacion edhe në faqen zyrtare ëeb të UMSH.

Megjithatë, pavarësisht se në Rregulloren e NJSBCZHK parashikohet përfshirja e një anëtari nga radhët e studentëve, në Rregulloren e Organizimit të UMSH, NJSBCZHK përbëhet vetëm nga përfaqësues të Njësisë Kryesore, dhe nuk rezulton përfaqësim i studentëve. Gjithashtu, sipas

akteve rregullatore të institucionit, përfaqësimi i studentëve nuk përcaktohet as për Këshillin e Etikës.

Megjithatë, nga ana e institucionit vërehet një nivel i lartë përgjegjshmërie në lidhje me përfaqësimin e studentëve në instancat vendimarrëse institucionale dhe mbështetje konkrete të Këshillave Studentore. Kjo vërehet në plotësimin e një pjese të konsiderueshme të Kriterit 1, Standardit V.5.

GVJ pasi shqyrtoi edhe herë materialet e DVV dhe duke konsideruar që mangësitë e gjetura në aktet rregullatore nuk reflektojnë punën reale, me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme të bërë nga institucioni në mbështetje të studentëve/

Nga sa më sipër dhe për të qënë sa më objektivë ndaj realitetit, GVJ mendon që vlerësimi i ‘*Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre*’ **ndryshon** nga ‘*Përmbushet Kryesisht*’ në ‘*Përmbushet Plotësisht*’.

6. Në *Standardin V.6*, GVJ ka vlerësuar në tërësi procedurat institucionale të UMSH për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve. Për vlerësim objektiv të standardit, GVJ ka konsultuar organigramën e miratuar të institucionit dhe rregulloret përkatëse. Konkretisht, zyra Alumni që përmendet në objeksionin/sqarimin e UMSH nuk gjendet e parashikuar në organigramën e institucionit. Konstatohet që sipas Rregullores së Zyrës së Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës (ZKSK) është kjo e fundit që mban të dhëna për punësimet pas diplomimit dhe informimin e studentëve. GVJ, konstaton që ZKSK dhe Sekretaria mësimore kanë një rol të rëndësishëm në informimin e studentëve. Për sa më sipër, vlerësimi i detajuar gjendet në *Kriterin 1, Standardi V.6*.

GVJ gjykon që vlerësimi për *Kriterin 1* **nuk ndryshon**.

Objeksioni/Sqarimi tjetër në lidhje me këtë standard lidhet me *Kriterin 4*, ku jepet vlerësimi në lidhje me Zyrën e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës (ZKSK) në ndjek studentët pas diplomimit lidhje me ndjekjen e studentëve pas diplomimit. Për këtë program studimi, nuk ka ende të dhëna të punësimit nga ndjekja e studentëve pas diplomimit meqënëse ky program sapo ka diplomuar brezin e parë të studentëve. Për vlerësimin e këtij kriteri, GVJ është bazuar në anën procedurale, kompetencat dhe detyrat e ZKSK. GVJ konsultoi rregulloren e ZKSK dhe konstatoi që fokusi kryesor i ZKSK është informimi i studentëve aktuale. GVJ i qëndron rekomandimit të saj në lidhje me përditësimin e Rregullores së ZKSK me objektiva dhe detyra të reja në lidhje me ndjekjen e studentëve pas diplomimit, mbledhjen, përpunimin dhe mbledhjen e të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të këtij programi studimi dhe në përgjithësi të programeve të studimit që ofron UMSH.

Për sa më sipër, vlerësimi për *Standardin V.6* **nuk ndryshon**.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”.

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Në përputhje me Statutin e tij, Kodin e Etikës, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH), ka mision të përgatisë profesionistë dhe qytetarë aktivë për shoqërinë demokratike shqiptare dhe për vlerat europiane. UMSH realizon misionin e tij përmes zhvillimit të arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë, në shërbim të lirisë dhe diversitetit të ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit ligjor, për rritjen e mirëqënies dhe dinjitetit njerëzor, të realizuara me veprimtari të ligjshme dhe transparente. <i>Evidenca Nr 1: Statuti i UMSH</i> <i>Evidenca Nr 3: Plani i zhvillimit strategjik te UMSH</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i Studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software” është mbështetur dhe hartuar në përputhje me misionin e UMSH për të formuar specialistë të lartë dhe përgatitur shkencëtarë të rinj, Planin e Zhvillimit Strategjik të UMSH, përmes të cilës, në kuadër të interesit rajonal, UMSH, synon, ndër të tjera, përgatitjen e individëve të mirëkualifikuar, produktivë, të orientuar drejt kërkimit shkencor dhe të hapur ndaj sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare si edhe Strategjinë e Zhvillimit të Programit të studimit, për të zhvilluar aftësi e kompetenca teorike & praktike në fushën e Informatikës dhe Ekonomisë. <i>Evidenca Nr 1: Statuti i UMSH</i> <i>Evidenca Nr 3: Plani i zhvillimit strategjik te UMSH</i> <i>Evidenca Nr 4: Strategjia e zhvillimit te programit</i>

Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit.	Programi i Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software” është mbështetur dhe hartuar në përputhje me Planin e Zhvillimit Strategjik të institucionit dhe në përputhje me strategjinë e programit, duke qenë një vazhdim i suksesshëm i programeve <i>Bachelor</i> në fushën e informatikës dhe/ose ekonomisë. Ky program studimi është zhvilluar në bazë të nevojave të tregut të punës dhe në përputhje të plotë me Vendimin e Këshillit të Ministravë nr.41, date 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar. Studentët e këtij programi studimi janë të përgatitur profesionalisht për të plotësuar nevojat e tregut të punës për: koordinator IT, konsulent sistemi, analist biznesi, zhvillues sofueri, menaxher projektsh, analist i sistemeve te bazave te te dhënave etj., duke qenë në përputhje të plotë me fushat e drejtimet akademike të institucionit. <i>Evidenca Nr 3: Plani i zhvillimit strategjik te UMSH</i> <i>Evidenca Nr 4: Strategjia e zhvillimit te programit</i> <i>Evidenca Nr 5: Rregullore e Fakultetit te Informatikes</i> <i>Evidenca Nr 24: Analiza e tregut te punes</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi i Studimeve Master i Shkencave në “Informatikë me profile a) Inxhinieri Software b) Sisteme Informacioni në Biznes” kontribon në përmbushjen e objektivave dhe interesave kombëtarë në përputhje me prioritetet SKZHIE 2030, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacioniet (SKSTI 2020), me Strategjinë e Inovacionit dhe Teknologjisë me Biznesin (BITS), me Strategjinë për TIK (miratuar me Vendim KM Nr. 2016, datë 10.04. 2003. Ky program është hartuar në përputhje me këto strategji. <i>Evidenca Nr 3: Plani i zhvillimit strategjik te UMSH</i> <i>Evidenca Nr 4: Strategjia e zhvillimit te programit</i> <i>Evidenca Nr 47: Strategjia e nderkombetarizimit</i>
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software” ofrohet nga Departamenti të Informatikës së Biznesit, si pjesë e Fakultetit të Informatikës në përputhje me interesat kombëtare, me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe me</i>

	<i>fushën e veprimtarisë së tij akademike dhe profesionale. Studentët e këtij programi studimi janë të përgatitur profesionalisht për të plotësuar nevojat e tregut të punës në shumë nënfusha të informatikës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësive kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”, në hapjen e tij në vitin 2016, ofrohet nga DIFSH, pjesë e FSHE me emërtimin Master i Shkencave në “Sistemet e Informacionit në Biznes”. Prej datës 4 Tetor 2022 pas riorganizimit të Fakultetit të Informatikës, në përputhje me planin strategjik të UMSH, dhe pas Urdhërit MAS nr. 584, Nr. Prot. 1737/3, ky program mban emëtimin e ri të tij dhe ofrohet nga Departamenti i Informatikës së Biznesit, si pjesë e Fakultetit të Informatikës. Stafi akademik i angazhuar në programin e studimit Master i Shkencave në “Informatikë me profile a) Inxhinieri Software b) Sisteme Informacioni në Biznes”, ka përvojën dhe kualifikimin e duhur për ofrimin e tij. Gjatë vitit akademik 2023 – 2024, Departamenti i Informatikës së Biznesit, si pjesë e Fakultetit të Informatikës ka në përbërje të tij 10 personel akademik efektiv (PAE) nga ku: - 1 Prof. Dr; - 0 Prof. Asoc; - 3 Dr; - 5 Dr. Proc; - 1 MSc; 5 personel akademik me kontratë (PAK) nga ku: - 1 Prof. Dr;

	- 0 Prof. Asoc. Dr; - 0 Dr; - 2 Dr. Proc.; - 2 MSc; 1 personel ndihmës akademik. Departamenti i Informatikës së Biznesit disponon, në funksion të programeve të studimit që ofron, laboratorë bashkëkohorë përmes të cilëve, studentët realizojnë orët praktike në përputhje me programin e studimit dhe nevojat për aftësimin praktik të tyre. Nga vizita në Institucion dhe takimi me stafin akademik PAE dhe PAK, GVJ vlerëson faktin që institucioni mbështet stafin akademik për rritje profesionale, pjesëmarrje në konferenca, publikime në revista shkencore. <i>Evidenca Nr 10: Permbledhese e tabelave per programin</i> <i>Evideca Nr 25: Urdheri per riorganizmin e Programit Master Shkencor ne Informatike me Profile</i> <i>Dokumenta shtese: Evidence Inventari per infrastrukturen e laboratoreve qe mbeshtetin kete program studimi</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software” ofrohet nga <i>Departamenti i Informatikës së Biznesit</i> si pjesë e Fakultetit të Informatikës, në përputhje me fushën e përgjithshme dhe specifike të tij. Fusha e studimit të programit “Informatikë me profile a) Inxhinieri Software b) Sisteme Informacioni në Biznes” është në përputhje akademike dhe kërkimore me programin e studimit <i>Bachelor</i> në “Shkenca Kompjuterike” të ofruar në departament. Kodifikimi i lëndëve, në zbatim të VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 dhe Urdhër të MAS Nr. 31 datë 15.11.2022, është në proces. Nga evidencat e vendosura në dispozicion, institucioni ka hartuar planin e kodifikimit të programeve si më poshtë: - Kodifikimi 0613 - për Programin e studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Informatikë me profil Inxhinieri Software”, ku 06 specifikon fushën e gjerë (Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit) dhe 0613 – fusha e ngushtë (Zhvillimi dhe analiza e software-ve dhe aplikacioneve)

EVA

[Signature]

	- Kodifikimi 0688 - për Programin e studimit <i>Master i Shkencave</i> në “Informatikë me profil Sistemet e Informacionit në Biznes”, ku 06 specifikon fushën e gjerë (Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit) dhe 0688 – fusha e ngushtë (Programet dhe kualifikimet ndërdisiplinore, që përfshijnë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit). <i>RVB, Mendimi Dekanit, Shkresa Percjellese</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software” ofruar nga Departamenti i Informatikës së Biznesit (DIB), si pjesë e Fakultetit të Informatikës (FI) është një program, i cili i shtohet ofertës akademike pranë këtij fakulteti. Fakulteti i Informatikës përbëhet nga: 1. Departamenti i Informatikës së Biznesit 2. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit 3. Qendra e Inovacionit dhe Teknologjive Digjitale Programi është në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë duke ofruar një qasje ndërdisiplinore të shkencave kompjuterike. <i>Evidenca Nr 9: Rregullore e organizimit UMSH</i> <i>Evidenca Nr 3: Plani i zhvillimit strategjik te UMSH</i>
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohehet nga institucionet partnere.	Nuk aplikohet.
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Programi <i>Master i Shkencave</i> në “Informatikë me profile a) Inxhinieri Software b) Sisteme Informacioni në Biznes, bazuar në strategjinë e tij, është i angazhuar të ofrojë trajnime profesionale të mëtijshme, orë të hapura me ekspertë të tregut të punës, workshop-e, për studentët e diplomuar, duke i përditësuar studentët me njoftime të ndryshme nga tregu i punës dhe praktikave profesionale. UMSH ka marrëveshje bashkëpunimi

	me kompani të ndryshme si: Deloitte Audit, Digitalb, Deloitte Legal, Alpha Bank, Raiffesen Bank, Tirana Bank etj. <i>Evidenca Nr 11: Liste e marreveshjeve te bashkepunimit</i> <i>Dokumenta shtese: Model marreveshje bashkepunimi me kompani institucione</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se institucioni ka përvojën, kapacitet dhe burimet e duhura për realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”. Nga fushat e kërkimit shkencor, workshopeve e trajnimeve profesionale të zhvilluara, programi i studimit demonstroi se është në përputhje me fushën akademike të Departamentit të Informatikës si Biznesit si pjesë e Fakultetit të Informatikës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Organizimi i programit të studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software” realizohet nga Departamenti Informatikës së Biznesit, Fakulteti i Informatikës, mbështetur në rregulloren e Organizimit të Universitetit Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, Statutin e UMSH, Rregulloren e Fakultetit të Informatikës, Rregulloren e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK), si dhe të gjithë aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Angazhimi i personelit akademik me kohë të plotë, personelit akademik nga fakultete të tjera të UMSH, si dhe angazhimi i personelit akademik me kontratë bazohet në marrjen

	e përgjegjësiwe respektive dhe vlerësimin e vazhdueshëm të punës së tyre. Marrëdhënia midis strukturave të ndryshme brenda UMSH, njësiwe të ndryshme administrative dhe akademike rregullohet përmes rregullores së brendshme të Institucionit. Analizat e vazhdueshme të punës së stafit akademik dhe administrativ e realizuar nga Institucioni, tregojnë rezultate shumë të kënaqshme referuar rezultateve të mbledhura nga analiza e formularëve të vlerësimit të lëndëve, analiza e strukturës së cilësisë së provimit si edhe procesin e vlerësimit të kurrikulës apo përgatitjen e raporteve të vetëvlerësimit të programeve. <i>Evidenca Nr 9: Rregullore e Organizimit UMSH</i> <i>Evidenca Nr 1: Statuti i UMSH</i> <i>Evidenca Nr 5: Rregullore e Fakultetit të Informatikës</i> <i>Evidenca Nr 15: Rregullore e NJSBCZHK.pdf</i> <i>Evidenca Nr 32: Formulari i vlerësimit të pedagogut dhe lëndes nga studenti</i> <i>Evidenca Nr 33: Formulari i vlerësimit të pedagogut nga autoriteti drejtues</i> <i>Dokumenta shtesë:</i> <i>Analiza mesimore kerkimore e njesisë baze përgjegjëse për programin e studimit</i> <i>Plani i veprimit të miratuar për përmbushjen e rekomandimeve që dalin nga rezultatet e pyetësoreve</i> <i>Raport përmbledhës nga NJSBC i rezultateve të pyetësoreve</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Për realizimin e objektivave të programit të studimit, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH) ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucionesh homologe vendase dhe të huaja si: The headhunter Shpk, Inter-Office Shpk, Infosoft Group Shpk, Alpha Bank, Unit System, CodeIT, Raiffeisen Bank, Tirana Bank, Deloitte Albania Shpk, Intesa SanPaolo Bank Unit System, Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, Universiteti “Eqerm Cabej”, Universita di Bologna, Universita Della Calabria (Italy), Fon University Skopje (Maqedonia e Veriut), University of NIS (Serbia), Sigmund Freud University of Paris (France), Dimitrie

	Cantemir Christian University (Romania) etj., të cilat mundësojnë shkëmbimin e stafit dhe studentëve. UMSH ka hartuar një strategji ndërkombëtarizimi sipas së cilës ka përcaktuar si prioritare: - Promovimin e mobilitetit ndërkombëtar në hyrje dhe në dalje të gjithë studentëve dhe pedagogëve, kërkuesve shkencor; - Zhvillimin e partneriteteve ndërkombëtare në kërkim, mësimdhënie formim dhe administrim; - Nxitje në realizimin e stazheve dhe qëndrimit kohor në koto vende, falë edhe programit europian Erasmus+; - Vendosjen e një politike aktive të komunikimit ndërkombëtar; - Ndihmë në përmirësimin e kapaciteteve të organizmit, të formimit dhe kërkimit të universiteteve partnere, në vecanti atyre të rajonit. <i>Evidenca Nr 11: Liste e marreveshjeve te bashkepunimit</i> <i>Evidenca Nr 10: Permbledhese e tabelave per programin</i> <i>Evidenca Nr 16: Liste e mobiliteti i stafit akademik</i> <i>Evidenca Nr 47: Strategjia e nderkombetarizimit</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale, Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me ente, të cilat zhvillojnë aktivitetin e tyre në drejtim të Sisteme informacioni në Biznes dhe Inxhinieri Software si: Infosoft Group Shpk, Alpha Bank, Unit System, CodeIT, Deloitte Shpk etj. Departamenti i Informatikës së Biznesit, Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës (ZKSK) në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë ofrojnë politika bashkëpunimi dhe marrëveshje partneriteti në funksion të Programit <i>Master i Shkencave</i> në “Informatikë me profile a) Inxhinieri Software b) Sisteme Informacioni në Biznes”. Në kuadër të këtyre bashkëpunimeve janë kryer edhe mobilitete të stafit akademik apo studentëve në institucione të huaja si: Rzeszow University, Jagellonian University, Wraclaw University në Poloni; Lithuania Business University of Applied Sciences në Lituani, Univesity of Salento, Univerisity of Tuscia, University of L’acquila në Itali; Instituto Politecnico de Braganca në Portugali; Panteion University në Greqi; si edhe në

	disa universitete në shtete të tjera si Bullgari, Turqi, Estoni, Spanjë etj. <i>Evidenca Nr 11: Liste e Marreveshjeve te Bashkepunimit</i> <i>Evidenca Nr 16: Liste e mobiliteti i stafit akademik</i> <i>Evidenca Nr 27: Procedura per perzgjedhjen e studenteve dhe stafit ne programin Erasmus</i> <u>Dokumenta shtese:</u> <i>Lista e marreveshjeve me kompanite ku studentet e ketij programi realizojne praktiken mesimore</i> <i>Model marreveshje bashkepunimi me kompani institucione</i> <i>Nje raport ne lidhje me perfitimet nga bashkepunimet per praktikat profesionale</i> <i>Procedure per mobilitet Erasmus nga studente te ketij programi studimi</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Departamenti i Informatikës së Biznesit kujdeset për krijimin e mundësive për zhvillimin korrekt të praktikave profesionale për të gjithë studentët e tij, në përputhje me programin e studimit të ofruar. Për të analizuar arritjet dhe për të përcaktuar objektivat, kryhen raporte vjetore të realizuara nga Departamenti dhe Raporte Vjetore Institucionale, të realizuar nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC). Raportet hartohen bazuar ne 4 vlerësime: 1. Vlerësimi praktikës mësimore të studentit nga personi përgjegjës në institucion 2. Vlerësimi i praktikës nga pedagogu përgjegjës 3. Vlerësimi i performancës së studentit pranë institucionit ku ai ka kryer praktikën 4. Vlerësimi i raportit final të cilin studenti dorëzon në përfundim të praktikës. Departamenti ka hartuar gjithashtu një raport në lidhje me përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit dhe praktikave profesionale, ku theksohet: - Rritja e mundësive për të rritur aftësi profesionale, duke forcuar lidhjet e universitetit me industrinë (Deloitte Albania, Raiffeisen, AKSHI;

	- Rritja e “networkut”, ku disa prej studentëve kanë mundësi edhe të punësohen pranë institucioneve në të cilat zhvillojnë praktikën profesionale; - Ofrimi i Trajnimeve dhe organizimi i workshopeve në bashkëpunim me keto institucione. <i>Evidenca Nr 17: Lista e pedagogeve qe monitorojne praktikat profesionale</i> <i>Evidenca Nr 19: Format i shperndarjes se studenteve praktikante ne institucione</i> <i>Evidenca Nr 2: Raport vjetor i UMSH</i> <i>Dokumenta Shtese:</i> <i>Raport permbledhes nga NJSBC i rezultateve te pyetesoreve</i> <i>Nje raport ne lidhje me perfitimet nga bashkepunimet per praktikat profesionale</i>			
Konkluzione	<i>GVJ, nisur nga DVV dhe nga vizita në Institucion, konstaton që UMSH ka marrëveshje bashkëpunimi me Institucione të ndryshme të Arsimit të Lartë brenda dhe jashtë vendit, të cilat mundësojnë shkëmbimin e stafit dhe studentëve, aplikimin në projekte të përbashkëta dhe implementimin me sukses të projekteve të fituara.</i> <i>Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë falë bashkëpunimeve me ente vendase mundëson zhvillimin korrekt të praktikave profesionale të studentëve, në përputhje me profilin e studimeve të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																					
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”, i ofruar nga Departamenti i Informatikës së Biznesit pranë Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program realizohet me ndjekje të mësimit me kohë të plotë, me një kohëzgjatje 2 vjet të ndarë në katër semestra, në përfundim të të cilave studenti fiton 120 kredite. Në planin mësimor paraqitet shpërndarja e lëndëve sipas semestrave, dhe krediteve përkatëse të lëndëve, ku secila lëndë ka të përcaktuara orë mësimore në auditor dhe orë të pavarura. Çdo lëndë i është caktuar numri i duhur i krediteve ECTS në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar. <table><tr><th>Tipi veprimtarise</th><th>Tipi i Aktivitetit</th><th>Nr. i ECTS</th></tr><tr><td>A</td><td>Aktivitete në disiplina të formimit të përgjithshëm</td><td>12 ECTS</td></tr><tr><td>B</td><td>Aktivitete në disiplina të formimit të karakterizuar</td><td>60 ECTS</td></tr><tr><td>C</td><td>Aktivitete në disiplina ndërdisiplinore dhe intriguese</td><td>18 ECTS</td></tr><tr><td>D</td><td>Aktivitete në disiplina plotësuese</td><td>12 ECTS</td></tr><tr><td>E</td><td>Përgatitja e tezës së diplomës</td><td>18 ECTS</td></tr><tr><td>Totali</td><td></td><td>120 ECTS</td></tr></table> Nga shpërndarja e krediteve sipas tabelës së mësipërme programi i studimit në të dy profilet e studimit <i>Master Shkencor</i>	Tipi veprimtarise	Tipi i Aktivitetit	Nr. i ECTS	A	Aktivitete në disiplina të formimit të përgjithshëm	12 ECTS	B	Aktivitete në disiplina të formimit të karakterizuar	60 ECTS	C	Aktivitete në disiplina ndërdisiplinore dhe intriguese	18 ECTS	D	Aktivitete në disiplina plotësuese	12 ECTS	E	Përgatitja e tezës së diplomës	18 ECTS	Totali		120 ECTS
Tipi veprimtarise	Tipi i Aktivitetit	Nr. i ECTS																				
A	Aktivitete në disiplina të formimit të përgjithshëm	12 ECTS																				
B	Aktivitete në disiplina të formimit të karakterizuar	60 ECTS																				
C	Aktivitete në disiplina ndërdisiplinore dhe intriguese	18 ECTS																				
D	Aktivitete në disiplina plotësuese	12 ECTS																				
E	Përgatitja e tezës së diplomës	18 ECTS																				
Totali		120 ECTS																				

	në "Informatikë me profile a) Inxhinieri Software b) Sisteme Informacioni në Biznes", ka në planin e tij: - Lëndë bazë (A) – 12 ECTS – 10 %; - Lëndë karakterizuese (B) – 63 ECTS – 50 %; - Lëndë ndërdisiplinore/integruese (C) – 18 ECTS – 15 %; - Lëndë plotësuese (D) – 12 ECTS – 10 %; - Detyrime përmbyllëse (E) – 18 ECTS – 15 %; GVJ konstaton që shpërndarja e krediteve në këtë program studimi është realizuar në përputhje me VKM Nr. 41, sipas të cilit: - Lëndët Bazë (A) duhet të jenë në masën 5-10%; - Lëndët karakterizuese (B) duhet të jenë në masën 50-60%; - Lëndët ndërdisiplinore/integrese (C) duhet të jenë në masën 12-20%; - Lëndët plotësuese (D) duhet të jenë në masën 10%; - Lëndët përmbyllëse (E) duhet të jenë në masën 10-15%; <i>Megjithatë, GVJ konstaton se në planin mësimor dhe në syllabuset e lëndëve:</i> - <i>Asnjë lëndë nuk ka të dedikuara kredite në lidhje me orët laboratorike;</i> - <i>Nuk janë përcaktuar kodet e lëndëve.</i> Gjatë vizitës në institucion, GVJ mësoi që për shkak të natyrës teknike të programit të studimit për një pjesë të lëndëve mësimi zhvillohet tërësisht në laborator. Megjithatë, mungesa e orëve laboratorike të shprehura qartë në ngarkesë mësimore në planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve mund të bëhet pengesë për transferimin e studentëve në institucione të tjera, mobilitetet, vlerësimin nga ekspertët për mjaftueshmërinë e kapaciteteve laboratorike të institucionit, etj. <i>GVJ sugjeron përcaktimin në planin mësimor të ngarkesës mësimore për aktivitetin didaktik Laborator.</i> Evidenca Nr 10: Permbledhese e tabelave per programin Evidenca Nr 21: Plani mesimor Evidenca Nr 22: Syllabuset e lendeve te ofruara per vitin akademik
--	--

Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software” është zhvilluar në përputhje me Nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), të dispozitave të ligjit numër 10 247, datë 04.03.2010. Orientimi i programit të studimit <i>Master Shkencor</i> në “Informatikë me profile a) Inxhinieri Software b) Sisteme Informacioni në Biznes”, i specifikuar edhe në Statutin e Universitetit, demonstroi aftësi kërkimore të cilat janë të disponueshme në Departamentin e Informatikës së Biznesit. Objektivat kryesore formuese të këtij programi, mbështetur në Nivelin 7 në KSHK, në lidhje me njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që një student i diplomuar në: I. Programi <i>Master Shkencor</i> në Informatikë me profil “Inxhinieri Software”, duhet të plotësojë janë: a. Përgatitja e specialistëve me kualifikim bashkëkohor me njohuri të avancuara në fushën e inxhinierisë software, shkencave kompjuterike dhe teknologjisë së informacionit, duke përfshirë analizën kritike të teorive, parimeve, vlerësimeve të njohurive, mjeteve dhe pajisjeve si edhe kriterëve të performancës; b. Përgatitja e specialistëve me kualifikim bashkëkohor për aftësi të avancuara në shkencë kompjuterike, si “machine learning”, inteligjenca artificiale, “cyber security” duke demonstruar inovacion, zgjidhje të problemeve komplekse, përmirësimin e sigurimit të cilësisë; c. Përgatitja e specialistëve të kualifikuar për menaxhimin e aktiviteteve apo projekteve komplekse teknike ose profesionale, duke i përgatitur për përgjegjësi vendimmarrje. II. Programi <i>Master Shkencor</i> në Informatikë me profil “Sisteme Informacioni në Biznes”, duhet të plotësojë janë: a. Përgatitja e specialistëve të kualifikuar për menaxhimin e bazave të të dhënave; b. Përgatitja e specialistëve me kualifikim bashkëkohor për aftësi të avancuara në Sistemet e Planifikimit të Burimeve të Ndërmarrjes (ERP); c. Përgatitja e specialistëve me kualifikim bashkëkohor me njohuri të avancuara në analizën dhe dizajnimin e sistemeve si edhe përdorimi i teknologjive inovative për
---	--

	analizimin e të dhënave të biznesit me qëllim marrjen e vendimeve strategjike. <i>Evidenca Nr 1: Statuti i UMSH</i> <i>Evidenca Nr 6: Rregullore e programit Master Shkencor ne Informatike me profile</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Lëndët/modulet janë grupuar sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 me ngarkesën përkatëse në kredite, si më poshtë: - Lëndë bazë (A) – 12 ECTS; - Lëndë karakterizuese (B) – 60 ECTS; - Lëndë ndërdisiplinore/integruese (C) –18 ECTS; - Lëndë plotësuese (D) – 12 ECTS; - Detyrime përmbyllëse (E) – 18 ECTS; GVJ konstaton që sipas VKM Nr. 41: Programi i studimit, bazuar në planin mësimor ka të përcaktuara në kredite realizimin e praktikës profesionale (12 ECTS), të konvertuara në 120 orë dhe temë diplome në kuadër të detyrimeve përmbyllëse (18 ECTS): <i>Evidenca Nr 10: Permbljedhese e tabelave per programin</i> <i>Evidenca Nr 21: Plani mesimor</i> <i>Evidenca Nr 23: Udhezues per pergatitjen e punimit te diplomes</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	Nuk aplikohet.
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e	

mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Nuk aplikohet.
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Nuk aplikohet.
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Për programin <i>Master Shkencor</i> në “Informatikë” me profile “Sistemet Informacioni në Biznes” dhe “Software Engineering” të ofruar nga UMSH, vihet re se plani mësimor në emërtime lëndësh, por edhe në shpërndarje, është i ngjashëm me programet e ofruara nga IAL të tjera brenda vendit dhe në përputhje me objektivat e formimit të këtij programi studimi. Krahasuar me programe të ngjashme të studimit të ofruara në vend dhe bazuar në listën e programeve të akredituara nga ASCAL dhe të publikuar në faqen web zyrtare, po përmendim disa prej tyre: 1. <i>Master i shkencave</i> Shkenca Informatike me tre profile "Informatikë Biznesi", "Teknologji Informacioni", "E-Commerce dhe Inovacion", ofruar nga Kolegji Universitar i Biznesit. 2. <i>Master i shkencave</i> "Inxhinieri kompjuterike dhe teknologji informacioni", me profile: "Inxhinieri kompjuterike dhe BIG

	Data"; "Rrjetet kompjuterike dhe Siguria Kibernetike"; "Multimedia-Dizajn", ofruar nga Universiteti European i Tiranës 3. <i>Master i shkencave "Inxhinieri kompjuterike dhe teknologji informacioni"</i>, me profile: "Inxhinieri kompjuterike dhe BIG Data"; "Rrjetet kompjuterike dhe Siguria Kibernetike"; "Multimedia-Dizajn", ofruar nga Kolegji "Instituti Kanadez i Teknologjise".
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Kodifikimi i lëndëve, në zbatim të VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 dhe Urdhër të MAS Nr. 31 datë 15.11.2022, është në proces. Nga evidencat e vendosura në dispozicion, institucioni ka hartuar planin e kodifikimit të programeve si më poshtë: - Kodifikimi 0613 - për Programin e studimit <i>Master i Shkencave</i> në "Informatikë me profil Inxhinieri Software", ku 06 specifikon fushën e gjerë (Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit) dhe 0613 – fusha e ngushtë (Zhvillimi dhe analiza e software-ve dhe aplikacioneve) - Kodifikimi 0688 - për Programin e studimit <i>Master i Shkencave</i> në "Informatikë me profil Sistemet e Informacionit në Biznes", ku 06 specifikon fushën e gjerë (Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit) dhe 0688 – fusha e ngushtë (Programet dhe kualifikimet ndërdisiplinore, që përfshijnë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit). <i>Evidence: Materiali RVB</i>
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i studimit <i>Master Shkencor</i> në "Informatikë me profile a) Inxhinieri Software b) Sisteme Informacioni në Biznes", nuk ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, duke qenë një program i ri studimi.
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master i Shkencave në "Informatikë", me profile "Sistemet e Informacionit në Biznes" dhe "Inxhinieri Software", ofron njohuritë dhe kompetencat e nevojshme për formimin e specialistëve në fushën e shkencave kompjuterike. Ai</i>

	është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ndjek politikat dhe procedurat e pranimit dhe të përzgjedhjes së studenteve bazuar në kriteret dhe afatet ligjore të përcaktuara në aktet ligjore përkatëse dhe në përputhje me kapacitetet e tij në infrastrukturë, burime njerëzore dhe kërkesat e tregut. Programi i studimit është ndërtuar pjesërisht në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Konstatohet që në planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve nuk është përcaktuar ngarkesa në kredite/orë mësimore për veprimtarinë formuese, Laborator. Duke e konsideruar këtë aktivitet didaktik tejet të rëndësishëm për natyrën e programit të studimit, GVJ sugjeron përcaktimin në planin mësimor të ngarkesës së këtij aktiviteti didaktik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Fakulteti i Informatikës si njësi kryesore është i përbërë nga këto njësi bazë: 1. Departamenti i Informatikës së Biznesit; 2. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit; 3. Qendra e Kërkimore: Qendra e Inovacionit dhe Teknologjive Digjitale. Institucioni, bazuar në ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ka miratuar: 1. Statutin e Universitetit Mesdhetar i Shqipërisë, urdhër MASR Nr. 7769/5, datë 16/12/2022;

2. Rregulloren e Organizimit UMSH;
3. Rregulloren e Njesisë Kryesore – FI;
4. Rregulloren e Departamentit të Informatikës së Biznesit;
5. Rregullore e Programit të Master në “Informatikë me profile a) Inxhinieri Software b) Sisteme Informacioni në Biznes”.

Mbi bazën e tyre është ngritur Struktura Akademike e FI si më poshtë:

- a. Strukturat drejtuese:
 - Dekan (Drejtues i Njesisë Kryesore)
 - 1 Zëvendës dekan
 - 3 Përgjegjës Departamenti (drejtues të Njësive Bazë)
- b. Administratori i njesisë kryesore
- c. Asambleja e personelit akademik të njesisë kryesore
- d. Njësitë bazë të punës mësimore shkencore:
 - Departamenti i Informatikës së Biznesit;
 - Departamenti i Teknologjisë së Informacionit;
 - Qendër Kërkomore: Qendra e Inovacionit dhe Teknologjive Digjitale;
- e. Strukturat mbështetëse:
 - 1 kryesekretare
 - Sekretaria mësimore e FI
 - Laborantë IT
 - Biblioteka

Fakulteti i Informatikës në vitin akademik 2023-2024 është i përberë nga Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel fakulteti (27 pedagogë PAE) dhe 18 Personel Akademik me Kontratë, të cilët kanë kualifikimin si më poshtë:

Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Informatikës	
	PAE	PAK
Prof.Dr	3	3
Prof.Asoc	-	3
Dr/PhD	11	-
Msc	13	12
Gjithsej	27	18
	45	

Njësia bazë, Departamenti i Informatikës së Biznesit përgjegjës për programin e studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë:

Tituj/ grada	2022 – 2023		2023 – 2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	1	1	1
Prof. Asoc.	-	-	-	-
Dr./PhD.	3	-	3	-
Msc.	4	2	6	4
Totali	8	3	10	5

GVJ konstaton se stafi akademik i angazhuar në program ka të paktën gradën shkencore doktor.

GVJ konstaton se të dhënat numerike të stafit akademik në tabelat 6 dhe 12 në lidhje me stafin akademik me kontratë nuk korespondojnë. Megjithatë, pavarësisht kësaj mospërputhjeje, mbi 90% e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit është staf akademik efektiv dhe Departamenti i Informatikës plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë.

GVJ rekomandon institucionin të bëjë kujdes të shtuar në kontrollin e saktësisë së të dhënave që vihen në dispozicion të GVJ.

Evidenca Nr 1: Statuti i UMSH;

Evidenca Nr 9: Rregullore e organizmit UMSH;

Evidenca Nr 5: Rregullore e Fakultetit të Informatikës;

	<i>Evidenca Nr 14: Rregullore e Departamentit te Informatikes se Biznesit;</i> <i>Evidenca Nr 6: Rregullore e Programit Master Shkencor ne Informatike me Profile;</i> <i>Evidenca Nr 10: Permbledhese e tabelave per programin; Tabela 6.1; Tabela 6.2, Tabela 12.</i> <i>Evidenca Nr 7: CV e stafit akademik ne programin e studimit;</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Departamenti i Informatikës së Biznesit, përgjegjës për programin e studimit në fjalë, bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, ka në strukturën e tij 1 (një) staf ndihmës akademik me përshkrimin “Specialist i rrjetit kompjuterik” i cili angazhohet në instalimin dhe testimin e software dhe hardware në institucion, garantimin e sigurisë dhe privatësisë së rrjeteve kompjuterike, mirëmbajtja e sistemeve kompjuterike dhe mbështetje teknike e përdoruesve. GVJ konstaton që stafi ndihmës akademik (laboranti) ka kualifikimin e duhur, por ky personel duhet të kryejë aktivitete në mbështetje të studentëve gjatë seancave laboratorike, praktikave mësimore dhe zhvillimit të temave të diplomave, bazuar në Statutin e UMSH, Neni 59 dhe Rregulloren e Programit të Studimit, Neni 11. <i>Evidenca Nr 1: Statuti i UMSH</i> <i>Evidenca Nr 6: Rregullore e Programit Master Shkencor ne Informatike me Profile</i> <i>Evidenca Nr 8: CV e stafit ndihmes ne programin e studimit</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Departamenti i Informatikës së Biznesit, si pjesë e Fakultetit të Informatikës, cakton një koordinator për programet master. Koordinatori për programin e për programin e studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”, zhvillon veprimtaritë e tij në përputhje me rregulloren e programit të studimit, dhe raporton periodikisht tek shefi i departamentit dhe dekani. Në cilësinë e koordinatorit, zhvillon vazhdimisht takime me studentët dhe stafin e përfshirë në programin e studimit. Gjithashtu në kompetencat e tij, koordinatori drejton punën për miratimin e planeve mësimore, ndjek dhe kontrollon aktivitetin shkencor, bashkërendon shpërndarjen e ngarkesës mësimore, realizon analiza të herëpashershme me stafin përkatës për aspektet shkencore në programet e studimit. <i>Evidenca Nr 5: Rregullore e Fakultetit te Informatikes</i>

	<i>Evidenca Nr 6: Rregullore e Programit Master Shkencor ne Informatike me Profile</i> <i>Evidenca Nr 14: Rregullore e Departamentit te Informatikes se Biznesit</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</i> <i>GVJ konstaton se:</i> - <i>Stafi akademik i angazhuar në program ka të paktën gradën shkencore doktor;</i> - <i>Mbi 90% e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit është staf akademik efektiv dhe kriteri ligjor plotësohet;</i> - <i>Stafi ndihmës akademik (laboranti) ka kualifikimin e duhur, por ky rol duhet të kryejë edhe aktivitete në mbështetje të studentëve gjatë seancave laboratorike, praktikave mësimore dhe zhvillimit të temave të diplomave.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”, është hartuar dhe ofrohet nga Departamenti i Informatikës së Biznesit, pranë Fakultetit të Informatikës. Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se Departamenti i Informatikës së Biznesit disponon dhe ka vënë në dispozicion të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si: rregulloren e programit të studimit, planin mësimor me ndarjen e lëndëve sipas veprimtarive formuese, syllabuset e lëndëve ku paraqitet informacion i

	hollësishëm mbi detyrimin e frekuentimit/ndjekjes së programit, mënyrën e vlerësimit të dijeve, CV e personelit akademik, etj. Të dhëna që janë edhe në nivel të njësisë kryesore, ku mund të përmendim: Të dhëna të përgjithshme mbi programin, objektivat formuese, synimet, kriteret përzgjedhëse, regjistrimet, transferimet, tarifat, metodat e mësimdhënies etj. Dokumentacioni i sipërcituar ruhet, arkivohet dhe menaxhohet sipas rregullave të brendshme institucionale. <i>Evidenca Nr 1: Statuti i UMSH</i> <i>Evidenca Nr 5: Rregullore e Fakultetit të Informatikës</i> <i>Evidenca Nr 9: Rregullore e organizmit UMSH</i> <i>Evidenca Nr 21: Plani mesimor</i> <i>Evidenca Nr 22: Syllabuset e lendeve të ofruara për vitin akademik</i> <i>Evidenca nr 7: CV e stafit akademik në programin e studimit</i>									
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Sipas planit mësimor, programi i studimit është i strukturuar në 2 vite akademike të organizuar në 4 semestra. Zhvillohen gjithsej 15 lëndë lëndë të ndara sipas 2 viteve: • 10 lëndë në vitin e parë; • 5 lëndë, praktika dhe diploma në vitin e dytë. Në vitin e dytë është parashikuar edhe Praktika me 12 kredite ECTS dhe Diploma me 18 kredite ECTS. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 41/2018 i ndryshuar) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E) dhe në përqindje në përputhje me aktet rregullatore në fuqi. Çdo lëndë i është caktuar numri i duhur i krediteve ECTS në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar. <table><tr><th>Tipi veprimtarise</th><th>Tipi i Aktivitetit</th><th>Nr. i ECTS</th></tr><tr><td>A</td><td>Aktivitete në disiplina të formimit të përgjithshëm</td><td>12 ECTS</td></tr><tr><td>B</td><td>Aktivitete në disiplina të formimit të karakterizuar</td><td>60 ECTS</td></tr></table>	Tipi veprimtarise	Tipi i Aktivitetit	Nr. i ECTS	A	Aktivitete në disiplina të formimit të përgjithshëm	12 ECTS	B	Aktivitete në disiplina të formimit të karakterizuar	60 ECTS
Tipi veprimtarise	Tipi i Aktivitetit	Nr. i ECTS								
A	Aktivitete në disiplina të formimit të përgjithshëm	12 ECTS								
B	Aktivitete në disiplina të formimit të karakterizuar	60 ECTS								

	C	Aktivitetë në disiplina ndërdisiplinore dhe intriguese	18 ECTS
	D	Aktivitetë në disiplina plotësuese	12 ECTS
	E	Përgatitja e tezës së diplomës	18 ECTS
	Totali		120 ECTS
Nga shpërndarja e krediteve sipas tabelës së mësipërme programi i studimit në të dy profilet e studimit <i>Master Shkencor</i> në "Informatikë me profile a) Inxhinieri Software b) Sisteme Informacioni në Biznes", ka në planin e tij: - Lëndë bazë (A) – 12 ECTS – 10 %; - Lëndë karakterizuese (B) – 63 ECTS – 50 %; - Lëndë ndërdisiplinore/integruese (C) – 18 ECTS – 15 %; - Lëndë plotësuese (D) – 12 ECTS – 10 %; - Detyrime përmbyllëse (E) – 18 ECTS – 15 %; GVJ konstaton që shpërndarja e krediteve në këtë program studimi është realizuar në përputhje me VKM Nr. 41. IAL ka parashikuar në planin mësimor dhe në syllabuset e lëndëve numrin total të krediteve ECTS dhe ndarjen e tyre në aktivitete formuese Leksione, Seminare, (nuk parashikon kredite ECTS/ore mesimore për Ushtrimeve/laboratoreve) si dhe orët në auditor/jashtë auditorit për çdo lëndë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit për programin e studimit rezulton se për programin parashikohen në total 1170 orë në auditor dhe 1830 orë jashtë auditorit. <i>Evidenca Nr 5: rregullore e fakultetit të informatikës</i> <i>Evidenca Nr 6: Rregullore e Programit Master Shkencor në Informatikë me profile</i> <i>Evidenca nr 10: Permblledhese e tabelave për programin</i> <i>Evidenca Nr 21: Plani mesimor</i> <i>Evidenca Nr 22: Syllabuset e lendeve të ofruara për vitin akademik</i>			
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ofron burime të ndryshme për t'i pajisur studentët me informacionet e nevojshme referuar kriterëve të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Këto informacione jepen në: - Rregulloren e Fakultetit të Informatikës		

specifike të pranimi, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	- Rregulloren e programit të studimit - Përmbledhje e Procedurës së transferimit Pranimi në programin e ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software” është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e parë Bachelor në fusha të ngjashme ose zotërojnë një diplomë ekuivalente studimi të fituar në vende të tjera të njohura nga autoritetet zyrtare dhe ligjet në fuqi, që plotëson kriterin e notës mesatare të përcaktuar çdo vit me VKM dhe aplikantët të cilët çertifikojnë nivelin e duhur të anglishtes bazuar në certifikimet ndërkombëtare si TOEFL (IBT 68, CBT 190, PBT 520), IELTS me e madhe se 5.5 apo njohja e nje prej 4 gjuhëve të tjera të huaja të Bashkimit Europian si frengjisht, gjermanisht, italisht ose spanjisht. Departamenti i Informatikës së Biznesit, bazuar në ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, përcakton kriteret e pranimi për këtë program studimi si dhe kriteret që do të përdoren për përzgjedhjen e kandidatëve fitues. Kriteret e përcaktuara miratohen nga Dekanati dhe pas miratimit në Senatin Akademik, u vihen në dispozicion Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin para fillimit të aplikimeve për pranime. Në këtë program studimi ka pasur 1 student të transferuar në Vitin e II, të grupit të studentëve të rregjistruar në vitin 2022-2023 dhe tre studentë të transferuar në Vitin e II, të studentëve të rregjistruar në 2023-2024. Programi i studimit ka pasur 6 studente të transferuar në Vitin e II, të rregjistruar në 2023-2024. GVJ konstaton se në Rregulloren e Programit Master Shkencor në Informatikë me Profile, Kreu III, Neni 12: - Pika 3 “Në Masterin e Shkencave në Informatikë me profile “Inxhinieri Software” dhe “Sisteme Informacioni në Biznes” me profile mund të pranohen pa plotësim kreditesh studentët që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në shkenca politike pranë UMSH, në përputhje me kriteret e njehsimit të diplomave.
--	--

	- Pika 4 “Në Masterin e Shkencave në Informatikë me profile “Inxhinieri Software” dhe “Sisteme Informacioni në Biznes” me profile mund të pranohen pa plotësim kreditesh studentët të cilët kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në shkenca politike apo profile të ngjashme me universitete të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë, në përputhje me kriteret e njehsimit të diplomave”. <i>GVJ rekomandon të rishikohen keto pika të nenit 12, për pranimin e studentëve, pasi studentët të cilët përfundojnë programin Bachelor në “Shkenca Politike” nuk kanë formimin e duhur për të ndjekur studimet për master shkencor në Inxhinieri software dhe Sisteme informacioni në biznes.</i> <i>Evidenca Nr 5: Rregullore e Fakultetit te Informatikes, Neni 32</i> <i>Evidenca Nr 6: Rregullore e Programit Master Shkencor ne Informatike me profile</i> <i>Evidenca Nr 46: Permbledhje e procedures se transferimit te studenteve</i> <i>Dokumenta shese:</i> <i>Procedure transferimi dhe lista e studenteve te transferuar</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Syllabuset e detajuara të çdo lënde, hartuar në përputhje me shtojcën Nr. 2 të VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018, bazuar në planin mësimor të programit të studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”, risjellin informacionet e nevojshme për studentët lidhur me organizimin e tyre në leksione/seminare, si dhe ngarkesën përkatëse brenda dhe jashtë auditorit. Nga materialet e vëna në dispozicion lidhur me syllabuset dhe planet mësimore, <i>GVJ rekomandon:</i> - <i>Në syllabus-et e lëndëve të paraqiten temat javore me orët përkatëse në cdo javë sipas ndarjes në leksione, seminare, laboratore dhe detyra kursi.</i> - <i>Evidentimin në planin mësimor dhe në syllabuset e lëndëve të krediteve/orëve të dedikuara laboratoreve/detyrave të kursit/projekteve.</i> - <i>Të cilësohet viti akademik në syllabuset e miratuara.</i> - <i>Të cilësohet programi i studimit dhe profili përkatës ku jepet lënda.</i> <i>Evidenca Nr 22: Syllabuset e lendeve te ofruara per vitin akademik</i>

	<i>Evidenca Nr 21: Plani mesimor</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”, nuk ka pësuar ndryshime bazuar në legjislacionin në fuqi, pasi programi akreditohet për herë të parë. Ndërkohë, në përputhje me Politikën e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, Strategjinë e Zhvillimit të Programit, për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe <i>Rregulloren e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave</i>, bëhet një rishikim vjetor i programit të studimit, i cili përfshin vlerësimin e efektivitetit dhe identifikimin e fushave për përmirësim duke përfshirë modifikimet e kurrikulës. Syllabuset përditësohen nga stafi i angazhuar në mësimdhënie dhe miratohen nga Departamenti i Informatikës së Biznesit përpara fillimit të vitit akademik për të garantuar përmirësimin dhe përditësimin e informacionit për studentët. Me tej ato ngarkohen në sistemin SMS. <i>Evidenca Nr 3: Plani i zhvillimit strategjik të UMSH-se</i> <i>Evidenca Nr 4: Strategjia e zhvillimit të programit master shkencor në informatikë me profile</i> <i>Evidenca Nr 15: Rregullore e NJSBCZHK</i> <i>Evidenca Nr 10: Përmbledhese e tabelave për programin</i>
Konkluzione	Programi i studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”, përmban informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra sipas disiplinave përkatëse, krediteve dhe orëve në auditor dhe jashtë auditorit. Nga materialet e vëna në dispozicion lidhur me syllabuset dhe planet mësimore, <u>GVJ rekomandon:</u> - Në syllabus-et e të realizohet shpërndarja e orëve në auditor së bashku me temat përkatëse për secilën orë referuar secilës kategori: leksion, seminar, laborator dhe detyrë kursi; - Të shprehen qartë në planin mësimor dhe në syllabuset e lëndëve të krediteve të dedikuar detyrave të kursit/projekteve/laboratorëve. - Në syllabuse, të cilësohet viti akademik në të cilin syllabusi është miratuar, programi i studimit dhe profili përkatës ku jepet lënda;

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software” është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Viti akademik është i organizuar në 4 semestra dhe përmban 120 ECTS. Përgjatë dy viteve të studimit, me anë të lëndëve të përbashkëta të cilat zhvillohen në të dy profilet, si Programim i Avancuar, Inteligjencë Artificiale, Data Warehouse, Sistemet e Menaxhimit të Informacionit, Metoda të Kërkimit Shkencor, Analiza dhe Projektimi i Sistemeve të Informacionit, Siguria e Sistemeve të Informacionit, Menaxhim Projektsh Modulime dhe Simulime, E-Business i Avancuar, studentët përgatiten që të zbatojnë parimet inxhinierike në fushën informatike, kërkimit shkencor, por edhe për t’u pajisuar me aftësi për të punuar në grup dhe për të pasur role drejtuesi. Gjithashtu për profilin e vecantë “Inxhinieri Software” programi ofron lëndët Inxhinieri Software, Testim Software, Aplikime Enterprise, ndersa në profilin “Sistemet e Informacionit”, programi ofron lëndët Kontabilitet, Kosto Drejtimi, Modele të Rritjes Ekonomike, Komunikimi i të Dhënave. Kjo realizohet në përputhje me rregulloren e programit, misionin dhe studimin e tregut të punës për këtë program. Lëndët në planin mësimor të këtij programi studimi e kanë të nevojshme zhvillimin në ambiente laboratorike për aftësimin e studentëve në fushën e informatikës dhe formimin e tyre profesional për tregun e punës. <i>GVJ, thekson që mungesa e orëve laboratorike (sipas rekomandimeve në Standardi II.3) të matshme në orë në auditor në secilën lëndë shihet nga GVJ si</i>

	<i>mangesi per thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme, transferim te studimeve brenda dhe jashte vendit dhe punësimin e studentëve.</i> <i>Evidenca Nr 10: Permbledhese e tabelave per programin</i> <i>Evidenca Nr 6: Rregullore e programit Master Shkencor ne Informatike me profile</i> <i>Evidenca Nr 24: Analiza e tregut te punes</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Lëndët/modulet janë grupuar sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 me ngarkesën përkatëse në kredite, si më poshtë, ku për secilin profil është shpërndarja e mëposhtme: - 2 lëndë bazë (Kategoria A – 12 ECTS – 10 %) - 10 lëndë karakterizuese (Kategoria B – 60 ECTS – 50 %) - 3 lëndë ndërdisiplinore/integruese dhe grup-lënde me zgjedhje (kategoria C – 18 ECTS – 15 %) - 1 lëndë plotësuese (Praktika Profesionale – Kategoria D – 12 ECTS – 10 %) - 1 detyrime përmbyllëse (Mbrojtja e diplomës – Kategoria E – 18 ECTS – 15 %) Detyrimet përmbyllëse (E) parashikojnë mbrojtjen e diplomës, gjithsej 18 ECTS. Shpërndarja e lëndëve në semestra duke filluar nga lëndët formuese në vitin e parë, deri te ato bërthamë në vitin e dytë, e më tej në lëndët me zgjedhje bëhet sipas një rrjedhe logjike të programit përputhur me rezultatet e të nxënit të secilës lëndë. Nisur nga të dhënat e planit mësimor, GVJ konstaton se shpërndarja e lëndëve/moduleve në semestral mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të kërkimit shkencor. <i>Evidenca Nr 10: Permbledhese e tabelave per programin, Tabela 9</i> <i>Evidenca Nr 21: Plani mesimor</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master	Struktura e programit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software” ka një fokus të madh në aftësitë praktike, duke ofruar një raport të mirë të teorisë dhe praktikës me qëllim ofrimin e metodologjive më efektive për planifikimin, zhvillimin, testimin dhe mirëmbajtjen e softuarit, implementimin e machine learning dhe algoritmave të inteligjencës artificiale, implementimin e data warehouse, menxhimin e projekteve, etj. në përputhje edhe me programe të tjera studimi të suksesshme të Informatikës me

Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	profile në Inxhinieri Software apo Sisteme Inforamacioni në Biznes. <i>GVJ sugjeron që institucioni të rishohë syllabuset duke shprehur qartazi ngarkesën për aktivitetet laboratorike, projekte e detyra kursi, të vlerësuara nga GVJ si aktivitetete të rëndësishme në formimin e studentëve në fushën e Informatikës.</i> <i>Evidenca Nr 21: Plani mesimor</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë duke ofruar një kurrikul të pasur moderne me fokus në pjesët teorike dhe praktike, nxit një shkallë të lartë të punësimit, sidomos në studentët e viteve të dyta. Studentët e programit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software” duke u pajisur me aftësi programuese e dizajnuese të softuare-it, nocione dhe implementime të algoritmeve të ndryshme e “machine learning”, modelime dhe simulime në biznes, bëhen të aftë të punësohen në institucione e kompani te ndryshme apo në ndjekjen e studimeve të niveleve më të larta jo vetëm në institucione të tjera të arsimit të lartë në Shqipëri, por edhe në universitete ndërkombëtare. Sipas Strategjisë së Ndërkombëtarizimit, UMSH synon nëpërmjet planit mësimor të programit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software” të lehtësojë procesin e transferimit të studentëve në një universitet brenda apo jashtë vendit. <i>GVJ mendon që rishikimi i raporteve teori/praktikë në planin mësimor do të mbështeste me tej Strategjinë e Ndërkombëtarizimit institucional.</i> <i>Evidenca Nr 21: Plani mesimor</i> <i>Evidenca Nr 47: Strategjia e Nderkombetarizimit</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Pedagogët e lëndëve të programit të studimit kujdesen të përgatisin materiale mësimore të përditësuara jo vetëm nga ana e përmbajtjes, por edhe në lidhje me metodologjinë, të cilat vihen në dispozicion të studentëve. Ofrimi i programit realizohet në gjuhën shqipe, por një pjesë e konsiderueshme e literaturave ofrohen në gjuhën angleze. Literatura mund të aksesohet fizikisht në bibliotekën e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë ose në bibliotekën dixhitale të ofruar në Sistemin e Menaxhimit të Studentëve UMSH:

	<i>Megjithatë, nga vlerësimi i literaturës në syllabuset e lëndëve, GVJ konstaton që për një pjesë të tyre viti i botimit të literaturës nuk është i viteve të fundit sipas kriterit përkatës.</i> <i>GVJ rekomandon të përditësohet literatura e rekomanduar në syllabus-et e lëndëve me botime të viteve të fundit dhe të pasurohet biblioteka me këto tituj.</i> <i>Evidenca Nr 22: Syllabuset e lendeve te ofruara per vitin akademik</i> <i>Evidenca Nr 37: Udhëzues per perdorimin e SMS-se</i> <i>Evidenca Nr 43: Manual mbi perdorimin e bibliotekes online</i> https://sms.umsh.edu.al:8020/EbooksServer/user-registration/index.php
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”, u mundëson dhe u garanton studentëve përfitimin e dijeve, fitimin e aftësive dhe kompetencave për t’u punësuar në fushën e shkencave kompjuterike, vendas dhe të huaj, në përputhje me nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, si dhe ndjekjen e studimeve të ciklit të tretë Doktoraturë në përputhje me profilin e studimit. Programet janë hartuar në përshtatje me tregun e punës duke ofruar një formim teorik, praktik e profesional. <i>Evidenca Nr 6: Rregullore e programit Master Shkencor ne Informatike me profile</i> <i>Evidenca Nr 10: Permbledhese e tabelave per programin</i> <i>Evidenca Nr 25: Urdheri per riorganizimin e programit Master Shkencor ne Informatike me profile</i>

Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Departamenti i Informatikës së Biznesit, si pjesë përbërëse e Fakultetit të Informatikës në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë, është në marrëdhënie të vazhdueshme me industrinë, për të përputhur programin e studimit me nevojën e tregut të punës. Si rezultat i bashkëpunimeve ka raste suksesi të punësimit të studentëve në kompani më të cilat UMSH bashkëpunon, si: Deloitte Albania, Procredit, Lufthansa Industry Solutions, Raiffaisen Bank, TeamSystem, Agjencia Kombëtare e e Shoqërisë së Informacionit. <i>Evidenca Nr 11: Liste e marreveshjeve te bashkepunimit</i> <i>Dokumenta shtese: Nje raport ne lidhje me perfitimet nga bashkepunimet per praktikat profesionale</i>			
Konkluzione	Organizimi dhe përmbajtja e kurrikulës në module/lëndë në programin e studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”, krijon mundësinë për një formim të studentëve si ndërthurje e njohurive teorike dhe praktike të nevojshme, në përputhje me teknologjitë më të fundit të fushës, duke mundësuar integrimin e tyre të shpejtë në tregun e punës, si dhe vazhdimin e studimeve në ciklin e tretë të Studimeve, Doktoraturë. GVJ rekomandon: – të përditësohet literatura e rekomanduar në syllabus-et e lëndëve me botime të viteve të fundit dhe të pasurohet biblioteka me këto tituj. – të rishikohet ndarja e veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5 Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës (ZKSK) është një njësi e cila asiston dhe ndjek studentët, jo vetëm gjatë ndjekjes së studimeve, por edhe pas mbarimit të saj duke krijuar një bazë të dhënash për karrierën, suksesin dhe vështirësitë e studentëve gjatë përshtatjes në treg. Gjithashtu, në Fakultetin e Informatikës, bëhen analiza në nivel fakulteti dhe departamenti për ecurinë e programeve të studimit, duke marrë në konsideratë mendimin e përfaqësuesve të tregut të punës dhe studentëve. Misioni i këtij formimi është të sigurojë që programet e studimit përmbushin kërkesat e sektorit privat e të përditësojë kurrikulat në mënyrë të tillë që t'u ofrojë studentëve aftësitë e nevojshme për të qenë të aftë në tregun kombëtar dhe atë ndërkombëtar. <i>Evidenca Nr 15: Rregullore e NJSBCZHK</i> <i>Evidenca Nr: 24: Analiza e tregut te punes</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Institucioni mban kontakte të vazhduara me studentët, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinatorit dhe mentorëve të programit të studimit si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor. Pranë Departamentit të Informatikës së Biznesit, përfshirja e studentëve në përmirësimin e programit të studimit kryhen në disa drejtime: 1. Nëpërmjet përfshirjes në senatin akademik, organin më të lartë vendimmarrës, të kryetarit të këshillit studentor; 2. Përfshirja në Njësinë e Sigurimit të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave; 3. Nëpërmjet sondazhit të vlerësimit të pedagogëve të lëndës; 4. Nëpërmjet takimeve me studentet e diplomuar të cilët ndajnë eksperiencën profesionale në tregun e punës dhe shprehin sugjerimet për përditësime apo përmirësime që mund t'i bëhen kurrikulës për t'iu përshtatur tregut të punës. UMSH përfshin studentët në kërkimin shkencor duke i nxitur ata të marrin pjesë në konferenca, workshope, botime akademike e revista shkencore. Nga takimi i GVJ i zhvilluar me studentët u konstatua një përfshirje dhe interes i tyre në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, duke qenë se shumë prej tyre ishin të punësuar, ose ishin punësuar pas zhvillimit të praktikave mësimore nga Institucione, të cilat zhvillojnë

	aktivitetin e tyre në fushat e informatikës si programimi, rrjete kompjuterike, siguria e rrjeteve kompjuterike, menaxhim bazash të dhënash, “machine learning” apo menaxhim biznesi. Gjithashtu, njësia bazë realizon takime të ndryshme në formën e diskutimeve me studentët e diplomuar, për të marrë propozime nga këndvështrimi i tyre, tashmë si të punësuar. https://www.umsh.edu.al/d/443/universiteti-mesdhetar-i-shqiperise-mbledh-ish-studentet-zhvillohet-takimi-vjetor-alumni <i>Evidenca Nr 6: Rregullore e Programit Master Shkencor ne Informatike me profile</i> <i>Evidenca Nr 26: Procedura e punes me fokus grupet</i> <i>Evidenca Nr 15: Rregullore e NJSBCZHK, Neni 3, faqe 5</i> <i>Evidenca Nr 32: Formulari i vleresimit te pedagogut dhe lendes nga studenti</i> <i>Evidenca Nr 9: Rregullore e organizmit UMSH, Neni 11, pika 2</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Departamenti i Informatikës së Biznesit ka autonomi organizative për t’u angazhuar vazhdimisht në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare, duke ofruar mundësi për krijimin e rrjeteve dhe nënshkrimin e Memorandumeve të Mirëkuptimit (MoU) me institucione publike/jopublike, institucione të arsimit të lartë kombëtare/ndërkombëtare apo organizata të ndryshme. Ky bashkëpunim ka qenë i frytshëm në kuadër të hartimit të programit të studimit, duke sjellë një kurrikul, e cila plotëson nevojat e tregut nga pikëpamja e përmbajtjes dhe e zbatimit të tij. Nga takimet e zhvilluara në institucion u konstatua që ky bashkëpunim është i vazhdueshëm nga ana e institucionit gjë që garanton ruajtjen e cilësisë së programit të studimit dhe lidhjen e ngushtë të tij me tregun e punës. <i>Evidenca Nr 1: Statuti i UMSH</i> <i>Evidenca Nr 11: Liste e marreveshjeve te bashkepunimit</i> <i>Dokumenta shtese: Model marreveshje bashkepunimi me kompani institucione</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se UMSH nxit përfshirjen e studentëve dhe institucioneve partnere në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit të ofruara, duke dëshmuar një përmirësim të vazhduar të ofertës së tij akademike. Departamenti i Informatikës së Biznesit ka autonomi organizative për t’u</i>

	<i>angazhuar vazhdimisht në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare në kuadër të përmirsimit të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software” ofrohet në përputhje të plotë me strategjitë e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë për të përgatitur studentë me një karrierë të mirë profesionale. Objektivat kryesore të këtij programi studimi: - Pajisja e studentëve me njohuri të thelluar teorike dhe shkencore dhe aftësi kërkimore shkencore dhe profesionale në fushën e sistemeve të informacionit dhe inxhinierisë software; - Studenti të jetë i aftë të njohë fushat pilar në sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit si: algoritmika e avancuar, projektimi i sistemeve kompjuterike, strukturave të të dhënave, të njohë konceptet kryesore të aspekteve të sigurisë dhe ‘cyber security’ dhe në përdorimin e inteligjencës artificiale e “machine learning”. - Përgatitja e tyre për të arritur një karrierë të sukseshme profesionale apo akademike duke i nxitur aftësinë e mendimit kritik dhe aftësitë komunikuese; - Përgatitja e tyre për të pasur aftësinë për të punuar në grup apo për të marrë role drejtuese. <i>Evidenca Nr 1: Statuti i UMSH</i> <i>Evidenca Nr 4: Strategjia e zhvillimit të programit Master Shkencor në Informatikë me profile</i> <i>Evidenca Nr 3: Plani i zhvillimit strategjik të UMSH-se</i> <i>Evidenca Nr 47: Strategjia e ndërkombëtarizimit</i>

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Departamenti i Informatikës së Biznesit, si pjesë e Fakultetit të Informatikës është përgjegjës për sigurimin e kërkesave dhe standardeve të nevojshme të mësimdhënies. Stafit akademik vepron në liri të plotë dhe të pavarur akademike, në përputhje me Statutin e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, Rregulloren e Përgjithshme të tij dhe në përputhje me Rregulloren e Programit të Studimit. Departamenti nxit dhe mbështet stafin akademik drejt kërkimit shkencor, në pjesëmarrje në konferenca e publikime në revista kombëtare e ndërkombëtare. Nga vizita në institucion dhe takimi me stafin akademik, GVJ konsaton se insitucioni i mbështet dhe i suporton financiarisht stafin akademik për publikim në revista/konferenca kombëtare apo ndërkombëtare. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është pjesë e programit “Erasmus +”, lançuar nga Komisioni European, i cili synon ndër të tjera krijimin e mundësive të studimit, mësimdhënies dhe trajnimit jashtë vendit për periudha të shkurtra. Në kuadër të këtij programi nga institucioni realizohen mobilitete të studentëve dhe stafit akademik. GVJ, konstaton se procedura e mobiliteteve të stafit mbështetet në meritë. Nga takimi me stafin akademik dhe nga evidencat e vëna në dispozicion konstatoi se janë kryer disa mobilitete në universitete të ndryshme si: Lithuania Business University of Applied Sciences (Lituani), Cukurova University (Turqi), Lomza University (Poloni), University of Tuscia (Itali) etj. GVJ konstaton që departamentit nxit veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. <i>Evidenca Nr 1: Statuti i UMSH</i> <i>Evidenca Nr 6: Rregullore e Programit Master Shkencor në Informatikë me Profile</i> <i>Evidenca Nr 9: Rregullore e Organizimit UMSH</i> <i>Evidenca Nr 5: Rregullore e Fakultetit të Informatikës</i> <i>Evidenca Nr 12: Lista e aktiviteteve organizuar nga fakulteti i Informatikës</i> <i>Evidenca Nr 16: Lista e mobilitetit të stafit akademik</i>
---	--

	<i>Evidenca Nr 27: Procedura per perzgjedhjen e studenteve dhe stafit ne programin Erasmus</i> https://www.umsh.edu.al/c/224/aktivitete-2023 https://www.umsh.edu.al/c/141/aktivitete-2022 <i>Dokumenta shtese:</i> <i>Analiza mesimore kerkimore e njesise baze pergjegjese per programin e studimit</i> <i>Evidence te financimit te kerkimit shkencor nga institucioni</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundeson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software” motivon e inkurajon studentët të përfshihen në studime, ose aktivitete shkencore. Për me tepër bashkëpunimi me institucionet partnere u ofron studentëve mundësinë të aftësohen në punë të ndryshme, ku kryejnë internship-e apo edhe punësohen më tej. GVJ nga vizita në Institucion dhe nga takimi me grupin e studentëve konstatoi se ata ishin të përfshirë në pjesëmarrje konferencash studentore të organizuar nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë dhe një pjesë e tyre ishin të punësuar tashmë nga kompani partnere si Deloitte, Raiffesien etj. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë nxit pjesëmarrjen e stafit dhe studenteve në projekte dhe mobilitete ndërkombëtare. Për studentët të cilët aplikojnë për bursa Erasmus+ kriteret që merren në konsideratë janë: Mesatarja, Gjuha e huaj, Dokumenti Learning Agreement, Letër Motivimi. Konkretisht, 2 studentë nga ky program studimi kanë marrë pjesë në mobilitete. <i>GVJ sugjeron që UMSH të nxisë dhe dokumentojë bashkëpunimin e studentëve me stafin akademik dhe pjesëmarrjen e tyre të përbashkët në konferenca, projekte apo publikime në revista.</i> <i>Evidenca Nr 11: Liste e marreveshjeve te bashkepunimit</i> <i>Evidenca Nr 12: Lista e aktiviteteve organizuar nga fakulteti i informatikes</i> <i>Evidenca Nr 27: Procedura per perzgjedhjen e studenteve dhe stafit ne programin Erasmus</i> <i>Evidenca Nr 10: Permbledhese e tabelave per programin</i> https://sites.google.com/umsh.edu.al/iscumsh-2023/home?pli=1

	https://www.umsh.edu.al/d/360/studentet-e-umsh-pjese-e-programit-te-ri-ne-fushen-e-informatikes-key-academy
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Departamenti i Informatikës së Biznesit, si pjesë e Fakultetit të Informatikës, angazhohet për të realizuar aktivitete studimore, kërkimore shkencore. Departamenti organizon workshop-e, leksione të hapura dhe bashkëpunime institucionale. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë motivon stafin e tij akademik për pjesëmarrje në Konferenca dhe publikime në revista kombëtare apo ndërkombëtare me anë të: - Bashkëpunimeve nga projektet e përbashkëta me partnerë ndërkombëtarë; - Burime të brendshme të universitetit, duke i alokuar çdo stafi akademik mbështetje financiare për kërkimin shkencor, pjesëmarrje në konferenca apo workshope, publikim librash. Plani i shpenzimeve për mbështetje financiare hartohet një herë në vit. Nga vizita në Institucion, takimi me stafin akademik, takimi me dekanin dhe shefen e departamentit, GVJ konstatoi se Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ndjek politika mbështetje të stafit kërkimor shkencor në mënyrë të tillë që buxheti i parashikuar për këtë zë, ndahet në mënyrë të barabartë mes anëtarëve të departamentit. Instancat përkatëse vendimmarrëse për aprovimin e një kërkese financimi për një pjesëmarrje në konferencë apo botim artikulli janë: - Përgjegjësi i Departamentit/ Dekani i Fakultetit; - Përgjegjësi i financave; - Bordi Administrativ; Në mënyrë që stafi të përfitojë mbështetje financiare duhet që të plotësojë hapat e mëposhtëm: - Plotësimi i formularit të kërkesës së paku dy javë para zhvillimit të aktivitetit; - Dorëzimi i abstraktit dhe letra e pranimi; - Dorëzimi i punimit të plotë në dekanat, në formë elektronike dhe fizike. <i>Evidenca Nr 16: Liste e mobiliteteve te stafit akademik</i> <i>Evidenca shtese: Evidence te financimit te kerkimit shkencor nga institucioni</i>

Konkluzione	<i>GVJ nga vizita në Institucion dhe nga takimi me grupin e studentëve konstatoi se ata ishin të përfshirë në konferenca të organizuara nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë dhe një pjesë e tyre ishin të punësuar nga kompani partnere me UMSH si Lufthansa Solution. Konkretisht, 2 studentë nga ky program studimi kishin marrë pjesë në mobilitete të financuara nga IAL-ja apo projekte ndërkombëtare.</i> <i>GVJ konsaton se insitucioni i mbështet dhe i suporton financiarisht stafin akademik në avancimin e tyre akademik, për kryerje mobilitetesh, pjesëmarrje në konferenca kombëtare/ndërkombëtare apo për publikim në revista kombetare/ndërkombëtare të indeksuara në SCOPUS.</i> <i>GVJ rekomandon të nxitet jo vetëm pjesëmarrja e studentëve në mobilitete, por edhe bashkëpunimi i tyre me stafin akademik për pjesëmarrje në konferenca shkencore, projekte dhe publikime në revista.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.7 Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Departamenti i Informatikës së Biznesit në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë, mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore. Duke pasur marrëdhëne bashkëpunimi me struktura të tjera kërkimore, programi i studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”, organizon lëndët në mënyrë të tillë ku i kushtohet vëmendje e vecantë anës praktike. Gjithshtu në kuadër të projekteve shkencore në rang departamenti apo fakulteti, u është ofruar mundësia studentëve të këtij programi që të zhvillojnë njohuritë e tyre shkencore-kërkimore, duke u bërë pjesë e këtyre projekteve.

	<i>Evidenca Nr 10: Permbledhese e tabelave per programin, Tabela 22</i> <i>Evidenca Nr 21: Plani mesimor</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Departamenti i Informatikës së Biznesit, si pjesë e Fakultetit të Informatikës, harton dhe kryen analiza vjetore në kuadër të ecures së kërkimit shkencor apo projekteve. Angazhimi ndodh në nivel akademik, studentor, në nivel departamenti, fakulteti e universiteti. Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore të tij, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, zbaton politika të brendshme për të inkurajuar stafin drejt kërkimit shkencor apo aplikimet për projekte të ndryshme kombëtare/ndërkombëtare. Nga vizita në institucion, takimi me Dekanin, Përgjegjësen e Departamentit dhe stafin akademik PAE & PAK, GVIJ vëren përfshirje e pjesëmarrje në konferenca apo publikime në revista të stafit akademik. UMSH harton një raport vjetor, në të cilin mbledh këto të dhëna nga departamentet dhe harton një raport në të cilin përmban informacion në lidhje me: - Kërkimit shkencor. - Realizimin e qëllimit dhe objektivave sipas planit strategjik. - Mësimdhënien. - Bashkëpunimet. <i>Evidenca Nr 20: Raport vjetor i UMSH</i> <i>Evidenca shtese:</i> <i>Evidence te financimit te kerkimit shkencor nga institucioni</i> <i>Analiza mesimore kerkimore e njesise baze pergjegjese per programin e studimit</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Departamenti i Informatikës së Biznesit, si pjesë e Fakultetit të Informatikës, në bashkëpunim me Qendrën Kërkimore: Qendra e Inovacionit dhe Teknologjive Digjitale hartojnë planin vjetor të kërkimit shkencor, në të cilin përfshihen aktivitete të ndryshme shkencore si: - Konferenca Shkencore Konferenca e vitit 2023 ishte me temë “International Scientific Conference with the topic “ARE WE READY? Challenges of the society facing digital transformation”;

	- Periodikë shkencore (1) revista Euromediterranean [https://www.umsh.edu.al/c/69/revista-euromediterranean], (2) revista Ecoinfo-sistem [https://www.umsh.edu.al/c/226/revista-ekoinfo-sistem], - Leksione të hapura [https://www.umsh.edu.al/c/218/aktivitete-te-tjera]; - Forume; - Trajnime për stafin akademik e studentët; GVJ, prej evidencave të vendosura në dispozicion, takimi me stafin akademik, drejtuesen e departamentit dhe dekanin e fakultetit vlerëson faktin që: - Ka një mbështetje dhe inkurajim të mobiliteteve në programet Erasmus të stafit akademik dhe studentëve; - Ofrohet mbështetje financiare për stafin akademik për pjesëmarrje në konferenca apo publikime shkencore. <i>Evidenca Nr 16: Liste mobiliteti e stafit akademik</i> <i>Evidenca Nr 27: Procedura per perzgjedhjen e studenteve dhe stafit ne programin Erasmus</i> <i>Evidenca shtese: Evidence te financimit te kerkimit shkencor nga institucioni</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software” ofron një kurrikul bashkëkohore të përshtatur sipas nevojave tregut të punës duke formuar kështu profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe atë ndërkombëtar, duke pasur mundësi punësimi në fusha të ndryshme si: - Specialist në menaxhimin e sistemeve të informacionit; - Web developer; - Specialist informatike për biznesin - Zhvillues programesh - Programues - IT etj. Nga vizita në institucion dhe takimi me studentët, GVJ konstatoi se pjesa më e madhe e studentëve ishin tashmë të punësuar në institucionet partnere apo edhe në kompani të tjera. <i>Evidenca Nr 21: Plani mesimor</i>

	<i>Evidenca Nr 3: Plani i zhvillimit strategjik te UMSH-se</i> <i>Evidenca Nr 4: Strategjia e zhvillimit te programit Master Shkencor ne Informatike me Profile</i>			
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Nuk Aplikohet			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Nuk Aplikohet			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <i>- Njësia përgjegjëse angazhohet për të garantuar njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor, duke organizuar konferenca për të nxitur kërkimin shkencor të stafit akademik dhe studentëve.</i> <i>- Programi i studimit përgatit profesionistë konkurues në tregun e punës;</i> <i>- UMSH mbështet dhe angazhon përfshirjen e personelit akademik dhe studentëve në kërkimet shkencore.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë si pjesë e misionit të tij, ka krijimin, zhvillimin dhe transmetimin e njohurive përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe atij të aplikuar, si dhe inovacionit. Në një sërë dokumentash që i janë paraqitur GJV, si “Statuti i UMSH”, “Plani i Zhvillimit Strategjik UMSH”, “Strategjia e Ndërkombëtarizimit”, “Strategjia e Zhvillimit të Programit Master Shkencor në Informatikë me profile”, “Vlerësimi performancës së personelit akademik”, “Rregullorja e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë” paraqiten prioritete të tilla si: Inovacioni dhe kreativiteti i burimeve njerëzore; rritja e mbështetjes për ekselencë në mësimdhënie etj. Gjithashtu, në kuadër të orëve të hapura, të planifikuara nga departamenti, aktorë të ndryshëm nga industria apo universitetet partnere ndërkombëtare ftohen dhe ndajnë me studentët ekspertizat e tyre. Ngarkesa në auditor e studentëve është e organizuar në: - Leksione (450 orë); - Seminare (450 orë); - Ushtrime/laboratorë (n/a); - Projekte/Detyra (n/a); - Praktika (240 orë); - Diploma (30 orë); - Totali 1170 orë.

	Metodologjitë e mësimdhënies së përdorura në programin e studimit i studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”, përshkruhen në Planprogramin e lëndëve në “Kurrikulën e programit të studimit të programit”, ku përfshihen aktivitetet e mëposhtme: - Leksione në auditor; - Seminare të cilat mund të organizohen në auditor apo laborator; - Prezantime në baza javore për lëndët për lëndët e bazës së projektit; - Detyra javore; - Leksionet të hapura. Labororet, edhe pse nuk janë parashikuar në planin mësimor si orë në auditor, kryhen gjatë orëve të seminareve sipas nevojave të lëndës. Format e mësimdhënies i prezantohen studenti nga pedagogu i lëndës për secilën lëndë në fillim të semestrit. <i>Gjithsesi, GVJ i qendron rekomandimit të lënë më sipër për përfshirjen e tyre në syllabuset e lëndëve dhe rishikimin e tyre.</i> <i>Evidenca Nr 9: Permblledhese e tabelave per programin, Kreu 2</i> <i>Evidenca Nr 1: Statuti i UMSH</i> <i>Evidenca Nr 3: Plani i zhvillimit strategjik te UMSH-se</i> <i>Evidenca Nr 47: Strategjia e nderkombetarizimit</i> <i>Evidenca Nr 4: Strategjia e zhvillimit te programit master shkencor ne informatike me profile</i> <i>Evidenca Nr 32: Formulari i vleresimit te pedagogut dhe lendes nga studenti</i> <i>Evidenca Nr 33: Formular i vleresimit te pedagogut nga autoriteti drejtues</i> <i>Evidenca Nr 15: Rregullore e NJSBCZHK</i> <i>Evidenca Nr 12: Lista e aktiviteteve organizuar nga fakulteti i informatikes</i> <i>Evidenca Nr 10: Permblledhese e tabelave per programin, Tabela 13</i> <i>Evidenca Nr 21: Plani mesimor</i>
--	--

Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Mësimdhënia në programin e studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software” është kombinim i njohurive teorike me një komponent të fortë të praktikës profesionale , e cila synon të vendosë studentët në situata reale me të cilat do të ndeshen gjatë aktivitetit të tyre profesional. Programi i përgjigjet nevojës së tregut të punës për specialistë në fushën e inxhinierisë software, zhvillues programesh, mirëmbajtës rrjeti, siguria në rrjetet kompjuterike, zhvillues faqesh web, manaxhimin e sistemeve të informacionit apo informatikës për biznesin. Personeli akademik ka vëmendje të veçantë në përshtatjen e metodave të mësimdhënies në përputhje me nevojat e studentëve. Departamenti i Informatikës së Biznesit parashikon gjatë gjithë vitit akademik konsulta të vazhduara të pedagogëve me studentët për plotësimin e nevojave të tyre. Institucioni ka hartuar edhe një rregullore të posacme për studentët me aftësi ndryshe për të përmbushur nevojat e tyre. Studentët gjithashtu mund të kontaktojnë koordinatorin e tyre akademik për të vepruar si ndërmjetës në zgjidhjen e problemeve të ndryshme në kuadrin e mësimdhënies. Disa nga format kryesore të mësimdhënies që Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë përdor janë: <u>Puna në grup.</u> Stafi akademik i organizon seminarët, orët e laboratorit apo praktike në punë në grup në mënyrë që të rrisë te studentët aftësitë e bashkëpunimit dhe negocimit, shkëmbimit të eksperiencave, ndarjes së detyrave; <u>Prezantime/ekspozime publike.</u> Secilës lëndë i caktohet si kriter vlerësues edhe një detyrave e cila duhet të mbrohet me prezantim, e cila synon të përmirësojë dhe rrisë cilësinë e teknikave të prezantimit te studenti, për ta bërë atë më konkurrues në tregun e punës; <u>Leksione të hapura.</u> Universiteti vazhdimisht organizon leksione të hapura në të cilat kryen prezantime studimesh, kërkimesh apo projektsh e që më pas ndiqen nga një sesion pyetjesh dhe diskutimi nga pjesëmarrësit në aktivitet. <u>Study Visit.</u> Format e mesimdhënies në auditor integrohen me ato jashtë auditorit, në kompanitë partnere të fushës si Deloitte, Raiffaissen, ProCredit, TeamSystem, Lufthansa.
--	--

	<i>Evidenca Nr 21: Plani mesimor</i> <i>Evidenca Nr 19: Formati i shperndarjes se studenteve praktikante ne institucione</i> <i>Evidenca Nr 12: Lista e aktiviteve organizuar nga fakulteti i informatikes</i> <i>Evidenca Nr 28: Grafiku i konsultimeve</i> <i>Evidenca Nr 29: Rregullore per studentet me aftesi ndryshe</i> <i>Evidenca Nr 11: Liste e marreveshjeve te bashkepunimit</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, dhe në mënyrë të veçantë Departamenti i Informatikës së Biznesit, mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Asistimi i personelit akademik me më pak përvojë në përmirësimin e performancës së tij përbën një nga orientimet prioritare të Departamentit. Kontaktet me institucione të huaja të arsimit të lartë dhe shkëmbimi i personelit akademik (programet Erasmus+) i kanë shërbyer përmirësimit të metodave të mësimdhënies dhe rritjes së kapaciteteve didaktike. Institucioni ndjek politika të tilla, që ofron trajnime të ndryshme apo leksione të hapura për të mbështetur stafin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mësimdhënies. Stafi akademik inkurajohet duke u mbështetur financiarisht për pjesëmarrje në konferenca kombëtare/ndërkombëtare apo publikime në revista, për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe për të rritur interesin e tyre në kërkimin shkencor. Për përmirësimin e zhvillimit të procesit mesimor, Departamenti i Informatikës së Biznesit ofron infrastrukturë të konsoliduar IT për Shërbimet Mësimore duke përmendur (1) Sistemin SMS; (2) Rrjetin; (3) Shërbimet Google; (4) Mirëmbajtja e pajisjeve dhe përmirësimet e programit etj. <i>Evidenca Nr 27: Procedura per perzgjedhjen e stuateve dhe stafit ne programin Erasmus</i> <i>Evidenca Nr 16: Liste e mobiliteteve te stafit akademik</i> <i>Evidenca Nr 12: Lista e aktiviteve organizuar nga fakulteti i informatikes</i> <i>Evidenca Nr 30: Program trajnimi dhe kualifikimi</i> <i>Dokumenta shtese:</i> <i>Evidence te financimit te kerkimit shkencor nga institucioni</i>

Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Në programin e studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software” është i angazhuar në mësimdhënie staf akademik i kualifikuar, me eksperiencë akademike dhe profesionale të fituar ndër vite gjatë punës në universitete dhe në Institucione të tjera të profilit, duke sjellë eksperiencën e tyre si mësimdhënës në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë. Aplikanti për staf akademik vlerësohet për kompetencat e tij përmes plotësimit të një “Formularin e Vlerësimi” ku analizohen rezultatet shkencore, metodologjia e prezantuar, aftësitë komunikuese, arritjet e kandidatit në ekspertizën e tij/saj të mësimdhënies dhe entuziazmin e kandidatit/es. Departamenti është përgjegjës që të bëjë shpërndarjen e ngarkesës mësimore në përputhje me fushën e ekspertizës së stafit akademik. Pedagogët përdorin metoda interaktive gjatë zhvillimit të lëndëve me qëllim arritjen e bashkëpunimit, si dhe përmirësimin e njohurive duke futur edhe koncepte të reja nga fusha teknologjike dhe ajo e zbatimit të tyre për të nxitur interesin dhe vullnetin e studentëve. <i>Evidenca Nr 41: Permbledhje e procedures se rekrutimit</i> <i>Evidenca Nr 7: CV e stafit akademik ne programin e studimit</i> <i>Evidenca Nr 33: Formular i vleresimit te pedagogut nga autoriteti drejtues</i> <i>Evidenca Nr 10: Permbledhese e tabelave per programin</i> <i>Dokumenta shites:</i> <i>Një praktikë e rekrutimit të stafit akademik</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Departamenti i Informatikës kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Në këtë kuadër një rëndësi të veçantë kanë edhe sugjerimet që vijnë nga studentët dhe të diplomuarit përmes kontakteve me ta, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinatores të programit të studimit, si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes mbledhjes së opinioneve nga NJSBCZHK dhe njësia bazë nëpërmjet: - Pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor nga studentët; - Vlerësimi nga drejtuesit; - Vetëvlerësimit të pedagogëve.

	Varësisht rezultateve të pyetësorit: - Përgjegjësi i Departamentit përgatit një Raport të detajuar dhe Plan Veprimi, i cili i përcillet Zyrës së Rektoratit dhe Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave; - NJSBCZHK u vendos në dispozicion rezultatet: Njesisë Kryesore, Rektoratit dhe Zyrës së burimeve njerëzore; - Përgjegjësi zhvillon takime individuale me pedagogët vlerësimi i të cilëve është nën mesatare apo që kanë komente shqetësuese nga studentët; - Organizohen trajnime dhe seminare të ndryshme në kuadër të përmirësimit të mësimdhënies. <i>Evidenca Nr 6: Rregullore e programit Master Shkecor ne Informatike me profile</i> <i>Evidenca Nr 32: Formulari i vleresimit te pedagogut dhe lendes nga studenti</i> <i>Evidenca Nr 23: Formular i vleresimit te pedagogut nga autoriteti drejtues</i> <i>Evidenca Nr 31: Plan veprimi NJSBCZHK</i> <i>Evidenca Nr 15: Rregullore e NJSBCZHK</i> <i>Evidenca shtese: Raport permbledhes nga NJSBC i rezultateve te pyetesoreve</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë	Në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë funksionon Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë dhe e Zhvillimit të Kurrikulave. Standardet e sigurimit të cilësisë hartohen në përputhje me Manualin e Sigurimit të Brendshëm dhe Kodin e cilësisë së Arsimit të Lartë. Manuali i Sigurimit të Brendshëm miratohet nga Senati Akademik. Kjo njësi e cila është e përbërë nga 9 anëtarë, të cilët janë personel akademik me kohë të plotë dhe/ose personel ndihmës akademik dhe/ose ekspertë të fushave të ndryshme dhe një anëtar është student i një prej degëve të studimit të UMSH. Anëtarët e NJSBCZHK kanë mandat 3 vjeçar. Këto struktura promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë aktivitetet me njësinë kryesore dhe njësinë bazë në shërbim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Në këtë kuadër janë hartuar udhëzues

vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies në bazë të fushave të ndryshme të studimit dhe lëndëve specifike. Departamenti i Informatikës monitoron rregullisht procesin e mësimdhënies/mësimnxënies dhe atë të vlerësimit të studentëve dhe analizon periodikisht situatën duke propozuar përmirësime dhe duke ofruar mbështetje për stafin akademik. NJBSCZHK kryen procesin e vlerësimit të stafit akademik, stafit administrativ, vlerësimin e infrastrukturës dhe logjistikës përmes pyetësorëve drejtuar studentëve, formularëve të vlerësimit dhe vetëvlerësimit. Ky proces kryhet në nivel horizontal dhe vertikal. Departamenti harton një raport vlerësimi për stafin akademik, të cilin ia përcjell Dekanit. Me tej Dekani informon stafin akademik dhe administrativ për rezultatet. NJBSCZHK në fillim të çdo viti akademik realizon Kalendarin e Ngjarjeve dhe Aktiviteteve për të kryer trajnime të rregullta për zhvillimin profesional të stafit mësimdhënës, nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave, Zyra e Burimeve Njerëzore, me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të metodave të reja dhe inovative në mësimdhënie si dhe eksperimentimin në këtë fushë. <i>Evidenca Nr 1: Statuti I UMSH, Kreu XI, Neni 84</i> <i>Evidenca Nr 15: Rregullore e NJSBCZHK</i> <i>Evidenca Nr 30: Program trajnimi dhe kualifikimi</i> <i>Evidenca Nr 32: Formulari i vlerësimit të pedagogut dhe lendes nga studenti</i> <i>Evidenca Nr 33: Formular i vlerësimit të pedagogut nga autoriteti drejtues</i> <i>Evidenca Nr 4: Strategjia e zhvillimit të programit Master Shkencor në Informatikë me profile</i> <i>Evidenca Nr 31: Plan veprimi NJSBCZHK</i> <i>Evidenca shtese: Raport i departamentit në lidhje me përdorimin e metodave inovative nga stafi akademik</i>
Konkluzione	<i>Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Institucioni nxit dhe mbështet stafin akademik në zhvillimin e mësimdhënies me metoda bashkëkohore, në</i>

	<i>përputhje me programin e studimit, në përshtatje me tregun e punës duke e bërë programin tërheqës për studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Format e kontrollit të dijeve në Departamentin e Informatikës janë provimi me shkrim, me gojë, me detyra kursi/projekte, i kombinuar me seminare workshope, frekuentime e studime laboratorike. Pas përfundimit të procesit të regjistrimit studentët pajisen nga Zyra e Regjistrimit me “Udhëzuesin e studenteve”, me anë të së cilës informohen mbi politikën, proceset dhe mekanizmat që drejtojnë studimet e tyre. Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përcaktohen, në programin e lëndës dhe i bëhen të ditura studentëve në orën e parë të mësimi. Në rregulloren e programit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”, Rregulloren e organizimit UMSH, dhe në çdo syllabus, gjithashtu, jepet informacion i detajuar mbi format e kontrollit të dijes. <i>Evidenca Nr 34: Udhëzuesi i studenteve</i> <i>Evidenca Nr 6: Rregullore e programit Master Shkencor në Informatikë me profile</i> <i>Evidenca Nr 9: Rregullore e organizimit UMSH</i> <i>Evidenca Nr 5: Rregullore e Fakultetit të Informatikës</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e	Pedagogu i lëndës ditën e parë të fillimit të vitit akademik, informon studentët në lidhje me syllabusin e lëndës dhe mënyrën e vlerësimit, duke e ngarkuar syllabusin edhe në sistemin SMS. Informimi i studentëve me mënyrat e vlerësimit realizohet gjithashtu në klasat virtuale respektive të secilës lëndë.

lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Bazuar në rregulloren e Fakultetit të Informatikës, tezat hartohen nga titullari i lëndës së bashku me pedagogun që e ka zhvilluar lëndën. Pas përfundimit të një procesi testimi dhe vlerësimi, bëhet shpallja e vlerësimit përfundimtar nga pedagogu i lëndës shoqëruar me firmën e tij. Bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit, studenti ka të drejtën e ankimimit të notës. <i>Evidenca Nr 6: Rregullore e programit Master shkencor në Informatikë me Profil</i> <i>Evidenca Nr 35: Manual i përdorimit të platformave online</i> <i>Evidenca Nr 5: Rregullore e fakultetit të informatikës</i> <i>Evidenca Nr 37: Udhëzues për përdorimin e SMS-se</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në formë dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Në rregulloren programit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”, Rregulloren organizimit UMSH, dhe në çdo syllabus, gjithashtu, jepet informacion i detajuar mbi format e kontrollit të dijes. Secili syllabus përmban informacion si: - Emri dhe kategoria e lëndës; - Pozicioni i lëndës në afatin dyvjeçar (vit+semestër); - ECTS të lëndës dhe vlerat e krediteve; - Kategoria e lëndës (A, B, C, D apo E); - Përcaktimin nëse është lëndë e detyrueshme apo me zgjedhje; Në çdo syllabus, gjithashtu, jepet informacion i detajuar mbi format e kontrollit të dijes: - Testimet e ndërmjetme; - Detyrat; - Provimi përfundimtar; Studenti që mungon në 25% të orëve të lëndës duhet të ndjekë përsëri lëndën gjatë vitit të ardhshëm. Në total studenti/ja mund të përfitojë 100 pikë. Sistemi i vlerësimit në UMSH bëhet me sistemin me 10 nota. Për çdo vlerësim me notën nga 4 (katër) e poshtë, studenti shpallet jokalues dhe është i detyruar ta përsërisë lëndën. Për çdo vlerësim me notën nga 5 (pesë) e sipër, studenti shpallet kalues. Vlerësimi përfundimtar do të bëhet mbi bazën e pikëve të grumbulluara dhe përqindjeve përkatëse.

	GVJ konstaton që pavarësisht se sipas rregullores studenti ka të drejtën e ankimimit të notës, institucioni nuk ka paraqitur një procedurë në lidhje me ankimimin e notës. Evidenca Nr 22: Syllalbuset e lendeve te ofruara per vitin akademik Evidenca Nr 35: Manual i perdorimit te platformave online Evidenca Nr 5: Rregullore e fakultetit te informatikes Evidenca Nr 21: Plani mesimor			
Konkluzione	Institucioni përcakton në rregulloret e tij institucionale mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore. Në rregulloren e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve përcakton procedurat e testimit dhe vlerësimit të njohurive të fituara nga studentët për çdo lëndë, duke garantuar aftësimin e tyre në përputhje me objektivat e programit të studimit. GVJ rekomandon që departamenti të hartojë një procedurë në lidhje me ankimimin e notës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Referuar Rregullores së Programit të studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”, syllabuseve të lëndëve, vlerësimi përfundimtar pasqyron rezultatet e një kontrolli të vazhdueshëm, që zhvillohet detyrave të kontrollit, vlerësimin e frekuentimit dhe aktivizimit, vlerësimin për detyra e kursit, si edhe vlerësimin e kontrollit përfundimtar. Nga vizita në institucion dhe takimi me GVB, GVJ konstaton se praktika profesionale, vlerësohet mbi bazën përgatitjes dhe prezantimit të një relacioni që përgatitet nga studentët, ndërsa

	zhvillimi i saj rregullohet bazuar në udhëzimet Udhëzuesin e Praktikës Profesionale. Studenti prezanton para komisionit të vlerësimit punimin (relacionin) me tematikë të përcaktuar nga personeli akademik që ndjek Praktikën Profesionale. Komisioni i vlerësimit të praktikës së studentëve është përgjegjës për vlerësimin e njohurive të studentëve përsa i përket përmbajtjes së programit mësimor të praktikave. Komisioni gjithashtu është përgjegjës për hedhjen e pikëve dhe vlerësimin përfundimtar në SMS. Ky vlerësim kryhet me procesverbal, ku kopja origjinale e nënshkruar kalon në Sekretarinë Mësimore dhe një kopje e dytë ruhet në departament. Në këtë referim ftohen edhe subjekte private që janë të fushës që mbulon programi i studimit përkatës. Vlerësimi bëhet me notë dhe pasqyrohet në proces-verbalin përkatës. <i>Evidenca Nr 6: Rregullore e programit Master Shkencor në Informatikë me Profile</i> <i>Evidenca Nr 22: Syllabuset e lendeve të ofruara për vitin akademik</i> <i>Evidenca Nr 36: Udhëzues për provimin e ndermjetem përfundimtar dhe të sezonit perserites</i> <i>Evidenca Nr 18: Dosja e praktikës</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Institucioni nuk përdor sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, megjithatë institucioni garanton transparencë për studentët në vlerësimin e njohurive. <i>Evidenca Nr 37: Udhëzues për përdorimin e SMS-se</i> <i>Evidenca Nr 22: Syllabuset e lendeve të ofruara për vitin akademik</i> <i>Evidenca Nr 35: Manual i përdorimit të platformave online</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Departamenti i Informatikës, kujdeset që vlerësimi përfundimtar i lëndës të kryhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Në rregulloren e Organizmit UMSH, rregulloren e Fakultetit të Informatikës, dhe në çdo syllabus, gjithashtu, jepet informacion i detajuar mbi format e kontrollit të dijes: - Detyra kontrolli gjatë semestrit; - Detyrat e kursit; - Provimi përfundimtar.

	Tezat e provimeve duhet të përmbajnë pyetje përshkruese, pyetje shpjeguese dhe pyetje vlerësuese. Në total studenti/ja mund të përfitojë 100 pikë. Vlerësimi përfundimtar do të bëhet mbi bazën e pikëve të grumbulluara dhe përqindjeve përkatëse. <i>Evidenca Nr 9: Rregullore e organizimit UMSH</i> <i>Evidenca Nr 5: Rregullore e fakultetit të informatikës</i> <i>Evidenca Nr 22: Syllabuset e lendeve të ofruara për vitin akademik</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, studentëve u shfaqen pikët e marra për çdo komponent të vlerësimit dhe nota përkatëse në mënyrë të automatizuar. Pas shpalljes së rezultateve, pedagogu/ja ua komunikon rezultatet në mënyrë individuale studentëve duke u dhënë sugjerime në lidhje me pikat e tyre të dobëta. <i>Evidenca Nr 36: Udhëzues për provimin e ndërmjetëm përfundimtar dhe të sezonit përsëritës</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Në përputhje me “Kodin e Etikës”, dhe “Rregulloren e Fakultetit të Informatikës”: - Gjatë provimit nuk lejohet të komunikohet me asnjë person tjetër, përveçse me personelin akademik të lëndës; - Nuk lejohet përdorimi i celularit apo i çdo mjeti tjetër komunikimi ose regjistrimi; - Nuk lejohet përdorimi i asnjë materiali mësimor përveç materialeve të lejuara nga personeli akademik i lëndës. Personeli akademik informon studentët dhe asistuesin për materialet që studentët mund të përdorin përpara fillimit të provimit; Në rast se studenti thyen rregullat e provimit, ai ndërpret provimin dhe plotësohet procesverbali për parregullsi në provime nga personeli akademik i lëndës dhe asistuesi përkatës dhe informohet instrukturi i kursit dhe Shefi i Departamentit. Gjithashtu, procesverbalit i bashkëngjitet provimi, i cili vlerësohet me 0 pikë. UMSH për të shmangur plagjiaturën e mashtrimin, në “Udhëzues për provimet” përshkruan masat që merren për këtë shkelje disiplinore për projektet apo tezat e diplomave bachelor e master. Për parandalimin e plagjiaturës universiteti përdor softuerin <i>Turnitit</i>.

	<i>Evidenca Nr 2: Kodi i Etikes, Neni 7</i> <i>Evidenca Nr 5: Rregullore e Fakultetit te Informatikes</i> <i>Evidenca Nr 36: Udhezues per provimin e ndermjetem perfundimtar dhe te sezonit perserites</i> <i>Dokumenta shtese: Evidence mbi kontrollin e pronesise intelektuale te temave te diplomave</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Bazuar në “Udhëzuesin për provimin e ndërmjetëm, përfundimtar dhe të sezonit përsëritës”, vlerësimi i provimeve dhe dijeve të studentëve afishohen në një periudhë brenda tre ditësh nga data e kryerjes së provimit. Sekretaria pasi bën ç’sekretimin e provimeve dhe hedh pikët në listën e studentëve pjesëmarrës në provim, ia dorëzon procesverbal dhe me siglim të Kryesekretares bashkë me tezat e provimit, pedagogut titullar të lëndës brenda 2 ditëve. Personeli akademik i hedh notat në Sistemin e Menaxhimit të Studentit (SMS), brenda dy ditëve pas afatit të korigjimit, pikët për frekuencimin, pikët e provimeve të ndërmjetme/detyrave të kursit dhe pikët e provimit përfundimtar. <i>Evidenca Nr 36: Udhezues per provimin e ndermjetem perfundimtar dhe te sezonit perserites</i> <i>Evidenca Nr 37: Udhezues per pedorimin e SMS-se</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Nëpërmjet sistemit SMS, në llogarinë personale të studentëve ngakohet vlerësimi për rezultatin paraprak të provimit në kohë reale. Para hartimit të procesverbalit përfundimtar studenti ka të drejtë që informohet mbi vlerësimin e tij në seancat informuese që cakton pedagogu i lëndës. Sipas rregullores së fakultetit, Neni 42, Rregullores se organizimit te UMSH, Neni 67, dhe Udhezuesit te studenteve, studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimin përfundimtar duke dorëzuar një ankesë, e cila dorëzohet në sekretari dhe drejtohet me shkrim Dekanit jo më vonë se 2 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve. Dekani verifikon situatën nëse ka patur një gabim në vlerësim ose gjatë shënimit të notës. Dekani ngre një komision për rishikimin e tezës ose e rimerr studentin në provim. Në rregulloren e programit të studimet, Neni 23, parashikohet e drejta e ankimimit të studentit vetëm për shkelje të rregullave

	të provimit, por nuk parashikohet një procedurë për ankimim të rezultatit të provimit. GVJ sugjeron që në rregulloret institucionale dhe në Udhëzuesin për Provimin të përcaktohen qartë rregullat e komunikimit të notës, të ankimimit për shkelje të rregullave të provimit dhe procedura e ankimimit për rezultatin perfundimtar. Këto rregulla e procedura të jenë të qarta, të kuptueshme dhe lehtësisht të aksesueshme nga studentët. <i>Evidenca Nr 34: Udhëzues i studenteve</i> <i>Evidenca Nr 6: Rregullore e programit Master Shkencor në Informatike me profile, Neni 23</i> <i>Evidenca Nr 5: Rregullore e Fakultetit të Informatikës, Neni 42</i> <i>Evidenca Nr 9: Rregullore e organizimit UMSH, Neni 67</i> <i>Evidenca Nr 37: Udhëzues për përdorimin e SMS-se</i>			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Për programin e studimit Master Shkencor në Informatikë me profile a) Inxhinieri Software b) Sisteme Informacioni në Biznes nuk ka pasur asnjë rast ankimimi.			
Konkluzione	<i>Departamenti i Informatikës në rregulloren e programit të studimit përcakton procedura të qarta dhe transparente të vlerësimit të njohurive të studentëve të bazuara në meritë, si dhe ju jep mundësinë studentëve të ankimojnë vlerësimin, duke ngritur komisione ad hoc për shqyrtimin e ankimimit.</i> <i>Institucioni kujdeset në zhvillimin e aktiviteteve vlerësuese të dijeve me korrektesë, duke mos pranuar kopjen dhe plagjiaturën nga ana e studentëve.</i> GVJ sugjeron që në rregulloret institucionale dhe në Udhëzuesin për Provimin të përcaktohen qartë rregullat e komunikimit të notës, të ankimimit për shkelje të rregullave të provimit dhe procedura e ankimimit për rezultatin perfundimtar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit i ciklit të dytë <i>Master Shkencor</i> në Informatikë me profile a)Inxhinieri Software b)Sisteme Informacioni në Biznes, siç dëshmohej edhe në “Kurrikulat” e lëndës dhe “Strategjinë e Zhvillimit të Programit” ka për mision: – T’u ofrojë studentëve mundësinë që të marrin dhe zhvillojnë dijet, si dhe aftësitë e tyre profesionale në fushën informatike dhe ekonomike; – Të nxisë tek studentët të menduarit dhe analizuarit kritik për të kuptuar sfidat në situata të ndryshme të zhvillimit të softuereve, të njohjes me algoritmat e avancuara, aspektet e sigurisë së informacionit, programimit, “machine learning”, sistemeve të informacionit, menaxhimit të projekteve etj; – Të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme për të zbatuar në mënyrë efektive aftësitë teknike dhe logjistike në fushën e programimit, inxhinierisë së softuerit, rrjetave kompjuterike, inteligjencës artificiale, informatikës në biznes. <i>Evidenca Nr 21: Plani mesimor</i> <i>Evidenca Nr 4: Strategjia e zhvillimit te progarmit Master Shkencor ne Informatike me profile</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Natyrë e kompetencave të kërkuara në programin e studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”, garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, komunikimit dhe ndërveprimit social duke qenë se sektori informatik është në mënyrë të pashmangshme i lidhur me rrjetin ndërkombëtar, kërkon njohje të gjuhës së huaj, si dhe një komunikim intensiv duke shfrytëzuar elementë të avancuar të teknologjisë së informacionit. Për më tepër plani mësimor ofron lëndë si: “Menaxhim Projektsh”, “Komunikim i të dhënave” apo “Praktika” të cilat e ndihmojnë studentin në

	përmirësimin e aftësive të komunikimit dhe ndërveprimit. Gjithashtu, roli që ka inxhinieria software për zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të reja, apo fakti që sistemet e informacionit përbëjnë në nga mjetet kryesore në dispozicion të menaxherëve të biznesit dhe organizatave, ndihmon studentët në përmirësimin e vendimmarrjes dhe të qenit konkurrues. <i>Evidenca Nr 21: Plani mesimor</i> <i>Evidenca Nr 22: Syllabuset e lendeve të ofruara për vitin akademik</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Gjatë orëve të fundit të mësimi, studentët dorëzojnë detyrat e kursit, punët e laboratorëve, apo zhvillojnë seanca përmbledhëse ushtrimesh, përmes të cilave testojnë njohuritë e marra dhe vetëvlerësojnë përgatitjen e tyre përpara provimit përfundimtar. Në fund të lëndës, bëhet një përmbledhje e argumentave kryesorë dhe diskutim i situatave reale mbi temat e trajtuara. Stafi akademik i Departamentit të Informatikës së Biznesit, si pjesë e Fakultetit të Informatikës kryen procesin e rishikimit të çdo plan programi, në përfundim të çdo semestri akademik me qëllim përmirësimin e kurrikulave sipas kërkesave të tregut. Ky proces menaxhohet nga Departamenti dhe Fakulteti. <i>Evidenca Nr 28: Grafiku i konsultimeve</i> <i>Evidenca Nr 6: Syllabset e lendeve të ofruara për vitin akademik</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet	Kurrikula e programit të studimit <i>Master i Shkencave</i> në Informatikë me profile a) Inxhinieri Software b) Sisteme Informacioni në Biznes është hartuar duke ndërthurur orët teorike në auditor me orët praktike në laboratore, dhe praktikën mësimore, duke mundësuar zhvillimin tek studentët e kompetencave profesionale në fushën e shkencave kompjuterike. Një pjesë e detyrave të kursit zhvillohen në grup, me qëllim nxitjen e punës në grup, aftësimin në ndarjen e detyrave, ballafaqimin e rezultateve dhe diskutimin e tyre. Duke organizuar aktivitete të ndryshme si konferenca studentore, bashkëpunim pedagog student në kuadër të kërkimit shkencor, workshope, "hackathone", etj, UMSH nxit dhe zhvillon njohuritë inovative të studentëve. Studentët kanë akses në infrastrukturën e nevojshme si: - Infrastruktura në Funksionin e Programit të Studimit;

ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	- Shërbimet e Bibliotekës; - Shërbimet IT. Bashkëpunimet e Departamentit të Informatikës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar kontribuojnë në rritjen e mobiliteteve dhe shkëmbimin e eksperiencave me Institucionet partnere. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ai brenda vendit kontribon për rritjen e mobiliteteve dhe shkëmbimin e eksperiencave. GJV vlerëson kontributin që institucioni jep në kuadër të praktikave profesionale dhe mbështetjen për projekte kërkimore shkencore. <i>Evidenca Nr 21: Plani mesimor</i> <i>Evidenca Nr 12: Lista e aktiviteteve organizuar nga Fakulteti i Informatikës</i> <i>Evidenca Nr 38: Relacioni i godines</i> <i>Evidenca Nr 43: Manual mbi perdorimin e bibliotekes online</i> <i>Evidenca Nr 11: Liste e marreveshjeve te bashkepunimit</i> <i>Dokumentas shtese:</i> <i>Evidenca Nr 47: Strategjia e Nderkombetearizimit</i> <i>Dokumenta shtese:</i> <i>Inventari per infrastrukturen e laboratoreve qe mbeshtesin kete program studimi</i> <i>Lista e librave (elektronike ose fizike) ne dispozicion te ketij programi studimi</i> <i>Procedure per mobilitet Erasmus nga studente te ketij programi studimi</i> <i>Model marreveshje bashkepunimi me kompani institucione</i>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Departamenti i Informatikës zhvillon vazhdimisht leksione të hapura me stafin e tij akademik dhe me staf të ftuar duke sjellë tek studentët zhvillimet më të fundit në fushën e shkencave kompjuterike, brenda dhe jashtë vendit. Duke konsideruar faktin që një ndër pikat kyçe të MoU që UMSH ka nënshkruar me partnerët e tij është organizmi i leksioneve të hapura periodikisht dhe seminareve të organzuara nga drejtorërt ekzekutivë të këtyre institucioneve, e bën më të lehtë ekspozimin e vazhdueshëm të studentëve në ide e teknologji inovative. Organizimi i ketyre aktiviteteve organizohet në nivel departamenti dhe fakulteti çdo fillim viti akademik.

	<i>Evidenca Nr 20: Raport vjetor i UMSH</i> <i>Evidenca Nr 16: Liste e mobilitetit te stafit akademik</i> <i>Evidenca Nr 11: Liste e marreveshjeve te bashkepunimit</i> <i>Evidenca Nr 12: Lista e aktiviteteve organizuar nga Fakulteti i Informatikes</i> <i>Dokumenta shtese: Evidence te financimit te kerkimit shkencor nga institucioni</i>			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	UMSH, në kuadër të zhvillimit të ideve inovative dhe studimeve të përparuara kërkimore, ofron suport financiar dhe infrastrukturor në disa drejtime: - Mbështet studentët duke u vënë në dispozicion pajisje më të avancuara për prodhim dixhital; - Asistencë teknike dhe “know-how”; - Duke ofruar trajnime në fushën e inovacionit; - Duke ofruar skema bashkëzhvillimi dhe bashkëfinancimi të projekteve më premtuese. Disa studentë të programit <i>Master i Shkencave</i> në Informatikë me profile a) Inxhinieri Software b) Sisteme Informacioni në Biznes janë të angazhuar në projekte të Departamentit. https://sites.google.com.umsh.edu.al/iscumsh-2023/home			
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master i Shkencave në Informatikë me profile a) Inxhinieri Software b) Sisteme Informacioni në Biznes është hartuar duke ndërthurur orët teorike në auditor me orët praktike në laboratore, dhe praktikën mësimore, duke mundësuar zhvillimin tek studentët e kompetencave profesionale në fushën e shkencave kompjuterike.</i> <i>Njësia bazë dhe ajo kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, janë të angazhuar në rritjen e cilësisë në tërësi të ofertës akademike duke realizuar në mënyrë të vazhduar takime, seminare, workshop-e, në kuadër të bashkëpunimeve dhe në motivimin e studentëve drejt tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Në rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software” përcaktohet procedura për zhvillimin e mbrojtjes së diplomës, në të gjitha fazat: aplikimi i temës së diplomës, miratimi i temës, përcaktimin e pedagogut udhëheqës si edhe planit të realizimit të saj. Që një student të kualifikohet në procesin e diplomimit duhet që ai: - Në fillim të semestrit të dytë të vitit akademik të paraqesë kërkesën/propozimin për temë e cila miratohet nga Dekani, nëse studenti ka shlyer detyrimet përkatëse; - Të kryejë konsultimet e paracaktuara gjatë procesit të kryerjes së diplomës ; - Të realizojë me sukses Kontrolllet nga Komisioni; - Të dorëzojë punimin final. Procedura në lidhje me detyrimeve përveçse janë të përcaktuara në Rregulloren e Përgjithshme dhe në Udhëzuesin e përgatitjes së Punimit të Diplomës. Studentët që janë në prag diplomimi, informohen gjithashtu edhe me email. <i>Evidenca Nr 6: Rregullore e programit Master Shkencor në Informatikë me profile</i> <i>Evidenca Nr 23: Udhëzues për përgatitjen e punimit të diplomës</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Përfundimi i studimeve të ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”, konkludojnë me mbrojtje teme diplome në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 8012015, datë 22.07.2015, Satutin e UMSH, Rregulloren e UMSH si e dhe udhëzuesin e mbrojtjes së punimit të diplomës. Departamenti i Informatikës përcakton listën e temave të diplomave (Projektin e Diplomimi) në fillim të semestrit të dytë të vitit akademik. Studenti asistohet rregullisht duke iu ofruar informacioni, udhëzimet dhe materialet e nevojshme në kuadër të kërkesave të

	përmbylljes nga departamenti, koordinatori i programit e nga udhëheqësit e diplomave të cilët ndjekin studentët në metodologjinë e përdorur, bazat teorike dhe zhvillimin e temës. <i>Evidenca Nr 1: Statuti i UMSH</i> <i>Evidenca Nr 9: Rregullore e Organzimit UMSH</i> <i>Evidenca Nr 23: Udhëzues për përgatitjen e punimit të diplomes</i> <i>Evidenca shtese:</i> <i>Evidence mbi kontrollin e pronesise intelektuale te temave te diplomave</i> <i>Lista e pedagogeve me fushat e ekspertizes dhe temat qe i jane vene ne dispozicion studenteve</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Nuk është e aplikueshme pasi bazuar në aktet rregullatore institucionale ky program studimi mbyllet me mbrojtjen e temës së diplomës.
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmblyës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Fakulteti i Informatikës ka hartuar një procedurë për përzgjedhjen e temës së diplomës nga ana e studentëve. Filozofia e fakultetit është e tillë që në fillim të semestrit të dytë të vitit të dytë akademik studentët propozojnë vetë fushat e tyre të interesit në lidhje me temat e diplomave të cilat duhet të jenë në përputhje me axhendën e kërkimit shkencor. Në këtë mënyrë i lihet hapësirë studentit për shfaqjen e ideve të reja. Më tej në bashkëpunim me mentorin udhëheqës që përputhet me ekspertizen e nevojshme, studenti kryen punimin e temës së diplomës sipas standarteve kërkuara nga institucioni. Udhëheqësi ndihmon studentin në zhvillimin e idesë fillestare, kryerjen e studimit të literaturës, përcaktimin e metodologjisë, implementimin dhe testimin e rezultateve. Procesi i paraqitjes përfundimtare të temës së diplomës përcaktohet në “Udhëzuesin për përgatitjen e punimit të Diplomës”. <i>Evidenca Nr 23: Udhëzues për përgatitjen e punimit të diplomes</i> <i>Dokumenta shtese:</i>

	<i>Lista e pedagogeve me fushat e ekspertizes dhe temat qe i jane vene ne dispozicion studenteve</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Departamenti i Informatikës vë në dispozicion të gjithë infrastrukturën shkencore për të inkurajuar studentët drejt kërkimit shkencor, praktikave, kryerjeve të implementimeve apo testimeve të ndryshme në lidhje me shkencat kompjuterike, inxhinierinë software, rrjetave kompjuterike, sistemeve të informacionit. Infrastruktura shkencore e ofruar përfshin: - Infrastruktura në funksion të programit të studimit; - Shërbimet e bibliotekës; - Shërbimet e IT-së; - Aksesit në burime online të revistave shkencore; - Programe softuerike specifike të nevojshme për lëndët e tyre. <i>Evidenca Nr 43: Manual mbi perdorimin e bibliotekes online</i> <i>Evidenca Nr 44: Kerkese per libra</i> <i>Dokumenta shtese:</i> <i>Inventari per infrastrukturen e laboratoreve qe mbeshtesin kete program studimi</i> <i>Liste soft qe perdoren per kete program studimi</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Bazuar në “Udhëzues për përgatitjen e punimit të Diplomës” dhe “Rregulloren e Organizmit UMSH” diploma ka 18 ECTS, dhe në përfundim të mbrojtjes së saj studenti merr vlerësimin përfundimtar (maksimumi 100 pikë) të saj bazuar në 3 komponentë kryesore: 1. Vlerësimi i oponentit; 2. Vlerësimi i udhëheqësit; 3. Vlerësimi i komisionit të diplomës. <i>Evidenca Nr 9: Rregullore e organizmit UMSH</i> <i>Evidenca Nr 23: Udhëzues per pergatitjen e diplomes</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në	Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomë Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software” në Fakultetin e Informatikës, të Universitetit UMSH, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Studentit me kërkesë të tij i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit. Bazuar në Rregulloren për

dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	studimet universitare, studenti i cili ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka mbrojtur diplomën, pajiset me: - Diplomën përkatëse; - Suplementin e diplomës; - Certifikata e notave; - Katalogu i përshkrimit të lëndëve. Diploma nënshkruhet me shkrim dore duke shënuar emrin, mbiemrin, gradën dhe titullin shkencor nga Dekani i Fakultetit të Informatikës përgjegjës për programin e studimit dhe nga Rektori i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë Me tej diploma vulozet me vulën e njomë të UMSH. <i>Evidenca Nr 9: Rregullore e organizmit UMSH</i> <i>Evidenca Nr 39: Suplementi I Diplomes</i> <i>Evidenca Nr 40: Model diplome</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Fakulteti i Informatikës ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit në një arkivë fizike dhe elektronike, dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen. Dorëzimi i diplomave kryhet me Ceremoni publike ku marrin pjesë autoritete të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë dhe autoritete të tjera të fushës. Sekretaria mësimore arkivon të dhënat në procesverbalet përkatëse të notave, regjistrin fizik të notave dhe në sistemin elektronik të UMSH. Te dhënat arkivohen në formë të veçantë për çdo program studimi në vite.
Konkluzione	<i>Në rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në "Informatikë", me profile "Sistemet e Informacionit në Biznes" dhe "Inxhinieri Software" përcaktohet procedura për zhvillimin e provimit të gjithëpërfshirës përfundimtar/mbrojtjes së diplomës. Në bazë të kriterit të përmbylljes së të gjitha detyrimeve të planit mësimor, 70ire70nt ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës me mbrojtjen e një teze diplome.</i> <i>Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomë "Master i Shkencave" në Informatikë me profile a)Inxhinieri Software b)Sisteme Informacioni në Biznes, të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</i>

	<i>Studentit me kërkesë të tij i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe kompani private janë realizura nga Departamenti i Informatikës së Biznesit, Fakulteti Informatikës dhe Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë në kuadër të realizmit të praktikave profesionale të studentëve. Njësia bazë është përgjegjëse për ndërtimin dhe respektimin e lëndës së Praktikës duke: - Garantuar zgjedhjen dhe kontaktimin e institucioneve që janë më pranë programit të studimit dhe që u vlejné studentëve; - Vënë në dispozicion të studentëve listën e institucioneve që UMSH ka marrëveshje; - Miratuar tabelën e shpërndarjes së studentëve në institucioneve; - Kontrolluar të gjitha vizitat e studentëve në institucione nëpërmjet pedagogëve përgjegjës të praktikës; - Shpërndarë dhe grumbulluar formatet që formojnë dosjen e praktikës, të cilën studenti e dorëzon të plotësuar te pedagogu përgjegjës, jo më larg se një javë para daljes para komisionit të mbrojtjes së Praktikës; - Caktuar anëtarët e komisionit për mbrojtjen e praktikës. <i>Evidenca Nr 11: Lista e marreveshjeve te bashkepunimit</i> <i>Evidenca Nr 17: Lista e pedagogeve qe monitorojne praktikat profesionale</i> <i>Evidenca Nr 18: Dosja e praktikës</i>

	<i>Evidenca Nr 19: Formati I shperndarjes se studenteve praktikante ne institucione</i> <i>Dokumenta shtese: Lista e marreveshjeve me kompanite ku studentet e ketij programi realizojne praktiken mesimore</i>
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më 72ire të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Nuk aplikohet.
Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Bazuar në ‘Rregulloren e programit të studimit Master Shkencor në Informatikë me Profile’ dhe ‘Dosjen e Praktikës’, praktika profesionale realizohet me disa faza vlerësimi: - Hartimi i një raporti mbi eksperiencën e fituar; - Vlerësimi nga personi përgjegjës i praktikave në institucion; - Formulari i vetëvlerësimit të studentit; - Vlerësimi nga pedagogu udhëheqës. Të gjitha këto dokumenta dorëzohen përpara komisionit të vlerësimit të praktikave ditën e mbrojtjes së tyre, dhe ruhen në departament. Komisioni i vlerësimit ka për detyrë të hedhë notat në SMS. Praktika profesionale është e planifikuar në planin mësimor të programit të studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”, dhe ekuivalentohet me 12 ECTS, të përkthyer në 300 orë pune për studentin, të shtrira në semestrin e katërt të studimeve master. <i>Evidenca Nr 18: Dosja e praktikës</i> <i>Evidenca Nr 6: Rregullore e programit Master Shkencor ne Informatike me Profile</i> <i>Evidenca Nr 21: Plani mesimor</i>

Konkluzione	Në rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në "Informatikë", me profile "Sistemet e Informacionit në Biznes" dhe "Inxhinieri Software" përcaktohet përcaktohet procedura për mbrojtjen e diplomës. Studenti ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës me mbrojtjen e një teze diplome pasi ka përfunduar të gjitha detyrimet e lëndëve të tjera në planin mësimor. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomë Master i Shkencave në "Informatikë", me profile "Sistemet e Informacionit në Biznes" dhe "Inxhinieri Software", në Fakultetin e Informatikës, të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Studentit me kërkesë të tij i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1			
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat	Kriteri, "Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie ka së paku kualifikim të ciklit pasardhës", plotësohet nga stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi.		
		2022-2023	2023-2024

	Kualifikimi i stafit akademik të PS	PAE	PAK	PAE	PAK
	Prof. Dr	3	1	4	1
	Prof. Asoc.	1	-	1	-
	Dr/Phd	7	-	9	-
	Dr. Në proces	-	-	-	-
	Msc.	-	-	-	-
	Gjithsej	11	1	14	1

Nga analiza e të dhënave të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi dhe bazuar në të dhënat e paraqitura në Tabelat 6.1 dhe 6.2, GVJ konstaton se në vitin akademik 2022 – 2023, 91% e stafit akademik të angazhuar është staf akademik efektiv dhe 9% është staf akademik me kontratë. Në vitin akademik 2023 – 2024, 93% e stafit akademik te angazhuar është staf akademik efektiv dhe 9% është staf akademik me kontratë.

GVJ konstaton se të dhënat numerike të stafit akademik në tabelat 6 dhe 12 në lidhje me stafin akademik me kontratë nuk korespondojnë. Megjithatë, pavarësisht kësaj mospërputhjeje, mbi 90% e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit është staf akademik efektiv dhe kriteri ligjor plotësohet. GVJ rekomandon institucionin të bëjë kujdes të shtuar në kontrollin e saktësisë së të dhënave të paraqitura.

Evidenca Nr 10: Permbledhese e tabelave per programin; Tabela 6.1; Tabela 6.2, Tabela 12.

Evidenca Nr 7: CV e stafit akademik ne programin e studimit;

| **Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. | Ngarkesa e orëve mësimore për dy vite akademike është si më poshtë: | Viti | Total orësh | PAE | PAK | PAE/PAK (%) | |-----------|-------------|-----|-----|-------------| | 2022-2023 | 660 | 540 | 120 | 81% / 19% | | 2023-2024 | 1080 | 108 | 0 | 100 % / 0% | Bazuar në evidencën tabelat përmbledhëse (tabela 12) për dy vitet akademike 2022-2023 dhe 2023-2024, GVJ konsaton që ngarkesa mësimore është realizuar në masën mbi 70 % nga personeli akademik efektiv (PAE), sipas ligjit në fuqi. | | | | |

	<i>Evidenca Nr 10: Permbledhese e tabelave per programin, Tabela 12</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	GVJ konstaton se në vitet e fundit ka patur qëndrueshmëri të personelit akademik me kategorinë Lektor të angazhuar në programin e studimit. Nga takimet me përfaqësues të sektorit të Burimeve Njerëzore, GVJ u informua se personeli akademik me kohë të plotë i angazhuar në programin e studimit lidh kontratë pune me afat të caktuar për kategorinë Asistent Lektor dhe me afat të pacaktuar për kategorinë Lektor sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. UMSH garanton dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore të personelit akademik të punësuar. Personeli akademik me kontratë angazhohet mbi bazën e kontratave vjetore ose semestrale. <i>Takim me zyrën e Burimeve Njerëzore në Institucion;</i> <i>Dokument Shtese: Nje kontrate pune tip per staf akademik te brendshem dhe nje staf akademik te jashtem</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	UMSH ka përcaktuar në Statutin (Kreu VII – Punësimi në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë) dhe Rregulloren e Organizimit (Kreu V, Neni 39, 40) të tij procedurat për rekrutimin e personelit në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, VKM për stafet akademike, Kodi i Punës, aktet nënligjore të MAS. Zyra e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për zbatimin e procedurave të rekrutimit të personelit. GVJ verifikoi se kuadri rregullativ i UMSH përmban procedura transparente të rekrutimit dhe të vlerësimit të personelit. Kjo mënyrë siguron që kandidatët të plotësojnë kushtet dhe të jenë në nivelin e duhur të kualifikimeve në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. <i>Evidenca Nr 1: Statuti i UMSH - Kreu VII, Neni 57, 58</i> <i>Evidenca Nr 9: RREGULLORE E ORGANIZIMIT UMSH - Kreu V, Neni 39, 40</i> <i>Evidenca Nr 41: PERMBLEDHJE E PROCEDURES SE REKRUTIMIT</i> <i>Dokument Shtese: Një praktikë e rekrutimit të stafit akademik</i> <i>Dokument Shtese: Nje kontrate pune tip per staf akademik te brendshem dhe nje staf akademik te jashtem</i> <i>Takim me zyrën e Burimeve Njerëzore në Institucion;</i>

	https://www.umsh.edu.al/d/492/konkurs-per-vende-pune-prane-universitetit-mesdhetar-i-shqiperise
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, UMSH ka në strukturën e tij 1 (një) staf ndihmës akademik me përshkrimin “Specialist i rrjetit kompjuterik” (sipas Evidenca nr 8) i cili angazhohet në instalimin dhe testimin e software dhe hardware në institucion, garantimin e sigurisë dhe privatësisë së rrjeteve kompjuterike, mirëmbajtja e sistemeve kompjuterike dhe mbështetje teknike e përdoruesve. GVJ konstaton që stafi ndihmës akademik (laborant) ka kualifikimin e duhur, por ky rol duhet të kryejë aktivitete në mbështetje të studentëve gjatë seancave laboratorike, praktikave mësimore dhe zhvillimit të temave të diplomave, bazuar në Statutin e UMSH, Neni 59 dhe Rregulloren e Programit të Studimit, Neni 11. Gjatë vizitës në UMSH, GVJ vlerëson pozitivisht angazhimin me përkushtim të stafit akademik efektiv në mbështetje të procesit mesimor për realizimin e orëve laboratorike, praktikave mësimore dhe temave të diplomave. <i>Evidenca Nr 20: Raport Vjetor i UMSH</i> <i>Evidenca Nr 8: CV E STAFIT NDIHMES NE PROGRAMIN E STUDIMIT</i> <i>Evidenca Nr 6: RREGULLORE E PROGRAMIT MASTER SHKENCOR NE INFORMATIKE ME PROFILE</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ zhvilloi takim me përfaqësuesin e Zyrës së Burimeve Njerëzore. Gjatë këtij takimi dhe në bazë të dokumentacionit që u vu në dispozicion, GVJ konstaton se institucioni disponon dokumentacion për çdo anëtar të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe personelit ndihmës mesimor dhe administrativ të angazhuar në këtë program studimi. Bazuar në dokumentacionin e dërguar nga institucioni, GVJ konstaton parregullsi në Tabelat përmbledhëse në lidhje me stafin akademik me kontratë: PAK në Tabelat 6.1 dhe 6.2 është i ndryshëm nga PAK që figuron si lektor i lëndëve në tabelën 12. GVJ sugjeron bashkërendim më të mirë të punës së Burimeve Njerëzore me njësitë bazë në fakultete në lidhje me përditësimin e të dhënave të stafit akademik të angazhuar në programin e studimit. Sipas RVB, çdo vit përditësohen CV e pedagogëve ku pasqyrohen veprimtaritë kërkimore, publikimet dhe konferencat shkencore ku

	ai/ajo merr pjesë dhe plotësohen formularët e vetvlerësimit mbi progresin shkencor dhe akademik. Njësia bazë dhe ajo kryesore hartojnë cdo vit analizën vjetore në të cilën bëhet vlerësimi i performancës dhe pasqyrohet progresi i stafit akademik. <i>Materiali RVB</i> <i>Evidenca Nr 10: Permbledhese e tabelave per programin; Tabela 6.1, 6.2, 12</i> <i>Evidenca nr 7: CV E STAFIT AKADEMIK NE PROGRAMIN E STUDIMIT</i> <i>Dokumenta shitese: Lejet nga institucioni ku punojne per pedagoget e jashtem per 2 vite akademike</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	UMSH ka lidhur një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me industrinë, biznesin, dhe institucione të tjera të arsimit të lartë për të përmbushur objektivat e lëndëve praktike të planit mësimor të programit të studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”. Praktika mësimore zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të 2-të me 6 kredite ECTS dhe bazohet në bashkëpunime me kompanitë të ICT në vend si: EasyPay, InfoSoft, Deloitte Audit Albania, Digitalb, Instat, etj. Institucioni cakton personel akademik të brendshëm për ndjekjen si të praktikave mësimore ashtu dhe temave të diplomave. Bazuar në Dosjen e Praktikës, Zyrës së Keshillimit të Karrierës ka në kompetencat e saj parapërgatitjen e studentëve për procesin e praktikave profesionale dhe dhënien e informacionit dhe asistencës së nevojshme për gjetjen e mundësive për kryerjen e praktikave profesionale/internshipeve të ofruara nga institucionet partnere. Njësia bazë është përgjegjëse për mbarëvajtjen e praktikave profesionale dhe zhvillimit të temave të diplomave dhe koordinimin me institucionet me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi. <i>Evidenca Nr 11: Liste e marreveshjeve te bashkepunimit</i> <i>Evidenca Nr 18: Dosja e praktikës</i> <i>Evidenca Nr 20: Raport vjetor i UMSH (sesioni Bashkepunime)</i> <i>Dokumenta shitese: Lista e marreveshjeve me kompanite ku studentet e ketij programi realizojne praktiken mesimore</i> <i>Dokumenta shitese: Model marreveshje bashkepunimi me kompani institucione</i>

Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Në kuadrin e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe sipas Dosjes së praktikave profesionale drejtuesit e bizneseve, japin udhëzime me vlerë për studentët në kuadër të praktikës profesionale, bëjnë rekomandime dhe vlerësime, duke plotësuar formularët e dërguar nga ana e UMSH për ndjekjen e zhvillimin e praktikës nga studentët. Për vlerësimin me notë të praktikës profesionale, studenti Master vlerësohet në bazë të dosjes së plotësuar e cila përmban dokumentat si më poshtë: – Formati i vlerësimit të praktikës nga Pedagogu Përgjegjës – Formati i Vlerësimit të Praktikës Mësimore nga Personi Përgjegjës pranë Institucionit. – Formati i Vlerësimit të Studentit për Performancën e tij gjatë Zhvillimit të Praktikës – Formati i Raportit të Studentit në Përfundim të Praktikës Njësia bazë cakton komisionin për vlerësimin e praktikës i cili vlerëson studentët me notë bazuar në dosjen e praktikës për secilin student. <i>Evidenca Nr 17: Lista e pedagogeve qe monitorojne praktikat profesionale</i> <i>Evidenca Nr 18: Dosja e praktikës</i> <i>Evidenca Nr 19: Formati i shperndarjes se studenteve praktikante ne institucione</i> <i>Dokumenta shtese: Lista e pedagogeve me fushat e ekspertizes dhe temat qe i jane vene ne dispozicion studenteve</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se: - personeli akademik, i angazhuar në programin Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit dhe realizimin e procesit mësimor. Fusha kërkimore e personelit akademik është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve. - Ngarkesa mësimore realizohet në masën mbi 90 % nga staf akademik efektiv. - Rekrutimi i personelit akademik kryhet nëpërmjet procedurave të mirëpërcaktuara dhe të pasqyruara në aktet rregullatore të UMSH.

	- stafi akademik mbështet procesin mesimor për realizimin e orëve laboratorike, praktikave mësimore dhe temave të diplomave. - Institucioni ka lidhur një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me industrinë, biznesin, dhe institucione të tjera të arsimit të lartë për të përmbushur objektivat e lëndëve praktike, zhvillimin e orëve laboratorike dhe temave të diplomave. GVJ rekomandon që IAL të përditësojë rolin e stafit ndihmës-akademik (laborant) sipas përshkrimit të punës që ky rol ka në Statutin e UMSH, Neni 59 dhe Rregulloren e Programit të Studimit, Neni 11.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Për realizimin e procesit mesimor, në UMSH, janë vënë në dispozicion ambientet e duhura për zhvillimin si të leksioneve e seminareve ashtu edhe të seancave laboratorike për programin e studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”. Institucioni disponon 3 laboratorë informatike dhe 2 laboratorë për lëndët, me pajisje kompjuterike në dispozicion të procesit mesimor. Nga vizita në institucion dhe nga dokumentacioni i paraqitur, GVJ konstaton se ambientet e zhvillimit të mesimit janë të mjaftueshme, me kushte të mira, dhe të kompletuar me pajisje të viteve të fundit ku janë instaluar software e duhur për zhvillimin e procesit mesimor. Institucioni vë në dispozicion të studentëve edhe 1 sallë për aktivitete promovuese, 1 sallë interneti, mjedise shlodhëse si dhe zyra për stafin, bibliotekën dhe 1 zyrë informacioni për studentë. Postet fizike të punës në secilin laborator janë si më poshtë: – Lab C3 : 19 poste pune

- Lab C4 9 poste pune
- Lab 102: 18 poste pune
- Lab 103: 17 poste pune
- Lab 104: 16 poste pune

Numri i studentëve për programin e studimit sipas Tabelës përmbledhëse të dërguar nga institucioni është:

Profili	2022 - 2023	2023 -2024
<i>Inxhinieri Software</i>	66 studentë	40 studentë
<i>Sisteme Informacioni në Biznes</i>	30 studentë	51 studentë

Në Rregulloren e Departamentit të Informatikës së Biznesit, Neni 15, përcaktohet që: “Leksionet zhvillohen mbi bazë kursi deri në 6 grupe studentësh, seminarët deri në grupe deri 35 studentë dhe laboratorët në grupe deri 25 studentë”. ***Institucioni nuk ka paraqitur evidence në lidhje me ndarjen e studentëve në grupe.***

GVJ konstatoi që ndarja e studentëve në grupe mësimore është realizuar sipas profilit të studimit dhe nuk merr parasysh kapacitetin e laboratoreve, rregulloren e DIB dhe legjislacionin në fuqi i cili kërkon ndarjen e studentëve në grupe të vogla 20 – 25 studentë për zhvillimin sa më efektiv të orëve laboratorike dhe seminarëve. Në shkresën përcjellëse të UMSH në lidhje me ndarjen e grupeve mësimore thuhet që: “Për shkak të pjesëmarrjes së ulët e cila reflektohet edhe në numrin e ulët të studentëve të diplomuar, procesi mësimor organizohet në dy grupe dhe për ato lëndë specifike ku kërkohet puna laboratorike, seminarët zhvillohen në salla laboratorësh.

GVJ rekomandon që grupet mësimore të programit të studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software” të organizohen mbi bazë të të dhënave zyrtare institucionale dhe regjistrave të të studentëve në programin e studimit dhe duke respektuar VKM nr. 41, Datë 24.1.2018 Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë (Ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18.12.2019; nr. 185, datë 25.3.2021) dhe rregulloret e brendshme të UMSH.

Evidenca Nr 18: Relacioni i Godines

	<i>Evidenca Nr 14: Rregullore e Departamentit te Informatikes se Biznesit</i> <i>Dokumenta shtese: Liste soft qe perdoren per kete program studimi</i> <i>Dokumenta shtese: Inventari per infrastrukturen e laboratoreve qe mbeshtetin kete program studimi</i> <i>Evidencë nga Vizita e GVJ në institucion</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Gjatë vizitës në institucion GVJ pati mundësinë të njihet me infrastrukturën mësimore në funksion të realizimit të këtij programi studimi. UMSH zotëron 5 laboratorë informatike të pajisur me teknologjitë e nevojshme për të realizuar procesin mësimor si dhe praktikat mësimore për lëndë të këtij profili. Gjithashtu, mjediset e zhvillimit të procesit mësimor janë të pajisura me tabela whiteboard, videoprojektor, sistem fonie, internet etj. Sallat kanë hapësirën e nevojshme për të ushtruar mësimdhënien në kushte të mira dhe komode për studentët. Secili mjedis disponon ajrosjen dhe ndriçimin e duhur, sistem mbrojtje nga zjarri edhe ajër të kondicionuar. Ambjentet janë të pajisura me banka dhe karrige komode për t'ju përgjigjur edhe qëndrimit me orë të zgjatura në leksione dhe seminare të studentëve. <i>Evidencë nga Vizita e GVJ në institucion</i> <i>Dokumenta shtese: Inventari per infrastrukturen e laboratoreve qe mbeshtetin kete program studimi</i> <i>Dokumenta shtese: Liste soft qe perdoren per kete program studimi</i> <i>Evidenca Nr 18: RELACIONI I GODINES</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	UMSH për lëndët dhe programet e Departamentit të Informatikës së Biznesit ka infrastrukturë të përshtatshme teknologjike me 5 laboratorë kompjuterash. Të gjithë kompjuterat janë me parametra të lartë teknikë dhe programe të nevojshme për lëndët. GVJ është e mendimit se kjo infrastrukturë informatike plotëson më së miri kërkesat e moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. <i>Evidencë nga Vizita e GVJ në institucion</i> <i>Dokumenta shtese: Inventari per infrastrukturen e laboratoreve qe mbeshtetin kete program studimi</i> <i>Dokumenta shtese: Liste soft qe perdoren per kete program studimi</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së	Laboratorët e informatikës, janë të pajisur me programe profesionale dhe mbështetin realizimin cilësor të procesit mësimor

paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	me gjithë elementë e tij përbërës. Mirëmbajtja dhe funksionimi korrekt i pajisjeve informatike mundësohet nga angazhimi i personelit akademik me kualifikimin e duhur dhe IT e institucionit. <i>Evidencë nga Vizita e GVJ në institucion</i> <i>Dokumenta shtese: Inventari per infrastrukturen e laboratoreve qe mbeshtetin kete program studimi</i> <i>Dokumenta shtese: Liste soft qe perdoren per kete program studimi</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	Praktikat profesionale, e integruar dhe e mësimdhënies për programin e studimit Master i Shkencave në Informatikë me profile: “Inxhinieri Software dhe “Sisteme Informacioni në Biznes”, UMSH ka nënshkruar një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me bizneset, të cilat në periudhën e fillimit të praktikave profesionale presin, sistemojnë studentët e programit të studimit dhe angazhohen për plotësimin e planit të praktikës së tyre sipas dosjes së praktikës. Në përfundim të praktikës studenti plotëson raportin e praktikës dhe merr vlerësimi, i cili kërkohet dhe shërben për vlerësimin e studentit nga komisioni i pedagogëve të UMSH për mbrojtjen e praktikës. Elementë praktikë të përvetësimit të lëndëve shfaqen në kuadër të realizimit të programit përkatës si dhe në kuadër të temës së diplomës. <i>Dokumenta shtese: Nje raport ne lidhje me perfitimet nga bashkepunimet per praktikat profesionale.</i> <i>Dokumenta shtese: Inventari per infrastrukturen e laboratoreve qe mbeshtetin kete program studimi</i> <i>Dokumenta shtese: Liste soft qe perdoren per kete program studimi</i> <i>Evidenca Nr 17: Lista e pedagogeve qe monitorojne praktikat profesionale</i> <i>Evidenca Nr 18: Dosja e praktikës</i> <i>Evidenca Nr 19: Format i shperndarjes se studenteve praktikante ne institucione</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - <i>Mjediset e vëna në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimor janë të mjaftueshme, me kushte shumë të mira. Laboratorët janë të kompletuar me pajisje të viteve të fundit, të mirëmbajtur dhe në kompjuterat përkatës janë instaluar software e duhur për zhvillimin cilësor të procesit mësimor.</i>

	- <i>Infrastruktura informatike plotëson kërkesat e moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</i> - <i>Mirëmbajtja dhe funksionimi korrekt i pajisjeve informatike mundësohet nga angazhimi i personelit akademik dhe ndihmës akademik me kualifikimin e duhur.</i> <i>GVJ sugjeron:</i> - <i>ndarja e studentëve në grupe mësimore të marrë parasysh kapacitetin e laboratoreve, rregulloret e brendshme institucionale dhe legjislacionin në fuqi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Një pjesë e konsiderueshme e literaturës bazë dhe ndihmëse, në format fizik dhe digjital, ndodhet në bibliotekën e UMSH, në hapësirën e dedikuar fushës së shkencave informatike në mënyrë që studentët të mund të kenë akses të menjëhershëm sipas nevojave. Në bibliotekë ka: literaturë, botime periodike, si dhe një librari elektronike me një numër të konsiderueshëm titujsh, shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës., të aksesueshëm nga studentet dhe stafi akademik. Kërkesat për titujt e rinj mblidhen çdo vit në njësitë kryesore, duke siguruar kështu përputhshmërinë e tyre me kurrikulat mësimore dhe fushat e kërkimit shkencor. GVJ u informua se literatura bazë është e disponueshme në gjuhën shqipe në formën fizike, kurse literatura ndihmëse dhe tutoriale të ndryshme për vetë veçantinë e këtij programi janë kryesisht në gjuhë të huaj (anglisht). Gjatë takimit me stafin akademik GVJ mësoi që një pjesë e stafit akademik zgjedhin literaturë ndihmëse open-source në gjuhën angleze. Në disa raste stafi është angazhuar

	edhe në përgatitjen e cikleve të leksioneve të cilat i janë vënë në dispozicion studentëve të këtij programi studimi. <i>Evidencë nga Vizita e GVJ në institucion</i> <i>Evidenca Nr 44: Kerkese per libra</i> <i>Dokumenta shtese: Lista e librave (elektronike ose fizike) ne dispozicion te ketij programi studimi</i> <i>Dokumenta shtese: Relacion mbi biblioteken</i> <i>Tutorial Mbi perdorimin e faqes Web Bibloteka Online UMSH:</i> https://drive.google.com/file/d/1U5hQt9ZqdckNMDnW3FW6qOvUUhMjx5_z/view
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	UMSH i kushton rëndësi përditësimit të literaturës. Dekanët dhe përgjegjësit e departamenteve janë përgjegjës për të plotësuar dhe pasuruar fondin e bibliotekës me literaturën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe të veprimtarisë kërkimore shkencore në UMSH. Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni, për këtë program studimi janë në dispozicion të studenteve në format fizik në bibliotekë 74 libra dhe dispensa të përgatitura nga pedadogu i lëndës, bibliotekën online dhe akses në platformat COBISS dhe Elgar Publishing. GVJ evidentoi praktikën e punës në IAL, ku në fillim të çdo viti akademik bëhet rishikimi i përmbajtjes së syllabuseve dhe diskutohen nevojat për përditësim të literaturës dhe mbledhjes së kërkesave për libra të rinj. Njësia bazë përgjegjëse, ruan përditësimet e literatures që përfshihen në kopjet e syllabuseve për çdo semestër. <i>Megjithatë, nga analiza e syllabuseve të miratuara në departament, literatura bazë dhe e rekomanduar është mesatarisht e 10 viteve të fundit, gjë që nuk reflekton zhvillimet e shpejta teknologjike në fokus të programit të studimit.</i> <i>GVJ rekomandon institucionin të planifikojë buxhetin sipas akteve rregullatore për pasurimin e literaturës me botime të viteve të fundit në funksion të programit të studimit dhe njoftimin e personelit akademik dhe administrativ të përfshirë.</i> <i>Evidenca Nr 22: Syllabuset e lendeve te ofruara per vitin akademik</i> <i>Evidenca Nr 44: Kerkese per libra</i> <i>Dokumenta shtese: Lista e librave (elektronike ose fizike) ne dispozicion te ketij programi studimi</i> <i>Dokumenta shtese: Relacion mbi biblioteken</i>

Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Gjatë vizitës në UMSH, GVJ vizitoi ambientet e Bibliotekës, e cila arkivon, digjitalizon dhe mirëmban pasurinë akademike, kulturore e shkencore të Institucionit. Biblioteka e UMSH, është e konceptuar dhe e implementuar në 4 salla leximi në një hapësirë prej 157 m². Ajo ofron shërbime për të gjithë studentët dhe stafin akademik të UMSH. Shërbimi bibliotekar në UMSH ofrohet në gjashtë ditë të javës, nga a hëna në të shtunë, në orarin 08:00 – 20:00 për ditët nga e hëna në të premte dhe 09:00 – 14:00 ditën e shtunë. Për t'u ardhur në ndihmë sa më mirë studentëve dhe stafit akademik, biblioteka ofron edhe shërbime online për kërkim në fondin e saj të librave elektronikë. Biblioteka online aksesohet përmes linkut ne faqen zyrtare të UMSH duke u loguar. Biblioteka ofron edhe shërbime online për kërkim në platformat e bibliotekave elektronike COBISS dhe Elgar Publishing. <i>GVJ rekomandon institucionin të vërë në dispozicion ne faqen zyrtare institucionale për të gjithë të interesuarit, Rregulloren e Bibliotekës dhe orarin funksionimit të saj.</i> Stafi i bibliotekës organizon edhe veprimtari informuese përmes ekspozitave dhe vitrinave tematike të librit apo të hyrjeve të reja, takimeve dhe bisedave informuese, etj. <i>Dokumenta shtese: Relacion mbi biblioteken</i> <i>Evidenca Nr 10: Permbledhese e tabelave per programin, Tabela 16.</i> <i>Evidenca Nr 34: Udhezuesi i studenteve – D. Perdorimi i Bibliotekes</i> http://biblioteka.umsh.edu.al:8020/EbooksServer/user-registration/index.php
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive	Biblioteka e UMSH është e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse në gjuhën shqipe dhe të huaj, libra apo revista shkencore. Biblioteka mbulon modulet e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. Në bibliotekë studentët mund të gjejnë në format fizik dhe elektronik edhe leksionet e çdo lëndë nga pedagogët përkatës dhe slidet ne power point. Në ndihmë të studentëve janë dhe bibliotekat on-line të cilat mundësojnë të sigurohet akses në një literaturë të gjerë dhe të përditësuar në

mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	gjuhë të huaj, kryesisht në gjuhën angleze të cilën studentët dhe stafi akademik e preferojnë. <i>Materiali RVB</i> <i>Dokumenta shtese: Relacion mbi biblioteken</i> https://www.e-elgar.com/ https://plus.cobiss.net/cobiss/al/en/unpaywall
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	UMSH disponon akses në bibliotekën digjitale që nga viti 2021. Biblioteka online aksesohet përmes linkut në faqen zyrtare të UMSH duke u loguar. Punimet shkencore dhe leksionet e përgatitura nga pedagogët janë gjithashtu të aksesueshme online në formatin pdf. Biblioteka ofron edhe shërbime online për kërkim në platformat e bibliotekave elektronike COBISS dhe Elgar Publishing. GVJ në vizitën e saj në bibliotekën e UMSH, konsaton se studentët dhe pedagogët kanë akses të barabartë e pa pagesë në bibliotekën digjitale online, që siguron qasje në revista akademike, libra dhe burime kryesore. Çdo student e pedagog ka të drejtë regjistrimi dhe përdorim të fondit fizik dhe elektronik të bibliotekës. <i>Materiali RVB</i> <i>Dokumenta shtese: Relacion mbi biblioteken</i> <i>Evidenca Nr 43: Manual mbi përdorimin e bibliotekës online</i> http://biblioteka.umsh.edu.al:8020/EbooksServer/user-registration/index.php https://www.e-elgar.com/ https://plus.cobiss.net/cobiss/al/en/unpaywall
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	GVJ konsaton se Biblioteka është e pajisur me poste leximi/studimi dhe pajisje kompjuterike të lidhura me internet për akses të bibliotekës digjitale të UMSH dhe të bibliotekave online ndërkombëtare duke përmblusur nevojat e studentëve. Materialet gjenden lehtësisht si fizikisht dhe elektronikisht. <i>Materiali RVB</i> <i>Dokumenta shtese: Relacion mbi biblioteken</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në	Biblioteka në UMSH është në dispozicion të studentëve dhe ofron shërbime për të gjithë studentët dhe stafin akademik. Shërbimi bibliotekar në UMSH ofrohet në gjashtë ditë të javës, nga e hëna në të shtunë, në orarin 08:00 – 20:00 për ditët nga e hëna në të premte dhe 09:00 – 14:00 ditën e shtunë. Oraret e funksionimit të bibliotekës janë të afishura në hyrje të bibliotekës. GVJ rekomandon që ky informacion të vendoset edhe në faqen zyrtare

përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	web të institucionit (https://www.umsh.edu.al/). Sallat e bibliotekës janë komode dhe me kushte të përshtatshme për të punuar në ambientet e saj. <i>Evidencë nga Vizita e GVJ në institucion</i> <i>Dokumenta shtese : Relacion mbi biblioteken</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Nga takimet, vizitat, që GVJ zhvilloi në institucion, vërehet një frymë bashkëpunimi mes departamenteve e bibliotekës për rritjen e cilësisë së shërbimit të bibliotekës. Lektorët e lëndëve të programit të studimit depozitojnë gjithmonë në bibliotekë një kopje të materialeve të leksioneve. Studentët dhe personeli akademik kanë akses në të gjitha fondet online. Me kërkesën dhe në bashkëpunim me departamentet parashikohen blerjet e reja të titujve të librave duke pasuruar vit pas viti në fondin e saj. <i>GVJ rekomandon institucionin të mbledhë statistika në lidhje me numrin e përdoruesve të bibliotekës dhe shkallën e shfrytëzimit të saj dhe të marrë masa në parashikimin e buxhetit për pasurimin e fondit fizik dhe digjital të bibliotekës me literaturë të viteve të fundit në mbështetje të syllabuseve të lëndëve të programit të studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”.</i> <i>Evidencë nga Vizita e GVJ në institucion</i> <i>Dokumenta shtese: Relacion mbi biblioteken</i> <i>Dokumenta shtese: Lista e librave (elektronike ose fizike) në dispozicion të këtij programi studimi</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - <i>Literatura bazë e programit të studimit është e disponueshme në gjuhën shqipe në formën fizike, kurse literatura ndihmëse dhe tutoriale të ndryshme janë kryesisht në gjuhë të huaj.</i> - <i>nga a hëna në të shtunë, në orarin 08:00 – 20:00 për ditët nga e hëna në të premte dhe 09:00 – 14:00 ditën e shtunë.</i> - <i>UMSH ofron akses falas për studentët dhe stafin akademik në ambientet e bibliotekës, në bibliotekën online dhe platforma të tjera elektronike.</i> <i>Rekomandohet:</i> - <i>të vihet në dispozicion në faqen zyrtare Rregullorja e Bibliotekës dhe orari i funksionimit të saj.</i>

	- Të vlerësohet shkalla e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online të bibliotekës nga personeli akademik dhe studentët e programit. - zhvillimet e shpejta teknologjike në fokus të programit të studimit të reflektohen në literaturën e ofruar për programin e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UMSH disponon dhe administron informacionin e duhur për studentët, stafin akademik dhe personelin administrativ përmes një sistemi menaxhimi elektronik. Sistemi i Menaxhimit të Studentëve (SMS) përdoret rregullisht që nga viti 2017 për të ndjekur ecurinë e studentëve që nga regjistrimi deri në diplomim. Të dhënat që ruhen dhe përpunohen në SMS, ruhen njëkohësisht edhe në formatin hard-copy në regjistrat e notave dhe të diplomave në Sekretarinë Mësimore. Stafi dhe studentët e UMSH mund të aksesojnë të dhënat në SMS sipas të drejtave që ato kanë në sistem nëpërmjet identifikimit me anë të kredencialeve të tyre username dhe password. Zyra e IT bashkëpunon me strukturat e institucionit për menaxhimin sa më të mirë dhe mirëmbajtjen e SMS. <i>Evidenca Nr 10: Udhezues për përdorimin e sms-se</i> <i>Evidenca Nr 35: Manual i përdorimit të platformave online</i> <i>Evidenca Nr 50: Rregullore e sekretarisë mesimore</i> <i>Evidencë nga Vizita e GVJ në institucion</i> http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit	Sistemet e menaxhimit të informacionit në UMSH përdoren në pëputhje me statutin e UMSH-së dhe Rregulloren e Njesisë Kryesore dhe aksesohen nga studentët, pedagogët, financa dhe sekretaria respektivisht sipas roleve që ato kanë në institucion. Çdo përdorues/rol ka akses të dedikuar për të dhënat që kanë lidhje me aktivitetin e tij në UMSH.

administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	UMSH garanton përmes strukturave administrative të ngritura sipas organigramës së institucionit, administrimin e informacionit në lidhje me personelin akademik, studentët dhe mbarevajtjen e programit mësimor. Në Zyrën e Burimeve Njerëzore ruhen dhe administrohen informacione të personelit akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Zyra e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për dokumentacionin e personelit akademik (PAE/PAK) dhe stafit administrativ. Sekretaria Mësimore, e cila sipas ligjit, udhëzimeve e rregulloreve të dedikuara për dokumentimin dhe administrimin e veprimtarisë mësimore. <i>Evidenca Nr 1: Statuti i UMSH</i> <i>Evidenca Nr 9: Rregullore e organizimit UMSH</i> <i>Evidenca Nr 10: Udhezues për përdorimin e sms-se</i> <i>Evidenca Nr 50: Rregullore e sekretarise mesimore</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i menaxhimit funksionon në bazë të roleve dhe të drejtave të përdoruesve të cilët pasi logohen me anë të emailit dhe fjalëkalimit kanë akses në të dhënat e tyre sipas rolit që kanë në institucion. Në këtë mënyrë administrohen të dhënat e studentëve dhe i ofrohet atyre një hapësirë vetjake/private për të aksesuar notat, ndërtuar orarin, regjistruar modulet, riprovimet etj. Në këtë mënyrë garantohej privatësia e të dhënave personale dhe liria akademike sipas legjislacionit në fuqi. Të dhënat dhe informacionet janë të kufizuara vetëm brenda aktivitetit që përdoruesit zhvillojnë në UMSH duke ruajtur konfidencialitetin e çdo studenti ose anëtarit të personelit akademik dhe administrativ. <i>Institucioni nuk ka paraqitur evidencë në lidhje me rolet dhe të drejtat e përdoruesve në Sistemin e Menaxhimit të Studentëve apo një dokument teknik mbi të cilin GVJ mund të gjykojmë në lidhje me sigurinë e të dhënave personale të studentëve (hardware, software, storage, kontrollat e aksesit, administrimit, procedurave etj).</i> <i>Evidenca Nr 10: Udhezues për përdorimin e sms-se</i> http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë formë të komunikimit interaktiv dhe	Sistemi elektronik i menaxhimit të UMSH siguron module që mundësojnë formë të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit. Studentët dhe stafi akademik janë të pajisur me një adresë email në domainin e UMSH me anë të të cilës logohen në sistemin e menaxhimit të studentëve. Në fillim të vitit akademik cdo

shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	student i ri i UMSH pajiset me adresën e emailit dhe i sigurohet aksesit në SMS. UMSH përdor si nderfaqe aksesit të SMS faqen web zyrtare të tij. Në portalin e pedagogut hidhen ruhen dhe përpunohen të dhëna në lidhje me përmbajtjen e lëndës, frekuentimin dhe vlerësimin e vazhduar të studentit. Përmes SMS studenti merr në kohë të shpejtë të dhëna në lidhje me të drejtën për të hyrë ose jo në provim, regjistrimin në provim, vlerësimin e bërë nga pedagogu gjatë semestrit, vlerësimin në provim, notën përfundimtare dhe të dhënat e tij financiare pa patur nevojë të kontaktojë me njësitë përkatëse. <i>Evidenca Nr 10: Udhezues per perdorimin e sms-se</i> http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi i menaxhimit siguron adresa personale uniforme me domain të institucionit dhe llogari me akses elektronik personal. Gjithashtu, në dispozicion është aplikacioni SMS, faqja zyrtare e UMSH, G-Suite dhe sistemi Zoom Cloud. Në këtë mënyrë informacioni është i drejtpërdrejtë në kohë reale si për studentët që duan të informohen ashtu dhe për personelin akademik dhe administrativ. Institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime sipas roleve të përdoruesve në institucion. Në mënyrë automatike dhe të parametrizuar sistemi i menaxhimit gjeneron raportime në lidhje me kalueshmërinë, notën mesatare, përdorimin e ambienteve didaktike të cilat përdoren nga strukturat vendimarrëse të institucionit. <i>Evidenca Nr 10: Udhezues per perdorimin e sms-se</i> <i>Evidenca Nr 35: Manual i perdorimit te platformave online</i> http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në faqen zyrtare web të UMSH gjendet informacion për programet e studimit, partnerët, aktivitetet e ndryshme, etj. Gjithashtu në UMSH, Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës, e cila udhëhiqet nga staf i kualifikuar, ka mision të sajën që të drejtojë dhe mbështesë studentët gjatë procesit të formimit universitar, ti njohë të interesuarit me programet, përfitimet, punën dhe perspektivat në të ardhmen. Faqja web zyrtare e UMSH ofron informacioni në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. <i>Megjithatë, gjatë vizitës së faqes web të UMSH (www.umsh.edu.al) GVJ vëren që një pjesë e artikujve dhe informacioneve të publikuara ofrohen vetëm në gjuhën shqipe. GVJ rekomandon që institucioni, në kuadër të ndërkombëtarizimit, të kushtojë vëmendjen e duhur publikimit të cdo informacioni në faqen e tij web zyrtare në dy gjuhë.</i>

	https://www.umsh.edu.al/c/86/fakulteti-i-informatikes https://www.umsh.edu.al/c/221/fakulteti-i-informatikes https://www.umsh.edu.al/c/36/keshillimi-i-karrieres			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - UMSH disponon nje Sistem Menaxhimi të Studentëve, me anë të të cilit bëhet edhe monitorimi i aktivitetit akademik për programin e studimit. - Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre administrohet nga Sekretaria Mësimore. - Studentëve dhe stafit akademik u mundësohet hyrje e dedikuar në sistemin SMS nëpërmjet emrit të përdoruesit/emailit dhe fjalëkalimit. - Informacioni i detajuar për programin dhe personelin akademik mund të aksesohet nëpërmjet SMS, Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, sekretarisë Mësimore dhe faqes web zyrtare të UMSH. - Në faqen zyrtare www.umsh.edu.al shumica e informacioneve publikohen në dy gjuhë shqip dhe anglisht. <i>GVJ rekomandon që institucioni, në kuadër të ndërkombëtarizimit, të kushtojë vëmendjen e duhur publikimit të <u>cdo informacioni</u> në faqen e tij web zyrtare edhe në gjuhën angleze.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të	UMSH harton raporte financiare në të cilat paraqiten të ardhurat sipas burimeve dhe shpenzimet për vitin financiar. Në to raportohet gjithashtu për realizimin e objektivave të institucionit. Menaxhimi i aspekteve financiare në nivel institucioni mbulohet nga Administratori i UMSH dhe Bordi i Administrimit duke siguruar edhe miratimin e Senatit Akademik, hartojnë dhe dakordësojnë cdo vit projekt-buxhetin vjetor dhe propozojnë kriteret për menaxhimin e burimeve financiare dhe materiale. Raportet

studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	financiare të siguruar nga institucioni nuk janë detajuar në nivel programi studimi ndaj nuk është i mundur vlerësimi i detajuar i kostove të programit të studimit. Megjithatë, duke marrë në konsideratë situatën financiare të përgjithshme të UMSH, GVJ është i mendimit se është e garantuar mbarëvajtja e programit të studimit për më tepër se një cikël të plotë studimi. <i>Evidenca Nr 45: Raporti financiar</i> <i>Evidenca Nr 48: Rregullore e bordit të administrimit</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësive bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	GVJ konstaton se në raportimin e dërguar nga UMSH janë të pasqyruara në nivel institucional realizimi i financimeve për burimet njerëzore në shërbim të realizimit të programeve të studimit, shpenzimet për aktivitetin kërkimor shkencor, shpenzime për investime në teknologji, detyrimet financiare, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet, shërbimet trajnuese dhe zëra të tjerë. Alokimi i burimeve financiare në nivel njësive bazë bëhet mbi bazën e objektivave që ka secili departament në lidhje me veprimtarinë mësimore dhe kërkimore-shkencore. <i>GVJ sugjeron që institucioni të hartojë raporte financiare në nivel programi studimi dhe ta vërë këtë informacion në dispozicion të njësive bazë përgjegjëse për programin. Kjo do të ndihmonte departamentin në propozimin e kuotave të studentëve dhe kërkesave për investime.</i> <i>Evidencë nga Vizita e GVJ në institucion</i> <i>Evidenca Nr 45: Raporti financiar</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	UMSH kryen auditim financiar vjetor të brendshëm dhe të pavarur të jashtëm cdo vit. Kontrolli dhe auditimi i brendshëm në UMSH realizohet nga njësia e auditimit të brendshëm të UMSH. Audit i brendshëm emërohet nga Bordi i Administrimit dhe raporton pranë tij. Zyra e Financë Kontabilitetit është përgjegjëse për menaxhimin financiar dhe zbatimin e politikës financiare të institucionit. Pasqyrat financiare të institucionit janë transparente dhe pasqyrojnë gjendjen financiare të tij. Pasqyrat financiare auditohen

	edhe nga ekspertë të jashtëm që nga fillimi i aktivitetit dhe aktualisht kryhen nga shoqëria CROWE Horwath AL shpk. Sipas materialit në RVB, raportet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, paraqiten për diskutim dhe vendimmarrje në organet drejtuese të UMSH, në Senatin Akademik, dhe në Bordin e Administrimit dhe shërbejnë si burim informacioni për marrjen e vendimeve me qëllim rritjen e cilësisë së programeve të studimeve, rekrutimin e stafit akademik të kualifikuar, investime infrastrukturore, investime për kërkim shkencor, etj. <i>Materiali RVB</i> <i>Evidenca Nr 45: Raporti financiar</i> https://www.umsh.edu.al/media/678a46539c749.pdf
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	UMSH realizon një Raport vjetor i cili përcillet deri në nivel njësie bazë dhe publikohet edhe në faqen web të UMSH. Ky raport përgatitet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit dhe ofron informacion në lidhje me realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese, inovacionit, gjendjen financiare të UMSH, personelin akademik dhe elementë të tjerë që lidhen me shërbimet që ofron UMSH. <i>Evidenca Nr 45: Raporti financiar</i> https://www.umsh.edu.al/c/19/akte-ligjore
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	GVJ konstaton se nga të dhënat e publikuara në faqen e UMSH në dokumentat e raporteve financiare për të ardhurat dhe finacimet për tre vitet e fundit, institucioni garanton qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e veprimtarisë së tij akademike dhe ecurinë normale të programeve të studimit. Me qëllim diversifikimin e të ardhurave, institucioni vitet e fundit përparësi i ka dhënë edhe aplikimit për projekte shkencore dhe kërkimore. Institucioni ka aplikuar për projekte të ndryshme, disa prej të cilëve i ka fituar në partneritet me institucionet të tjera dhe disa nuk janë fituar. <i>Evidencë nga Vizita e GVJ në institucion</i> <i>Evidenca Nr 20: Raport vjetor i UMSH</i> <i>Evidenca Nr 45: Raporti financiar</i>
Konkluzione	- UMSH rezulton se ka kapacitete të mjaftueshme financiare për të realizuar objektivat e tij lidhur me programin e studimit.

	- Pjesa më e madhe e financimit vjen nga të ardhurat e studentëve. - UMSH bën përpjekje për diversifikimin e të ardhurave duke synuar rritjen e peshës së të ardhurave të krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta dhe nga grantet për kërkim. - Institucioni nuk raporton pasqyra financiare me një detajim deri në nivel programi studimi për të mundësuar një vlerësim më të detajuar të kostove të programit të studimit. GVJ sugjeron të hartohen raporte financiare në nivel programi studimi dhe të vihet ky informacion në dispozicion të njesisë bazë përgjegjëse për programin. Nisur nga situata financiare e përgjithshme e UMSH, GVJ mendon se institucioni garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit për më tepër se një cikël të plotë studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Pranimi i studentëve, përparimi i tyre përgjatë kursit të studimit, vlerësimi i dijeve dhe diplomimi mbështetet në Statutin e UMSH, Rregulloren e organizimit të UMSH, Rregulloren e Fakultetit të Informatikës, Rregulloren e Departamentit të Informatikës së Biznesit dhe Rregulloren e programit të studimit "Master Shkencor ne Informatike me Profile". Nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se veprimtaria e Fakultetit të Informatikës zhvillohet në përputhje me këto rregullore, të cilat janë hartuar në përputhje me

	aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe se u garantohet barazia dhe të drejta të njëjta të gjithë kandidatëve për studentë dhe studentëve që ndjekin studimet në këtë program studimi. <i>Evidenca Nr 1: Statuti i UMSH</i> <i>Evidenca Nr 9: Rregullore e Organizimit UMSH</i> <i>Evidenca Nr 5: Rregullore e Fakultetit te Informatikes</i> <i>Evidenca Nr 14: Rregullore e Departamentit te Informatikes se Biznesit</i> <i>Evidenca Nr 6: Rregullore e Programit Master Shkencor ne Informatike me Profile</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Politikat dhe procedurat e ndjekura nga Fakulteti i Informatikës janë të mirëpërcaktuara në rregulloret e ndryshme të të gjithë elementëve që lidhen që me pranimin e studentëve në këtë program studimi, ndjekjen e procesit mësimor dhe vlerësimin e studentit deri në diplomim. Procedurat e ndjekura janë në përputhje dhe përshtaten në mënyrë të vazhdueshme me udhëzimet, vendimet dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Veprimtaria mësimore organizohet dhe realizohet nga Departamenti i Informatikës së Biznesit dhe drejtohet e kontrollohet nga autoritetet dhe organet drejtuese përkatëse me kompetenca të përcaktuara në rregulloret përkatëse. <i>Evidenca Nr 9: Rregullore e Organizimit UMSH</i> <i>Evidenca Nr 5: Rregullore e Fakultetit te Informatikes</i> <i>Evidenca Nr 14: Rregullore e Departamentit te Informatikes se Biznesit</i> <i>Evidenca Nr 6: Rregullore e Programit Master Shkencor ne Informatike me Profile</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Përcaktimi i kriterëve pranuese në programin Master i Shkencave në "Informatikë", me profile "Sistemet e Informacionit në Biznes" dhe "Inxhinieri Software" kalon për miratim në të gjitha njësitë përgjegjëse për këtë program studimi (DIB, FI, Rektorat, Senat akademik, MAS). <i>GVJ sugjeron që kriteret dhe kuotat e miratura për këtë program studimi të publikohen edhe në faqen web zyrtare të UMSH. Në kërkesat për kuotat dërguar MAS parashikohet edhe pranimi i kandidatëve të huaj dhe atyre me transferim.</i> Për dy vitet e fundit akademike regjistrimet për programin e studimit Master i Shkencave në Informatikë me profile: "Inxhinieri Software" dhe "Sisteme Informacioni në Biznes" kanë qënë si më poshtë:

	<table><tr><th>Profili</th><th>Viti akademik</th><th>Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë</th><th>Nr. i studentëve të transferuar Viti I</th><th>Nr. i studentëve të transferuar Viti II</th></tr><tr><td rowspan="2">Inxhinieri Software</td><td>2022-2023</td><td>40</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>66</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td rowspan="2">Sisteme Informacioni në Biznes</td><td>2022-2023</td><td>51</td><td>-</td><td>6</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>30</td><td>-</td><td>3</td></tr></table>	Profili	Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Nr. i studentëve të transferuar Viti I	Nr. i studentëve të transferuar Viti II	Inxhinieri Software	2022-2023	40	-	-	2023-2024	66	-	-	Sisteme Informacioni në Biznes	2022-2023	51	-	6	2023-2024	30	-	3
Profili	Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Nr. i studentëve të transferuar Viti I	Nr. i studentëve të transferuar Viti II																				
Inxhinieri Software	2022-2023	40	-	-																				
	2023-2024	66	-	-																				
Sisteme Informacioni në Biznes	2022-2023	51	-	6																				
	2023-2024	30	-	3																				
	<i>Dokumenta shtese: Shkresa e miratimit te kuotave dhe kriterëve per pranimin e studentëve ne kete program studimi</i> <i>Evidenca Nr 10: Permbledhese e tabelave per programin, Tabela 21.</i>																							
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Rregulloret e institucionit, njësisë kryesore dhe programit të studimit kanë informacion të plotë për procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit. Këto informacione, studentët mund ti gjejnë në zyrat përkatëse në ambientet e institucionit. <i>GVJ sugjeron që këto informacione të jenë lehtësisht të aksesueshme edhe online në faqen zyrtare web të UMSH.</i> <i>Evidenca Nr 9: Rregullore e Organizimit UMSH</i> <i>Evidenca Nr 5: Rregullore e Fakultetit te Informatikes</i> <i>Evidenca Nr 14: Rregullore e Departamentit te Informatikes se Biznesit</i> <i>Evidenca Nr 6: Rregullore e Programit Master Shkencor ne Informatike me Profile</i> https://www.umsh.edu.al/c/150/kriteret-e-pranimit																							
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit	Referuar takimeve në institucion dhe dosjes së vetëvlerësimit, GVJ konstatoi se pjesë e informimit dhe udhëzimit të publikut janë dhe takime informuese me të interesuarit ku ofrohen edhe informacionet nëpërmjet broshurave dhe mjeteve të tjera si reklamat ne kanale te																							

në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	ndryshme, informimi nga Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës, pjesëmarrja në evente dhe panairë lidhur me fushën e arsimit, publikimi në gazeta dhe revista, flyers, postera, prezantime, në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit në programin e studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”. Gjithashtu, në rregulloren e programit të studimit KREU III i dedikohet Pranimit të Studentëve. <i>Evidenca Nr 6: Rregullore e programit Master Shkencor ne Informatike me profile</i> <i>Evidenca Nr 13: Rregullore ZKSK</i> <i>Evidenca Nr 49: Java e pare e orientimit ne UMSH</i> https://www.umsh.edu.al/c/231/broshura-informuese https://www.umsh.edu.al/c/36/keshillimi-i-karrieres
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	UMSH publikon cdo vit kriteret të qarta për studentët potenciale. Për kandidatët me aftësi ndryshe dhe shtresat e marginalizuara institucioni ofron shërbime lehtësuese bazuar në një rregullore të posacme për këtë kategori studentësh. Megjithatë, nga shqyrtimi i shkresës së miratimit të kuotave të UMSH për vitin akademik Referuar kuotave të propozuara nga UMSH, për vitin akademik 2023-2024, institucioni nuk ka parashikuar kuota për studentët me aftësi ndryshe në programin e studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”. <i>GVJ sugjeron që UMSH të konkretizojë nëpërmjet koutave të dedikuara mbështetjen për kandidatët me aftësi të vecanta apo që vijnë nga shtresa të marginalizuara.</i> <i>Evidenca Nr 29: Rregullore per studentet me aftesi ndryshe</i> <i>Dokumenta shtese: Shkresa e miratimit te kuotave dhe kriterëve per pranimin e studenteve ne kete program studimi</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Referuar kuotave të propozuara nga UMSH, për vitin akademik 2023-2024, vërejmë se për programin e studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software” nuk parashikohen kuota për kandidatët nga shtete të huaja. Meqënëse programi i studimit Master i Shkencave në Informatikë me profile: “Inxhinieri Software” dhe “Sisteme Informacioni në Biznes” ofrohet në gjuhën shqipe, <i>GVJ sugjeron që UMSH të përcaktojë kuota të dedikura për kandidatë nga republika e Kosovës, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, etj.</i>

	<i>Dokumenta shtese: Shkresa e miratimit te kuotave dhe kriterëve per pranimin e studentëve ne kete program studimi</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Referuar takimeve në institucion, dosjes së vetëvlerësimit dhe RVB, UMSH aplikon politika për bursat studentore për shtresat në nevojë si dhe për studentët me rezultate të larta akademike. Në zbatim të vendimit të Bordit të Administrimit, UMSH u ofron bursa kategorive të ndryshme të aplikantëve që duan të kryejnë cikle të ndryshme studimi. Konkretisht, UMSH ofron një shumëllojshmëri bursash nga të cilat për këtë program studimi vecojmë: - <i>bursë sociale</i> për aplikantët nga grupet në nevojë (familje me ndihmë ekonomike dhe mesatare shumë të lartë, status jetimi, fëmijë dëshmorësh në polici, në forca të armatosura, me aftësi ndryshe, komunitetet e marginalizuara, etj). - <i>bursë ekselence</i> master për studentët e regjistruar për herë të parë ne ciklin Master me mesataren 9.7-10 nga cikli paraardhës dhe me kushte ekonomike jo të favorshme. <i>Evidenca Nr 48: Rregullore e bordit te administrimit</i> https://www.umsh.edu.al/c/110/bursat
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - <i>Fakulteti i Informatikës garanton barazinë dhe të drejta të njëjta të gjithë kandidatëve për studentë dhe studentëve që ndjekin studimet në programin e studimit.</i> - <i>Kriteret dhe procedurat e regjistrimit bazohen në legjislacionin në fuqi dhe shpallen pas miratimit të tyre në Senatin Akademik dhe aprovimit prej MAS. Kriteret dhe procedurat janë lehtësisht të kuptueshme për të interesuarit.</i> - <i>Në faqen web të UMSH publikohen kriteret për kandidatët.</i> - <i>UMSH aplikon politikat për bursat studentore për shtresat në nevojë si dhe për studentët me rezultate të larta akademike.</i> <i>GVJ vlerëson se UMSH/FI/DIB kanë hartuar, ndjekin dhe zbatojnë politika, strategji dhe procedura për të gjithë rrugëtimin e studentëve që nga faza kur janë akoma kandidatë për studentë dhe pastaj për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</i> <i>GVJ sugjeron:</i>

	- rregulloret institucionale të cilat përmbajnë informacion për procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të jenë të aksesueshme edhe online në faqen zyrtare web të UMSH. - Përfshirjen e koutave të dedikuara për kandidatët me aftësi të vecanta, që vijnë nga shtresa të marginalizuara dhe për kandidatët nga huaj nga trojet.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Ndër mënyrat për të marrë informacion të plotë, në UMSH, në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, janë: - Faqja zyrtare e internetit - Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës - Sekretaria mësimore - Departamenti i Informatikës së Biznesit - Java e orientimit të studentët ku ata informohen për programin mësimor, ambjentet, detyrimet dhe të drejtat e studentëve. Burime bazë të informimit janë rregulloret e institucionit (Statuti i UMSH, Rregullorja e organizimit të UMSH, Rregullorja e Fakultetit të Informatikës, Rregullorja e Departamentit të Informatikës së Biznesit) si dhe dhe Rregullorja e programit të studimit “Master Shkencor në Informatikë me Profile”. Në to jepen elementë të tillë si pranimi në programin e studimit, pezullimi i studimeve, mobiliteti studentor, viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies, organizimi i semestrave mësimor, organizimi i grupeve mësimore, procesi i regjistrimit për frekuentimin e kursit, frekuentimi i orëve mësimore, kontrolli i dijeve, zhvillimi i provimeve gjatë semestrit, organizimi i sezoneve të riprovimeve, rregullat e provimit, ankimimi i provimeve, organizimi i kurseve intensive, përmirësimi i notës, mbrojtja e diplomës, organizimi dhe

	vlerësimi i provimit të përgjithshëm përfundimtar të diplomës etj. <i>GVJ sugjeron që rregulloret institucionale dhe udhëzuesit e përgatitur nga institucioni të jenë të aksesueshëm edhe online nëpërmjet faqes zyrtare të UMSH.</i> <i>Evidenca Nr 1: Statuti i UMSH</i> <i>Evidenca Nr 9: Rregullore e Organizimit UMSH</i> <i>Evidenca Nr 5: Rregullore e Fakultetit të Informatikës</i> <i>Evidenca Nr 14: Rregullore e Departamentit të Informatikës së Biznesit</i> <i>Evidenca Nr 6: Rregullore e Programit Master Shkencor në Informatikë me Profile</i> <i>Evidenca Nr 49: Java e parë e orientimit në UMSH</i> <i>Evidenca Nr 23: Udhëzues për përgatitjen e punimit të diplomes</i> <i>Evidenca Nr 46: Përmbledhje të procedurave të transferimit të studentëve</i> <i>Evidenca Nr 36: Udhëzues për provimin e ndërmjetëm përfundimtar dhe të sezonit perserites</i> https://www.umsh.edu.al/c/231/broshura-informuese
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurave të njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Institucioni garanton procedurat për njohjen dhe ekuivalentimin e kualifikimeve. Kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve nga studime të mëparshme janë të pasqyruar në rregulloren e FI, rregulloren e DIB, rregulloren e programit të studimit dhe Procedurën e Transferimit të Studimeve të përgatitur nga Zyra Juridike e UMSH. Gjithashtu gjatë regjistrimit të studentëve sekretaria mësimore i informon ata në lidhje me mundësinë e transferimit të krediteve dhe i udhëzon për procedurat që duhet të ndjekin në rastet kur kanë kryer studime të mëparshme. <i>Evidenca Nr 1: Statuti i UMSH</i> <i>Evidenca Nr 9: Rregullore e Organizimit UMSH</i> <i>Evidenca Nr 5: Rregullore e Fakultetit të Informatikës</i> <i>Evidenca Nr 14: Rregullore e Departamentit të Informatikës së Biznesit</i> <i>Evidenca Nr 6: Rregullore e Programit Master Shkencor në Informatikë me Profile</i> <i>Evidenca Nr 46: Përmbledhje të procedurave të transferimit të studentëve</i> <i>Dokumenta shtesë: Procedure transferimi dhe lista e studentëve të transferuar</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje	Elementët e detajuar për lëndët që bëjnë pjesë në programin e studimit, jepen nga pedagogët në javën e parë të mësimit, duke u

me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	bërë të njohur dhe vënë në dispozicion të studentëve syllabusin e lëndës dhe duke detajuar objektivat, temat përkatëse, elementët formues të programit (leksione, ushtrime, detyra kursi, laboratorë et.), mënyrën e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve si dhe literaturën përkatëse. Studentët informohen në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të tyre dhe nëpërmjet rregullores së FI, rregullores së DIB, rregulloren e programit të studimit dhe Udhëzuesit për Zhvillimin e Provimeve. Gjithashtu, pedagogët e lëndëve, Departamenti i Informatikës së Biznesit, Sekretaria Mësimore dhe Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës janë në shërbim të studentëve për ti informuar ata dhe për t'u vënë në dispozicion rregulloret dhe udhëzuesit përkatës. <i>Evidenca Nr 36: Udhëzues për provimin e ndermjetem perfundimtar dhe te sezonit perserites</i> <i>Evidenca Nr 5: Rregullore e Fakultetit te Informatikes</i> <i>Evidenca Nr 14: Rregullore e Departamentit te Informatikes se Biznesit</i> <i>Evidenca Nr 6: Rregullore e Programit Master Shkencor ne Informatike me Profile</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software” përcaktohet se diplomimi bëhet me punim diplome dhe në përfundim të tij studentët pajisen me diplomë. UMSH ka një udhëzues për mbrojtjen e diplomës i cili i vihet në dispozicion studentëve nga departamenti përgjegjës i programit të studimit. <i>Evidenca Nr 6: Rregullore e Programit Master Shkencor ne Informatike me Profile, Kreu VI - Diplomimi</i> <i>Evidenca Nr 23: Udhëzues për përgatitjen e punimit te diplomes</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Bazuar në dokumentat e dosjes së vetëvlerësimit dhe në faqen web të UMSH, institucioni publikon broshura studentore, përgatit fletëpalosje dhe reklama në kanale të ndryshme komunikimi në mënyrë periodike me qëllim që të informojë të interesuarit dhe studentët e ardhshëm mbi programet e studimit në UMSH. Gjithashtu, Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës në UMSH ka mision të sajën që të drejtojë dhe mbështesë studentët gjatë procesit të formimit universitar të tyre, si dhe t'i orientojë dhe këshillojë ata me kërkesat e tregut të punës dhe mundësitë e zgjedhjeve. Institucioni merr pjesë në panairët e edukimit të

	zhvilluara nga MAS si p.sh. Panairi Work & Study. Sipas RVB, Departamenti i Informatikës së Biznesit organizon veprimtari informuese në formën e leksioneve të hapura në të cilat diskutohet me të interesuarit mbi programet e studimit, mundësitë e punësimit dhe aftësimi i vazhdueshëm. <i>Materiali RVB</i> https://www.umsh.edu.al/c/231/broshura-informuese https://www.umsh.edu.al/d/278/panairi-work-and-study-universiteti-mesdhetar-kete-vit-me-programe-te-reja-studimi			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - UMSH vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi programin e studimeve, syllabuset, përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në programit të studimit. - Institucioni garanton procedurat për njohjen dhe ekuivalentimin e kualifikimeve. - Pedagogët u bëjnë të njohur dhe u vënë në dispozicion studentëve syllabusin e lëndës duke detajuar objektivat e lëndës, temat përkatëse, elementët formues të programit, mënyrën e shlyerjes si dhe literaturën përkatëse. - Faqja web e UMSH luajnë një rol të rëndësishëm në informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. - Burimet bazë të evidentuara të informimit janë rregulloret e institucionit, Rregullorja e UMSH, Rregullorja e Fakultetit të Informatikës, Rregullorja e Departamentit të Informatikës së Biznesit si dhe Rregullorja e programit të studimit. <i>GVJ sugjeron që rregulloret institucionale dhe udhëzuesit e përgatatur nga institucioni të jenë të aksesueshëm edhe online nëpërmjet faqes zyrtare të UMSH.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Gjatë takimit me studentët, GVJ konstatoi se ata janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij në fillim të vitit akademik. Një pjesë e informacioneve, si orari mësimor, struktura mësimore, datat e provimeve, konsultime, etj., janë të aksesueshme edhe nëpërmjet sistemit të menaxhimit të studentëve të UMSH, si dhe nëpërmjet klasave virtuale të krijuara nga pedagogët (Google Classroom). Departamenti i Informatikës së Biznesit cdo fillim viti akademik organizon takime informuese ku ofron informacion të përgjithshëm mbi programin e studimit, kurrikulën, lëndët, kreditet për çdo lëndë, shpërndarjen e tyre sipas semestrave, praktikat, procesin e diplomimit, etj. <i>Evidenca Nr 35: Manual i përdorimit të platformave online</i> <i>Evidenca Nr 49: Java e pare e orientimit në UMSH</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në faqen web të UMSH, studentët mund të aksesojnë online informacion të përgjithshëm mbi programin e studimit si edhe planin mësimor. Klasat virtuale të krijuara nga pedagogët e lëndëve (Google Classroom) kanë informacion të plotë në lidhje me secilën lëndë si përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese, menyrat e vlerësimit, organizimin e lëndës, literaturën, oraing, etj. Gjithashtu një informacion të plotë për lëndët dhe informacion në lidhje me organizimin e studimeve studentët e marrin në javën informuese që organizon departamenti. <i>Materiali RVB</i> <i>Evidenca Nr 35: Manual i përdorimit të platformave online</i> <i>Evidenca Nr 49: Java e pare e orientimit në UMSH</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen	Një rol të veçantë në drejtim të informimit të studentëve mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës e luan Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës. Ndër detyrat e kësaj zyre është që të drejtojë dhe mbështesë studentët gjatë procesit të formimit

institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	universitar të tyre, si dhe t'i orientojë dhe këshillojë ata me kërkesat e tregut të punës dhe mundësitë e zgjedhjeve. UMSH ka politika mbështetëse për studentët e ekselencës duke i ofruar atyre mundësi punësimi si personel akademik pranë institucionit. Në bazë të dokumentacionit të dërguar nga institucioni, Fakulteti i Informatikës organizon aktivitete të ndryshme : takime informuese nga tregu i punës, leksione të hapura nga kompani që ofrojnë internshipe për studentë, takime me qëllim orientimin e studentëve drejt ideve inovatore dhe startupeve, etj. UMSH i mundëson studentëve kryerjen e praktikave profesionale, falë bashkëpunimeve dhe partneriteteve që ka me kompanitë, institucionet publike, IAL-të brenda dhe jashtë vendit sipas programeve të studimit që ofron dhe merr pjesë në panairin Work and Study të organizuar nga MAS. Panairi Work and Study është aktivitet i përvitshëm i organizuar nga MAS. Në faqen web të UMSH pasqyrohet pjesëmarrja e UMSH në panairin Work and Study të vitit 2021, rrjedhimisht GVJ nuk mund të gjykojë nqs pjesëmarrja e UMSH në këtë aktivitet është e përvitshme apo jo. <u>Sugjerohet</u> përditësim i faqes web të UMSH me të gjitha aktivitetet ku ky institucion merr pjesë apo organizon. <i>Evidenca Nr 11: Liste e marreveshjeve te bashkepunimit</i> <i>Evidenca Nr 12: Lista e aktiviteteve organizuar nga fakultetii informatikes</i> <i>Dokumenta shtese: Nje raport ne lidhje me perfitimet nga bashkepunimet per praktikat profesionale</i> https://www.umsh.edu.al/c/183/bashkepunime-dypaleshe https://www.umsh.edu.al/d/278/panairi-work-and-study-universiteti-mesdhetar-kete-vit-me-programe-te-reja-studimi
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Studentëve të programit të studimit, nëpërmjet faqes zyrtare të UMSH, u vihet në dispozicion informacion i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Sekretaria mësimore gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në lidhje me informimin e studentëve për regjistrimet, pagesat, notat etj Në takimin informues që organizon departamenti në javën e parë të vitit akademik, studentëve u prezantohen sallat e leksioneve/seminareve, laboratorët, biblioteka fizike dhe ajo online, u jepet aksesit dhe kredencialet për login në sistemin e menaxhimit

	të studentëve dhe njihen me koordinatorin e programit dhe strukturat ndihmëse. <i>Evidenca Nr 35: Manual i përdorimit të platformave online</i> <i>Evidenca Nr 49 : Java e pare e orientimit në UMSH</i> https://www.umsh.edu.al/d/25/kalendari-akademik			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Studentët mund të aksesojnë të gjithë informacionin e nevojshëm rreth programit të studimit, vlerësimit, detyrave, orarit nëpërmjet sistemit të menaxhimit të studentëve, i cili aksesohet online dhe është lehtësisht i arritshëm edhe në distancë. <i>Evidenca Nr 10: Udhezues për përdorimin e sms-se</i> http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - Studentët e programit të studimit informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. - UMSH shpërndan informacion edhe nëpërmjet faqes zyrtare web duke informuar studentët në lidhje me programet e studimit. - Sekretaria mësimore dhe Departamenti i Informatikës së Biznesit luajnë një rol të rëndësishëm në lidhje me informimin e studentëve. - Një rol të rëndësishëm në drejtim të informimit të studentëve mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës luan dhe Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës. - Sistemi i Menaxhimit të Studentëve, ofron informacion në lidhje me programin e studimit dhe është lehtësisht i arritshëm edhe në distancë. <i>GVJ sugjeron përditësimin e faqes web të UMSH me aktivitetet aktuale ku ky institucion merr pjesë apo organizon në kuadër të promovimit të kërkimeve-shkencor dhe orientimit drejt tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																			
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	UMSH mban të dhëna statistikore vjetore per numrin e studenteve dhe të të diplomuarve. Këto të dhëna disponohen nga sekretaria mësimore e FI e cila i hedh në regjistrin e diplomimeve sipas kuadrit ligjor ne fuqi. Parelisht, këto të dhëna mund të aksesohen në bazë rolesh dhe të drejtash të përdoruesve edhe brenda sistemit SMS. GJV zhvilloi edhe një vizitë në Sekretarinë Mësimore dhe konstatoi se plotësimi i regjistrit themeltar dhe rregjistrit të lëshimit të diplomave janë në përputhje me standardet dhe udhëzimet e MAS. <i>Evidencë nga Vizita e GJV në institucion</i> <i>Evidenca Nr 50: Rregullore e sekretarise mesimore</i>																			
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Mbështetur në ligjin Nr. 80/2015 për arsimin e lartë, të dhënat e studentëve mbahen, administrohen, monitorohen dhe kontrollohen në sekretarinë mësimore. GJV ndërmori një vizitë në sekretarinë mësimore e cila administron të dhënat e studentëve që nga faza e regjistrimit deri në përfundim të studimeve. Të dhënat mbahen në formë të shkruar në tre regjistra: Regjistri themeltar i studentëve; Regjistri i arritjeve akademike; Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave. Këto të dhëna mbahen elektronikisht në Sistemin e Menaxhimit të Studentëve. Të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi sipas profileve për 2 vitet e fundit akademike paraqiten si vijon: <table><tr><th>Profili</th><th>Viti akademik</th><th>Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë</th><th>Nr. i studentëve të transferuar Viti I</th><th>Nr. i studentëve të transferuar Viti II</th></tr><tr><td rowspan="2">Inxhinieri Software</td><td>2022-2023</td><td>40</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>66</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td></td><td>2022-2023</td><td>51</td><td>-</td><td>6</td></tr></table>	Profili	Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Nr. i studentëve të transferuar Viti I	Nr. i studentëve të transferuar Viti II	Inxhinieri Software	2022-2023	40	-	-	2023-2024	66	-	-		2022-2023	51	-	6
Profili	Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Nr. i studentëve të transferuar Viti I	Nr. i studentëve të transferuar Viti II																
Inxhinieri Software	2022-2023	40	-	-																
	2023-2024	66	-	-																
	2022-2023	51	-	6																

	<table><tr><td>Sisteme Informacioni në Biznes</td><td>2023- 2024</td><td>30</td><td>-</td><td>3</td></tr></table> GVJ verifikoi edhe regjistrin e arritjeve akademike. Verifikimi u bë me të dhënat e dy studenteve të përzgjedhur në mënyrë rastësore në një procesverbal provimi me notat përkatëse të studentëve të zgjedhur të hedhur në regjistrin e arritjeve akademike. Verifikimet gjejnë një përputhje të notave dhe plotësimi i tij është në përputhje me kuadrin ligjor. <i>Evidenca Nr 50: Rregullore e sekretarise mesimore</i> <i>Evidenca Nr 10: Permbledhese e tabelave per programin</i> <i>Dokumenta shtese: Shkrese QSHA per pajisjen me rregjistrat</i>	Sisteme Informacioni në Biznes	2023- 2024	30	-	3
Sisteme Informacioni në Biznes	2023- 2024	30	-	3		
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sekretaria mësimore disponon gjithë informacionin për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Këto të dhëna disponohen edhe në format elektronik, gjë që bën që ky informacion të jetë lehtësisht i aksesueshëm. Aksesimi i të dhënave statistikore brenda sistemit SMS realizohet konform të drejtave dhe roleve të përdoruesve sipas rregulloreve institucionale dhe sipas organigramës së IAL-së duke ruajtur konfidencialitetin e të dhënave në përputhje me legjislacionin në fuqi. <i>Evidenca Nr 50: Rregullore e sekretarise mesimore</i> <i>Evidenca Nr 10: Udhezues per perdorimin e sms-se</i> http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar					
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin e të gjithë dokumentacionit (sekretaritë mësimore). Veprimtaria e sekretarisë mësimore të UMSH mbështetet në rregulloren e UMSH, rregulloren e FI dhe rregulloren e Sekretarisë Mësimore. Dokumentacioni që ruhet në Sistemin e Manaxhimit SMS është nën mbikqyrje të vazhdueshme nga specialistët e IT, duke garantuar menaxhimin e sigurt të informacionit dhe të të dhënave. Kontrolli dhe verifikimi i informacionit është lehtësisht i aksesueshëm nga personat e autorizuar në sipas roleve dhe përgjegjësive që ato kanë në institucion. Sekretaria mësimore i nënshtrohet kontrollit dy herë në vit. <i>Evidenca Nr 1: Statuti i UMSH</i> <i>Evidenca Nr 9: Rregullore e Organizimit UMSH</i>					

	<i>Evidenca Nr 5: Rregullore e Fakultetit te Informatikes</i> <i>Evidenca Nr 50: Rregullore e Sekretarise Mesimore</i> <i>Evidenca Nr 10: Udhezues per perdorimin e sms-se</i>													
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Departamenti dhe Sekretaria mësimore disponojnë informacionin mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, ndërsa Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës analizon gjendjen e punësimit të studentëve. Këta elementë janë objekt i analizave vjetore si në nivel Departamenti ashtu dhe instanca të tjera. Në përputhje me udhëzimet e MAS, të dhënat përpunohen në nivel institucional dhe një raport vjetor dorëzohet pranë MAS në fund të çdo viti akademik. Të dhënat për cilësinë në hyrje paraqiten si vijon : <table><tr><th>Profili</th><th>Viti akademik</th><th>Nota mesatare në hyrje</th></tr><tr><td rowspan="2">Inxhinieri Software</td><td>2022-2023</td><td>6.8</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>6.8</td></tr><tr><td rowspan="2">Sisteme Informacioni në Biznes</td><td>2022-2023</td><td>7</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>6.4</td></tr></table> Në lidhje me diplomimin dhe punësimin e studentëve, institucioni nuk ka paraqitur informacion, por GVJ gjykon që meqënëse programi akreditohe për herë të parë pas riorganizimit në vitin akademik 2022-2023, këto të dhëna do të jenë të disponueshme pas diplomimit dhe punësimit të brezit të parë të studentëve në këtë program studimi. Bazuar në rregulloret institucionale dhe takimet që GVJ zhvilloi me përfaqësues të Zyrës së Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës në UMSH konstatojmë që kjo zyrë gjurmon studentët dhe mban të dhëna në lidhje me studentët e diplomuar, analizon shkallën e punësimit, sektorët ku ata janë të punësuar, etj. <i>Evidenca Nr 9: Rregullore e Organizimit UMSH</i> <i>Evidenca Nr 10: Permbledhese e tabelave per programin</i>	Profili	Viti akademik	Nota mesatare në hyrje	Inxhinieri Software	2022-2023	6.8	2023-2024	6.8	Sisteme Informacioni në Biznes	2022-2023	7	2023-2024	6.4
Profili	Viti akademik	Nota mesatare në hyrje												
Inxhinieri Software	2022-2023	6.8												
	2023-2024	6.8												
Sisteme Informacioni në Biznes	2022-2023	7												
	2023-2024	6.4												
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - Sekretaria mësimore e Fakultetit të Informatikës mban statistika për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e													

	<i>studimit. Të dhënat përpunohen dhe ruhen si në format fizik, regjistrat themeltar, regjistrat e lëshimit të diplomave, ashtu dhe në format elektronik.</i> - <i>Sekretaria mësimore disponon gjithë informacionin për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</i> - <i>Departamenti dhe Sekretaria mësimore disponojnë informacionin mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, ndërsa Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës analizon gjendjen e punësimit të studentëve.</i> <i>GVJ vlerëson se UMSH mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin, profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Këto të dhëna menaxhohen me saktësi dhe kontrollohen vazhdimisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	GVJ konstatoi se UMSH ka parashikuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve (përfaqësuesve të tyre) në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. Këshillat e Studentëve (Statutin e UMSH, Neni 83 dhe Rregullore e organizimit UMSH, Kreu VIII, Neni 59) janë organizime të pavarura të studentëve të UMSH-së, të cilët nuk zhvillojnë veprimtari politike dhe ekonomike. Ato promovonë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të UMSH. Këshillat e studentëve shprehin mendime dhe propozime nëpërmjet përfaqësimit të tyre në organet drejtuese të UMSH për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të institucionit si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtari të mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera

	financiare për studentët, bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive, etj. UMSH mbështet këshillat e studentëve dhe financoi veprimtaritë e tyre. GVJ konstaton që bazuar në Statutin dhe Rregulloren e organizimit UMSH, studentët përfaqësohen në Senatin Akademik (<i>Statuti, Neni 11, Rregullore e organizimit UMSH, Neni 11.2</i>) dhe kanë të drejtë të organizohen në Këshillat Studentore (<i>Statuti, Neni 83, Rregullore e organizimit UMSH, Neni 59</i>). Në rregulloret institucionale NUK parashikohet përfaqësimi i studentëve në: - Këshillin e Etikës; (<i>Statuti - Neni 51, Rregullore e organizimit UMSH - Neni 21</i>) - Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave; (<i>Statuti - Neni 84, Rregullore e organizimit UMSH - Neni 28.3</i>), pavarësisht se në Rregulloren e NJSBCZHK parashikohet përfshirja e 1 anëtari nga radhët e studentëve. Për sa më sipër, GVJ <u>sugjeron</u> rishikimin e rregulloreve institucionale me qëllim unifikimin e informacionit. GVJ gjen të përfaqësuar studentët në Grupin e Vlerësimit të Brendshëm për këtë program studimi dhe vlerëson përkjekjen e Fakultetit të Informatikës për të përfshirë studentët në Asambleen e Personelit Akademik të Fakultetit të Informatikës, por gjykon që ky proces duhet të jetë i rregulluar dhe sanksionuar në rregulloret institucionale (Statuti dhe Rregullorja e Organizimit UMSH). GVJ vlerëson përfshirjen në faqen zyrtare web të institucionit të një rubrike të dedikuar studentëve në të cilën gjenden nënrubrika si: Këshilli Studentor, Klubet Studentore, Këshillimi i Karrierës, etj. <i>Evidenca Nr 1: Statuti i UMSH</i> <i>Evidenca Nr 9: Rregullore e organizimit UMSH</i> <i>Dokumenta shtese: Evidence mbi përfshirjen e studenteve ne strukturat vendimarrëse te institucionit</i> <i>Materiali RVB</i> https://www.umsh.edu.al/c/40/keshilli-studentor
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në	Këshilli Studentor i UMSH dhe aktivitetet e tij mbështeten financiarisht nga buxheti i UMSH. Gjithashtu studentët marrin pjesë në vlerësimin mbi procesin akademik, nëpërmjet pyetësorëve. Sipas rregulloreve të UMSH studentët shprehin vlerësimin e tyre





vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të universitetit, nëpërmjet vlerësimeve semestrale që organizohen nga njësitë e sigurimit të cilësisë. Nga takimet në institucion me studentët, këto pyetësorë realizohen përpara provimeve përfundimtare, në fund të çdo semestri dhe janë anonime duke shprehur mendimin real të tyre. <i>Evidenca Nr 51: Rregullore e keshillit studentor</i> <i>Evidenca Nr 26: Procedura e punes me fokus grupet</i> <i>Evidenca Nr 32: Formulari i vleresimit te pedagogut dhe lendes nga studenti</i> <i>Evidenca Nr 15: Rregullore e NJSBCZHK</i> https://www.umsh.edu.al/c/40/keshilli-studentor
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Pjesëmarrja e studentëve në organet vendimmarrëse të UMSH bën të mundur marrjen e mendimit të tyre për programin e studimit. Gjithashtu, nëpërmjet pyetësorëve të vlerësimit të lëndës nga studentët merret edhe mendimi për elementë që kanë të bëjnë me përmirësimin e programit të studimit. Përpunimi i të dhënave të këtij pyetësori për çdo program studimi, i cili plotësohet para provimeve, në fund të çdo semestri, shërben si bazë për përmirësime të mëtejshme. Megjithatë, për shkak se programi akreditohet për herë të parë, nuk ka patur përmirësime të dokumentuara në kurrikulën e programit të studimit. Departamenti realizon në mënyrë periodike mbledhje të hapura ku ftohen studentët të japin mendime nëpërmjet Senatorëve të tyre. <i>Evidenca Nr 51: Rregullore e keshillit studentor</i> <i>Evidenca Nr 26: Procedura e punes me fokus grupet</i> <i>Evidenca Nr 32: Formulari i vleresimit te pedagogut dhe lendes nga studenti</i> <i>Materiali RVB</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezulttit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e	Në Rregulloret e Organizimit të UMSH, Neni 62 - 67, gjejmë rregulluar: Kontrolli i Dijeve, Paraqitja në Provim, Organizimi i Provimeve, Riprovimet, Përmirësimi i Notës dhe Ankimi i Rezultatit të Provimit. Gjithashtu në Syllabuset e lëndëve janë përcaktuar qartë mënyra e vlerësimit të studentëve për vlerësimin përfundimtar. Në UMSH vlerësimi përfundimtar i çdo kursi kryhet duke u bazuar në shumën e pikëve të grumbulluara gjatë zhvillimit të kursit përmbledhur si më poshtë:

institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	<i>Forma e kontrollit të njohurive</i>	<i>Master në Informatikë me profile</i> <i>Pjesa (në %) ndaj totalit</i>
	Plotësimi i detyrimeve (laboratorë/detyra kursi)	30%
	Testime gjatë vitit	30%
	Provimi përfundimtar	40%
Në Udhezuesin për provimin përcaktohen mënyra e zhvillimit dhe të vlerësimit të provimit, por nuk janë përcaktuar rregullat e komunikimit të rezultatit dhe procesi i ankimimit. <i>GVJ sugjeron që në Udhezuesin për Provimin të përcaktohen qartë edhe rregullat e komunikimit të rezultatit dhe procedura e ankimimit për rezultatin përfundimtar të provimit.</i> <i>Evidenca Nr 9: Rregullore e organizimit UMSH</i> <i>Evidenca Nr 10: Permbledhese e tabelave për programin;</i> <i>Evidenca Nr 22: Syllabuset e lendeve të ofruara për vitin akademik</i> <i>Evidenca Nr 36: Udhezues për provimin e ndermjetem përfundimtar dhe të sezonit perserites</i>		
Konkluzione	<i>GVJ konstaton:</i> - bazuar në Statutin dhe Rregullore e organizimit UMSH, studentët përfaqësohen në Senatin Akademik - Studentët në UMSH janë të organizuar në Këshilla Studentore duke mundësuar shprehjen e mendimeve dhe paraqitjen e propozimeve për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të universitetit. - Pjesëmarrja e studentëve në disa nga organet vendimmarrëse të UMSH si dhe përpunimi i pyetësorëve të vlerësimit të lëndës nga studentët bën të mundur marrjen e mendimit të tyre për programin e studimit - Elementë të përmirësimit të programit të studimit janë integruar kryesisht në trajtën e përmirësimeve periodike të syllabuseve të lëndëve - Vlerësimi i kontrollit të dijeve, realizohet mbi bazën e procedurave të përcaktuara në rregulloret përkatëse të cilat garantojnë barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit. - Studentëve u njihet e drejta e ankimimit. <i>Sugjerohet:</i>	

	- Uniformimin e informacionit ne Rregulloren e Organizimit të UMSH me atë në Rregulloren e NJSBCZHK në lidhje me përfaqësimin e studentëve (Standardi V.5, Kriteri 1). - në Udhëzuesin për Provimin të përcaktohet qartë mënyra e komunikimit të rezultatit dhe procedura e ank0000imit të rezultatit të provimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Në UMSH funksionojnë njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve si: - Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës - Sekretaria Mësimore ZKSK mbështet Këshillin Studentor për mirëfunsonimin e tij dhe vë në dispozicion të grupeve të studentëve tutoriat dhe këshillim akademik sipas orareve të shpallura në fillim të vitit akademik. Sekretaria mësimore e FI është njësi ndihmëse në varësi të administratorit të UMSH e cila ndër të tjera koordinon punën e me fakultetet, departamentet, Zyrën e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës, Këshillin e Studentëve në mënyrë që të ndihmojë studentët në procesin mësimor. Nga Sekretaria Mësimore studentit i ofrohet informacion lidhur me: - procesin mësimor - procesin e provimeve - procesin e vlerësimit - vërtetime të ndryshme - listë notash - evente, aktivitete, konferenca, leksione të hapura, aktivitete sportive e artistike, etj.

	Sipas dokumentacionit të paraqitur nga UMSH, sekretaria mësimore e Fakultetit të Informatikës nuk është pjesë e Strukturës së Sekretarisë Mësimore, (Rregullore e Sekretarisë Mësimore, Neni 3). <i>GVJ sugjeron përditësimin e Rregullores së Sekretarisë mësimore sipas strukturës aktuale në organigramën e UMSH.</i> <i>Evidenca Nr 9: Rregullore e organizimit UMSH</i> <i>Evidenca Nr 13: Rregullore ZKSK</i> <i>Evidenca Nr 50: Rregullore e sekretarise mesimore</i> <i>Dokumenta shitese: Organigrama e miratuar a Universitetit</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Departamenti i Informatikës së biznesit, Sekretaria Mësimore dhe Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës koordinojnë punën midis tyre dhe bashkëpunojnë për të vënë në dispozicion të studentëve gjithë informacionin në lidhje me regjistrimin dhe avancimin akademik, për të mundësuar informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të tyre, asistimin e studentëve për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor, programin e studimit, punësimin dhe tregun e punës, etj. Një rol të veçantë në informimin e studentëve luan dhe faqja zyrtare e UMSH dhe Sistemi i Menaxhimit të Studentëve (SMS) në të cilën studentët pasi logohen mund të aksesojnë të dhënat e tyre personale në lidhje me avancimin akademik. <i>Evidenca Nr 13: Rregullore ZKSK</i> <i>Evidenca Nr 14: Rregullore e Departamentit ee Informatikes se Biznesit</i> <i>Evidenca Nr 50: Rregullore e Sekretarise Mesimore</i> <i>Evidenca Nr 30: Program trajnimi dhe kualifikimi</i> www.umsh.edu.al
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe	Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës (ZKSK) zhvillon procesin e këshillimit të karrierës, ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mban kontakte me të diplomuarit, krijon mundësi punësimi për studentët, organizon aktivitete ne formën e trajnimeve, seminareve, workshopeve dhe jep informacion dhe orientim për praktikën profesionale. Përveçse nga ZKSK, studentët informohen edhe nga sekretaria mësimore, por edhe nga stafi akademik I departamentit mbi: - Programet e studimit, - Akreditimin e tyre,

orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	- Organizimin dhe kohëzgjatjen e studimeve, - Kryerjen dhe ndjekjen e praktikës profesionale, - Për zgjedhjen e temës së diplomës, udhëheqësit përkatës për diplomën etj. <i>Evidenca Nr 13: Rregullore ZKSK</i> <i>Evidenca Nr 50: Rregullore e Sekretarise Mesimore</i> <i>Evidenca Nr 23: Udhezues per pergatitjen e punimit te diplomes</i> <i>Evidenca Nr 17: Lista e pedagogeve qe monitorojne praktikat profesionale</i> <i>Dokumenta shtese: Lista e pedagogeve me fushat e ekspertizes dhe temat qe i jane vene ne dispozicion studenteve</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Në UMSH, në varësi të Rektorit funksionon Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës (ZKSK) e cila bazuar në rregullore, ndër objektivat e saj ka edhe nxitjen e frymës së bashkëpunimit ndërmjet UMSH dhe ish-studentëve në mënyrë që të promovohen dhe rriten interesat e UMSH ALUMNI-t. Në këtë kuadër, ZKSK organizon cdo vit në ambientet e UMSH takimin vjetor me studentët ALUMNI në të cilin diskutohet mbi tema të ndryshme, rrëfime personale dhe eksperiencat aktuale të punës. Gjithashtu, Institucioni organizon trajnime me studentët, ALUMNI-t dhe partnerët e biznesit në lidhje me vlerësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit, përshtatjen e tyre dhe hapjen e programeve të reja. GVJ konsultoi me kujdes Rregulloren e Zyrës së Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës (ZKSK) e cila mban të dhëna për punësimet pas diplomimit dhe konstatoi që në detyrat e saj fokusi i kësaj zyre është informimi i studentëve aktuale. <i>GVJ sugjeron që Rregullorja e ZKSK të përditësohet me objektiva dhe detyra të reja në lidhje me ndjekjen e studentëve pas diplomimit, mbledhjen, përpunimin dhe mbledhjen e të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të këtj programi studimi dhe në përgjithësi të programeve të studimit që ofron UMSH.</i> <i>Dokumenta shtese: Organigrama e miratuar a Universitetit</i> <i>Evidenca Nr 13: Rregullore ZKSK</i> <i>Evidenca Nr 30: Program trajnimi dhe kualifikimi</i> <i>Dokumenta shtese: Pyetsoret qe behen per Alumnit</i>

	https://www.umsh.edu.al/d/443/universiteti-mesdhetar-i-shqiperise-mbledh-ish-studentet-zhvillohet-takimi-vjetor-alumni			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - Në UMSH funksionojnë njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve si Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës (ZKSK) dhe Sekretaria Mësimore, njësi të cilat janë shumë aktive dhe janë ndërtuar e funksionojnë në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. - Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës (ZKSK) zhvillon procesin e këshillimit të karrierës, ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mban kontakte me të diplomuarit/Rrjetin Alumni dhe krijon mundësi punësimi për studentët, organizon trajnime, seminare, workshop-e, etj. - ZKSK organizon cdo vit takimin vjetor me studentët ALUMNI në të cilin diskutohet mbi tema të ndryshme, rrëfime personale dhe eksperiencat aktuale të punës. <i>GVJ vlerëson se UMSH ka procedura e njësi të posaçme që ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</i> <i>Sugjerime:</i> - Të përditësohet Rregullorja e Sekretarisë Mësimore dhe Rregullorja e Zyrës së Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës sipas strukturës aktuale të institucionit dhe detyrave që këto njësi kryejnë në UMSH.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Fakulteti i Informatikës e zhvillon këtë program studimi në përputhje me standardet e vendosura nga UMSH dhe ato shtetërore të cilësisë, duke harmonizuar punën në auditor me punën individuale të studentit duke shfrytëzuar gjithë materialet e vëna në dispozicion nga pedagogët si dhe materialet që ofron biblioteka (fizike dhe online). GVJ vlerëson punën që ka bërë Departamenti i Informatikës së Biznesit në propozimin dhe analizën e metodave inovative në procesin e mësimdhënies në programin e studimit. DIB ka kryer një studim në lidhje vlerësimin e efektivitetit të metodave të ndryshme inovative me qëllim adaptimin e tyre në mësimdhënie në programet e studimit që ajo ofron. Si rezultat i kësaj analize, me qëllim përdorimn sa më efektiv të metodave inovative në përmirësimn e procesit të mësimdhënies, DIB ka rekomanduar përdorimin e: - mësimdhënies së bazuar në loje - sistemet e manaxhimit të informacionit - podcastet edukative GVJ mbështet këto rekomandime dhe mendon që aplikimi i tyre në të ardhmen do të përmirësojë problematika, si frekuentimi, të evidentuara nga institucioni. <i>Dokumenta shtese: Raport i departamentit ne lidhje me perdormin e metodave inovative nga stafi akademik</i> <i>Evidenca Nr 35: Manual i perdorimit te platformave online</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	DIB është përgjegjës për realizimin e procesit mësimor për programin e studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”. Kjo detyrë drejtohet nga Përgjegjësi i DIB. Në fillimin e vitit akademik, çdo anëtar i personelit akademik kryen parashikimin e ngarkesës vjetore e cila vlerësohet dhe miratohet nga përgjegjësi i Departamentit dhe Dekanati. GVJ konstaton që NJSBCZHK përgatit një plan veprimi vjetor për monitorimin e cilësisë në institucion. Konkretisht, ajo është përgjegjëse për hartimin dhe realizimin e anketimeve për matjen e

	performancës së pedagogëve në procesin mësimor, organizimin e punës me fokus grupet dhe për vlerësimin e punës me studentët. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se vlerësimi i lektorëve nga studentët realizohet 2 herë në vit, në fund të cdo semestri, para sezonit të provimeve. <i>Evidenca Nr 14: Rregullore e Departamentit ee Informatikes se Biznesit</i> <i>Evidenca Nr 15: Rregullore e NJSBCZHK</i> <i>Evidenca Nr 31: Plan veprimi NJSBCZHK</i> <i>Dokumenta shtese: Analiza mesimore kerkimore e njesise baze pergjegjese per programin e studimit</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Garantimi i përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve mundësohet nëpërmjet pyetësorit të vlerësimit të lektorëve të lëndëve të programit të studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”. Ky pyetësor plotësohet në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve. Pyetësori është anonim dhe gjithë procesi drejtohet dhe monitorohet nga NJSBCZHK. <i>Studentëve u njihet e drejta e ankimimit, por procedura e ndjekur për procesin e ankimimit nuk është e parashikuar në rregulloren institucionale (Shiko Standardi V.5, Kriteri 4).</i> NJSBCZHK harton një raport vjetor të punës së saj i cili i paraqitet Komisionit të përhershëm dhe një kopje e tij përcillet për dijeni dhe informim në Dekanat dhe miratohet në Senatin Akademik. <i>Evidenca Nr 15: Rregullore e NJSBCZHK</i> <i>Evidenca Nr 32: Formulari i vleresimit te pedagogut dhe lendes nga studenti</i> <i>Evidenca Nr 33 Formular i vleresimit te pedagogut nga autoriteti drejtues</i> <i>Dokumenta shtese: Raport permbledhes nga NJSBC i rezultateve te pyetesoreve</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Përpunimi i anketimeve dhe vlerësimi i pedagogëve sipas qëllimit të anketimit shoqërohet me një raport. Materialet e anketimeve i vihen në dispozicion: Njësisë Kryesore, Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Rektoratit (sipas Rregullore për Organizimin e Standardeve të Cilësisë, Neni 14). Bazuar në këto rezultate dekanati vlerëson punën e cdo pedagogu dhe në rast problematike zhvillon diskutime për zgjidhjen dhe përmirësimin e tyre.

	GVJ sugjeron që institucioni të parashikojë në procedurë edhe informimin e stafit akademik në lidhje me rezultatet e pyetësorit. Për ruajtjen e konfidencialitetit informimi mund të realizohet me email. <i>Evidenca Nr 15: Rregullore e NJSBCZHK</i> <i>Evidenca Nr 52: Rregullore për organizimin dhe punën e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilesise Dokumenta shtese: Raport përmbledhes nga NJSBC i rezultateve të pyetesoreve</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	NJSBCZHK luan një rol të rëndësishëm në promovimin e shembujve të praktikave të mira, nxitjen dhe inkurajimin e personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies. NJSBCZHK përgatit një plan veprimi vjetor për monitorimin e cilësisë në institucion ku parashikon kontakte të vazhdueshme me drejtuesit e njësive bazë, monitorimin e procesit mësimor, të syllabuseve, zhvillimit të provimeve, praktikave, diplomave, etj. Ajo njofton zyrtarisht drejtuesit e institucionit për rezultatet përfundimtare të monitorimit të cilësisë dhe rezultateve të pyetësorëve. Këta të fundit, nga ana e tyre marrin masa të promovojnë dhe nxisin personelin akademik në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë. <i>Evidenca Nr 15: Rregullore e NJSBCZHK</i> <i>Evidenca Nr 31: Plan veprimi NJSBCZHK</i> <i>Evidenca Nr 20: Raport Vjetor i UMSH</i> <i>Evidenca Nr 52: Rregullore për organizimin dhe punën e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilesise</i> <i>Evidenca Nr 26: Procedura e punës me fokus grupet</i> <i>Evidenca Nr 32: Formulari i vlerësimit të pedagogut dhe lëndës nga studenti</i> <i>Evidenca Nr 33 Formular i vlerësimit të pedagogut nga autoriteti drejtues</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se: - <i>Fakulteti i Informatikës e zhvillon programin e studimit Master i Shkencave në Informatikë me profile: "Inxhinieri Software" dhe "Sisteme Informacioni në Biznes" në përputhje me standardet e vendosura nga UMSH dhe ato shtetërore të cilësisë.</i>

	- NJSBCZHK drejton në nivel institucioni punën për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. - Pyetësorët e vlerësimit të lektorëve të lëndëve të programit të studimit Master i Shkencave në Informatikë me profile: "Inxhinieri Software" dhe "Sisteme Informacioni në Biznes" mundësojnë garantimin e përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve. - NJSBCZHK njofton autoritetet drejtuese të UMSH në lidhje me rezultatet e pyetësorëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. <u>Rekomandojmë</u> që institucioni të parashikojë në rregulloret e saj edhe një procedurë për informimin e stafit akademik në lidhje me rezultatet e pyetësorit. Për ruajtjen e konfidencialitetit informimi mund të realizohet me email.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Strukturat përgjegjëse në nivel institucional për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë në UMSH është Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK) e cila është në varësi të Rektorit. Bazuar në Statutin e UMSH (neni 53), NJSBCZHK konsiderohet si organ ndihmës në funksion të realizimit të procesit mësimor dhe kërkimit shkencor. Detyrat dhe përgjegjësitë e NJSBCZHK përcaktohen në rregulloren e saj. GVJ konstaton se këto struktura janë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. <i>Evidenca Nr 1: Statuti i UMSH</i> <i>Evidenca Nr 15: Rregullore e NJSBCZHK</i> <i>Evidenca Nr 52: Rregullore për organizimin dhe punën e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë</i>

Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Në nivel institucional, NJSBCZHK, përbëhet nga 9 anëtarë personel akademik me kohë të plotë ose ndihmës akademik dhe 1 anëtar student i një prej degëve të studimit në UMSH. NJSBCZHK monitoron cilësinë e zhvillimit të procesit mësimor, të syllabuseve, zhvillimit të provimeve, praktikave, diplomave, etj. Ajo në themel të punës së saj ka zbatimin e strategjisë institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë të cilin e realizon nëpërmjet mbikëqyrjes së proceseve të vlerësimit të brendshëm <i>Evidenca Nr 15: Rregullore e NJSBCZHK</i> <i>Evidenca Nr 52: Rregullore për organizimin dhe punën e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë</i> <i>Evidenca Nr 31: Plan veprimi NJSBCZHK</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Akreditimi i jashtëm kryhet periodikisht në UMSH. Institucionit i është akredituar institucionalisht me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 62, datë 18.12.2020, deri më 17.12.2026, por për herë të fundit, me Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 54, datë 13.01.2024 me një kohëzgjatje 2 vite u akreditua pjesërisht për fakultetin e ri. Vlerësimi i jashtëm i programit të studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”, me qëllim akreditimin e tij, po realizohet për herë të parë nga ASCAL. <i>Vendim BA Nr. 54, datë 13.01.2024</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Në nivel institucioni puna për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik drejtohet nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK), e cila shprehet qartë në Nenin 9 të Rregullores së NJSBCZHK, “Planifikimi dhe organizimi i vlerësimit të brendshëm”. Në mënyrë periodike, NJSBCZHK zhvillon pyetësorë me studentët me qëllim vlerësimin e procesit akademik dhe aspekteve të tjera që lidhen me institucionin: - Vlerësimit të stafit akademik nga studentët - Vetevlerësimi i stafit akademik për cilësinë e mësimdhënies, studentët dhe aktivitetin kërkimor-shkencor

	NJSBCZHK është pjesë aktive në të gjitha aktivitetet e Institucionit duke qenë nxitëse dhe garantuese e standardeve të cilësisë mes gjithë aktorëve të brendshëm të tij. <i>Evidenca Nr 15: Rregullore e NJSBCZHK</i> <i>Evidenca Nr 52: Rregullore për organizimin dhe punën e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë</i> <i>Evidenca Nr 26: Procedura e punës me fokus grupet</i> <i>Evidenca Nr 31: Plan veprimi NJSBCZHK</i> <i>Evidenca Nr 32: Formulari i vlerësimit të pedagogut dhe lëndës nga studenti</i> <i>Evidenca Nr 33 Formulari i vlerësimit të pedagogut nga autoriteti drejtues</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Në UMSH, Sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, garantohej nëpërmjet strukturave të ngritura në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. - NJSBCZHK funksionon në nivel institucioni, në UMSH. - NJSBCZHK monitoron cilësinë e zhvillimit të procesit mësimor dhe mbikëqyr proceset e vlerësimit të brendshëm. - Në mënyrë periodike, NJSBCZHK zhvillon pyetësorë me studentët dhe mbledh të dhënat nga formulari i vetëvlerësimit të stafit akademik me qëllim vlerësimin e procesit mësimor, kërkimor-shkencor dhe aspekteve të tjera që lidhen me institucionin. - NJSBCZHK është pjesë aktive në të gjitha aktivitetet e Institucionit duke qenë nxitëse dhe garantuese e standardeve të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor	Mbikëqyrja periodike e programit të studimit Master i Shkencave në "Informatikë", me profile "Sistemet e Informacionit në Biznes"

mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	dhe “Inxhinieri Software” bazohet në marrjen e informacionit nëpërmjet pyetësorëve që plotësohen në fund të çdo semestri përpara zhvillimit të provimit përfundimtar. Pyetësorët i kushtohen vlerësimit të lëndëve të programit të studimit dhe personelit akademik. Departamenti i Informatikës së Biznesit shqyrton veprimtarinë mësimore duke kryer analiza vjetore të realizimit të procesit mësimor, punës administrative dhe asaj kërkimore shkencore në të cilat shqyrtohen problematikat e hasura dhe hapat në drejtim të përmirësimit. Të gjitha udhëzimet dhe standardet e përcaktuara në aktet përkatëse ligjore e nënligjore ndiqen dhe zbatohen. <i>Evidenca Nr 20: Raport Vjetor i UMSH</i> <i>Dokumenta shtese: Raport permbledhes nga NJSBC i rezultateve te pyetesoreve</i> <i>Dokumenta shtese: Analiza mesimore kerkimore e njesise baze pergjegjese per programin e studimit</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	NJSBCZHK operon në mënyrë të pavarur për vlerësimin dhe monitorimin e proceseve të ndryshme duke respektuar planveprimin vjetor të miratuar nga Rektori në fillim të vitit akademik. Rektorati dhe drejtuesit e njësive bazë njoftohen me email përpara cdo fillimi të një procesi monitorimi. Raportet e vlerësimit bazohen në kontaktet e vazhdueshme me drejtuesit e njësive bazë dhe përfshijnë monitorimin e procesit mësimor, të syllabuseve, zhvillimit të provimeve, praktikave, diplomave, etj. NJSBCZHK njofton zyrtarisht drejtuesit e institucionit për rezultatet përfundimtare të monitorimit të cilësisë dhe rezultateve të pyetësorëve. Institucioni ka paraqitur si evidencë Strategjinë e Zhvillimit të këtij programi studimi i cili është i bazuar në rezultatet e monitorimit të cilësisë ku parashikohet plani i masave për përmirësim afatshkurtra dhe afatmesme. <i>Evidenca Nr 20: Raport Vjetor i UMSH</i> <i>Evidenca Nr 31: Plan veprimi NJSBCZHK</i> <i>Evidenca Nr 4: Strategjia e zhvillimit te programit Master Shkencor ne Informatike me profile</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e	Në UMSH përdoren mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit. Monitorimi i realizimit

cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	me korrektësi të programit studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software” realizohet në mënyrë të vazhdueshme nga NJSBCZHC. Bazuar në Raportin e Vjetor Institucional, NJSBCZHC në bashkepunim me Departamentin e Informatikës së Biznesit ka ndërtuar dhe zhvilluar programin SEMESTRAL për monitorimin e zhvillimit të mësimi. Sipas planit të punës së miratuar, në një orë mësimore të caktuar ka patur përfaqësues nga Departamenti dhe NJSBCZHC. Ata kanë plotësuar dhe dorëzuar një formular vlerësimi për cdo pedagog dhe lëndë. <i>Evidenca Nr 20: Raport Vjetor i UMSH</i> <i>Evidenca Nr 52: Rregullore per organizimin dhe punen e Komisionit te Perhershëm per Sigurimin e Standardeve te Cilesise</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.	Studentët në UMSH janë pjesëmarrës aktivë në vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit. Mendimi i tyre merret nëpërmjet: - Këshillit Studentor - përfshirjes në procesin e vlerësimit të programeve të studimeve (GVB ka një anëtar student) - këshillimit me stafin akademik dhe përgjegjësen e departamentit si edhe përdorimit të zyrave mbështetëse për këtë qëllim. - Përfaqësuesit të studentëve në NJSBCZHC - Pjesëmarrjes në Senatin Akademik Në procesin e vlerësimit kontribuojnë zhvillimi i anketimeve nëpërmjet pyetësoreve të studentëve, takimet me fokus grupet, pyetësoreve të zhvilluar me ALUMNI-t, mbledhjes së të dhënave nga sekretaria mësimore në lidhje me rezultatet e provimeve, kalueshmërinë, notën mesatare etj., gjurmimit të studentëve të diplomuar, etj. Evidencat e paraqitura dëshmojnë për përdorimin e metodave dhe instrumenteve të tërthorta të vlerësimit në institucion. <i>Evidenca Nr 1: Statuti i UMSH</i> <i>Evidenca Nr 52: Rregullore per organizimin dhe punen e Komisionit te Perhershëm per Sigurimin e Standardeve te Cilesise</i>

	<i>Evidenca Nr 32: Formulari i vleresimit te pedagogut dhe lendes nga studenti</i> <i>Evidenca Nr 26: Procedura e punes me fokus grupet</i> <i>Dokumenta shtese: Pyetsoret qe behen per Alumnit</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - Në UMSH ndiqen dhe zbatohen të gjitha udhëzimet dhe standardet e përcaktuara në aktet përkatëse ligjore e nënligjore për mbikëqyrjen periodike të programit të studimit Master i Shkencave në Informatikë me profile: "Inxhinieri Software" dhe "Sisteme Informacioni në Biznes". - Raportet e vetëvlerësimit, në të cilët jepet një tablllo e rezultateve të vlerësimit për vitin përkatës akademik hartohen në nivel institucioni. - Evidencat e paraqitura dëshmojnë për përdorimin e metodave dhe instrumenteve të drejtpërdrejta të vlerësimit në institucion.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Në UMSH, sigurimi i brendshëm i cilësisë menaxhohet nga NJSBCZHC, aktiviteti i së cilës synon përfshirjen e një numri sa më të madh aktorësh të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Në kuadër të përmirësimit të cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në "Informatikë", me profile "Sistemet e Informacionit në Biznes" dhe "Inxhinieri Software", në planin strategjik të programit të studimit synohet dhe bashkëpunimi me institucione private dhe publike të arsimit të lartë për të krijuar një dialog kombëtar për mësimdhënie dhe mësimnxënie si edhe bashkëpunimi institucional dhe shkmbimi i eksperiencës me universitete të huaja. Këto objektiva strategjike synojnë përmirësimin e cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në "Informatikë", me profile "Sistemet e Informacionit në Biznes" dhe "Inxhinieri Software" dhe përshtatje të vazhdueshme me kërkesat e tregut të punës.

	<i>Evidenca Nr 4: Strategjia e zhvillimit te programit Master Shkencor ne Informatike me profile</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Rregullorja e NJSBCZHC përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Rregullorja synon përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke përmbushur, çdo shërbim që lidhet me standardet e cilësisë pranë UMSH, si dhe në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të lartë. <i>Evidenca Nr 52: Rregullore per organizimin dhe punen e Komisionit te Perhershëm per Sigurimin e Standardeve te Cilesise</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademi e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	UMSH garanton një proces gjithëpërfshirës në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”. Nga takimet në institucion, u konstatua se ka patur një koordinim të mirë të të gjithë instancave drejtuese dhe pjesëmarrje aktive të stafit akademik, studentëve etj. për të mundësuar një vlerësim real të programit të studimit me qëllim jo vetëm përmbushjen e detyrimit ligjor, por edhe për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së programit. Në përmirësimin e cilësisë së programit një rol të rëndësishëm luajnë dhe pyetësorët e studentëve, puna me fokus grupet si dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të studentëve në instanca të ndryshme konsultative e vendimmarrëse. <i>Evidenca Nr 4: Strategjia e zhvillimit te programit Master Shkencor ne Informatike me profile</i> <i>Evidenca Nr 20: Raport Vjetor i UMSH</i> <i>Evidenca Nr 32: Formulari i vleresimit te pedagogut dhe lendes nga studenti</i> <i>Evidenca Nr 26: Procedura e punes me fokus grupet</i> <i>Evidenca Nr 52: Rregullore per organizimin dhe punen e Komisionit te Perhershëm per Sigurimin e Standardeve te Cilesise</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo	Në veprimtarinë e saj me qëllim sigurimin e brendshëm të cilësisë, NJSBCZHC mbështetet edhe nga institucioni, Fakulteti i Informatikës dhe Departamenti i Informatikës së Biznesit. Në punën e saj NJSBCZHC zbaton gjithmonë parimin e ruajtjes së integritetit akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie. GJVJ nuk gjeti praktika të prekjes së integritetit apo

pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	ankimimit në lidhje me procesin në përgjithësi si dhe në anketimet e kryera në veçanti. <i>Evidenca Nr 2: Kodi i Etikes</i> <i>Evidenca Nr 52: Rregullore per organizimin dhe punen e Komisionit te Perhershëm per Sigurimin e Standardeve te Cilesise Takime në institucion</i>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Programi i studimit Master i Shkencave në Informatikë me profile: “Inxhinieri Software” dhe “Sisteme Informacioni në Biznes” zbatohet në bashkëpunim të ngushtë me bizneset. Për të siguruar vlerësime sa më të besueshme, të pavarura dhe profesionale, UMSH në bashkëpunim me NJSBCZHC, ka zhvilluar takime në institucion, ku ka përfshirë, studentë, ALUMNI dhe partnerë biznesi me qëllim vlerësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit, përshtatjen e tyre me kërkesat e tregut të punës dhe hapjen e programeve të reja. <i>Evidenca Nr 12: Lista e Aktiviteteve Organizuar nga Fakulteti i Informatikes</i> <i>Evidenca Nr 30: Program trajnimi dhe kualifikimi</i> <i>Evidenca Nr 11: Liste e marreveshjeve te bashkepunimit</i> <i>Evidenca Nr 24: Analiza e tregut te punes</i>			
Konkluzione	GVJ konstatos se: - Në UMSH, sigurimi i brendshëm i cilësisë menaxhohet nga NJSBCZHC, e cila synon përfshirjen e një numri sa më të madh aktorësh të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. - Ka një koordinim të mirë të të gjithë instancave drejtuese dhe pjesëmarrje aktive të stafit akademik, studentëve etj. për të mundësuar një vlerësim real të programit të studimit dhe për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së programit. - NJSBCZHC zbaton gjithmonë parimin e ruajtjes së integritetit akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	UMSH përdor komunikimin me email për të informuar studentët në lidhje me rezultatet e pyetësorëve dhe anketimeve të zhvilluara nga NJBSCZHC, organizimin, strategjitë, politikat dhe veprimtaritë e organizuara në kuadër të përmirësimit të cilësisë. Në faqen zyrtare web të UMSH gjenden informacion në lidhje me Zyrën e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë, dhe raporteve vjetore që ajo përgatit. https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise https://www.umsh.edu.al/media/6554a2bd64859.pdf
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Departamenti i Informatikës së Biznesit informohet për rezultatet e pyetësorëve të studentëve të stafit të angazhuar pranë tij. Stafi akademik i Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software” vihet në dijeni për rezultatet e pyetësorit të studentëve nëpërmjet përgjegjësit të departamentit. GVJ konstaton se informacionet e publikuara në faqen web të institucionit respektojnë lirinë akademike si edhe ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, ndryshuar me ligjin nr.48/2012 dhe ligjin nr.120/2014 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, duke garantuar ruajtjen e konfidencialitetit. https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise Dokumenta shtese: Raport permbledhes nga NJSBC i rezultateve te pyetesoreve
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Në rastet kur procesi i anketimeve me studentët dhe në përgjithësi procesi i sigurimit të cilësisë evidenton mangësi dhe dobësi, institucioni harton një plan masash konkrete për përmirësimin e tyre. Nëse ka nevojë për mbështetje financiare, njësitë bazë mbështeten financiarisht nga të ardhurat e UMSH, të ardhurat nga projektet dhe nga bashkëpunimi me bizneset. Evidencë nga Vizita e GVJ në institucion Evidenca Nr 20: Raport Vjetor i UMSH Dokumenta shtese: Evidence te financimit te kerkimit shkencor nga institucioni

	<i>Dokumenta shtese: Analiza mesimore kerkimore e njesise baze pergjegjese per programin e studimit</i>
Kriteri 4. Institucioni vlereson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Nga ana e UMSH, GVJ konstaton përpjekje në lidhje me efektivitetin e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në programin e studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software”. Angazhimi i të gjithë hallkave në këtë proces është shprehje e qartë e vëmendjes që UMSH i jep këtij procesi. <i>Evidencë nga Vizita e GVJ në institucion</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Hartimi i RVB për programin e studimit Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software” dhe grumbullimi i informacionit në mbështetje të tij ka qenë një proces në të cilin është angazhuar jo vetëm GVB, por edhe gjithë instancat drejtuese të UMSH dhe FI, DIB si dhe studentët nëpërmjet përfaqësuesit të tyre. Ky proces kontribuon në informimin dhe ndërgjegjësimin e të gjithë aktorëve të programit të studimit për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së tij. Procesi i realizimit të pyetësorëve kontribuon në informimin dhe ndërgjegjësimin e studentëve për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Ndikim pozitiv në këtë drejtim ka dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të studentëve në instanca të ndryshme vendimmarrëse e konsultative (Senat dhe NJSBCZHC) në të cilat diskutohen problematika që kanë lidhje me përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit. Institucioni ka paraqitur planin vjetor të aktiviteteve të NJSBCZHC në të cilin evidentohet që NJSBCZHC ndër të tjea ka në axhendë: – zhvillimin e trajnimeve për stafin akademik me qëllim ruajtjen e standardeve të cilësisë – monitorimin e mbledhjeve të hapura të studentëve me departamentin. <i>Evidencë nga Vizita e GVJ në institucion</i> <i>Evidenca Nr 31: Plan veprimi NJSBCZHC</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - Publikimi i rezultateve të veprimtarive në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit Master i Shkencave në Informatikë me profile: “Inxhinieri Software” dhe “Sisteme Informacioni në Biznes” siguron transparencën e këtyre veprimtarive. Transparenca e tyre

	<i>sigurohet nëpërmjet informacionit të publikuar në faqen zyrtare të UMSH në lidhje me rolin e Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe raporteve vjetore që ajo përgatit.</i> - <i>informimit me email të rezultateve në trajtën e raporteve dhe vlerësimeve si dhe nëpërmjet publikimit në faqen web të institucionit të rezultateve të raporteve vjetore.</i> - <i>Stafi akademik i programit vihet në dijeni individualisht për pyetësonin në lidhje me performancën e tij ndërsa DIB informohet për rezultatet e të gjithë stafit të angazhuar pranë tij. Informacioni me rezultatet e vlerësimeve respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</i> <i>Grumbullimi i informacionit në mbështetje të hartimit të RVB, anketimet me studentët dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të studentëve në instanca të ndryshme vendimmarrëse e konsultative mundësojnë evidentimin e pikave të forta, problematikave, kërcënimeve dhe kontribuon në informimin dhe ndërgjegjësimin e të gjithë aktorëve të programit të studimit për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Informatikë”, me profile “Sistemet e Informacionit në Biznes” dhe “Inxhinieri Software” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Fakulteti i Informatikës dhe Departamenti i Informatikës së Biznesit, organizojnë këtë program studimi me angazhimin e një stafi të përkushtuar në përçimin e dijeve.
2. Kërkesa nga të rinjtë për këtë program studimi është e lartë. Kjo vihet re nga numri i lartë dhe i qëndrueshëm i studentëve të regjistruar në këtë program studimi.
3. Në mbështetje të Strategjisë së Ndërkombëtarizimit të UMSH, ku përcaktohet si prioritet ndërkombëtarizimi, institucioni ka krijuar bashkëpunime me kompani për krijimin e programeve të praktikës profesionale, zhvillimin e projekteve të përbashkëta dhe sigurimin e mundësive të punësimit për studentët dhe partneritete me institucione akademike dhe kërkimore si shkëmbimin e njohurive, organizimin e konferencave të përbashkëta apo mundësi për studime të avancuara dhe projekte kërkimore.
4. Lëndët në tërësi, plani mësimor dhe organizimi i tij, janë në përputhje me objektivat formuese të studentëve për këtë cikël studimesh dhe të ngjashme me ato të ofruara nga IAL të tjera.
5. Komunikim student-pedagog, student-institucion është shumë i mirë.
6. Institucioni mbështet organizimin e studentëve në Këshilla studentorë.
7. Personeli akademik mbështetet financiarisht nga IAL në rritjen e tyre akademike dhe profesionale.
8. UMSH ka funksionale mekanizma të brendshëm të monitorimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë ku përfshihen edhe studentët.
9. UMSH administron informacionin e duhur për studentët, stafin akademik dhe personelin administrativ përmes një sistemi menaxhimi elektronik me anë të të cilit ndjek ecurinë e studentëve që nga regjistrimi deri në diplomim.
10. Për të shmangur plagjiaturën në projektet apo tezat e diplomave bachelor e master, institucioni përdor softuerin Turnitit.

Pika të dobta:

1. Mungesa e orëve laboratorike të matshme në kredite/orë në auditor në planin mësimor dhe në syllabuset e lëndëve. *(Standardi II.1, Kriteri 1)*



2. Mungesa e literaturës së viteve të fundit dhe e punimeve shkencore të përbashkëta midis stafit akademik dhe studenteve të masterit shkencor. *(Standardi II.4, Kriteri 5)*
3. Ndryshimet në disa nga njësitë administrative të IAL nuk janë të pasqyruara dhe unifikuara në Rregulloret institucionale. *(Standardi V.5, Kriteri 1 , Standardi V.6, Kriteri 1)*
4. Numër i lartë i studentëve në grupet e seminareve. *(Standardi IV.2, Kriteri 1)*

Rekomandime:

1. Të përcaktohet ngarkesa e veprimtarive Laboratorë/Projekte/Praktikë në planin mësimor dhe të reflektohet në syllabuset e lëndëve të paktën në lëndët karakterizuese;
2. Roli dhe detyrat e stafit ndihmës akademik (laborant) të bazohen në Statutin e UMSH, Neni 59 dhe Rregulloren e Programit të Studimit, Neni 11.
3. Të përditësohen dhe unifikohen rregulloret institucionale dhe të shënohet në secilën rregullore edhe data e miratimit në senatin akademik.
4. Për zhvillimin e orëve të seminareve dhe laboratorëve studentët të ndahen në grupe më të vogla duke respektuar kapacitetin e laboratoreve, VKM nr. 41, Datë 24.1.2018 Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë (Ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18.12.2019; nr. 185, datë 25.3.2021) dhe rregulloret e brendshme të UMSH.
5. Të përditësohen syllabuset specifikisht duke cilësuar/plotësuar: vitin akademik për të cilin syllabusi është miratuar; programin e studimit dhe profilin përkatës ku jepet lënda; ngarkesën në orë laboratorike në përputhje me planin mësimor; temat javore me orët përkatëse në cdo javë sipas ndarjes në leksione, seminare, laboratore dhe detyra kursi.
6. Të përditësohet literatura e rekomanduar në syllabus-et e lëndëve me botime të viteve të fundit dhe të pasurohet biblioteka me këto tituj.
7. Të nxitet bashkëpunimi i studentëve me stafin akademik për pjesëmarrjen e tyre të përbashkët në konferenca, projekte apo publikime në revista.
8. Institucioni të përcaktojë rregullat e komunikimit të notës, të ankimimit për shkelje të rregullave të provimit dhe procedura e ankimimit për rezultatin përfundimtar.
9. Faqja web zyrtare të pasurohet me informacione të përditësuara në të dy gjuhë dhe lehtësisht të aksesueshme si: rregulloret institucionale, udhëzuesit, bibliotekën, kriteret e pranimeve/ kuotave/ transferimeve për cdo program studimi, etj.

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Science in "Informatics", with profiles "Business Information Systems" and "Software Engineering" provided by the "Mediterranean University of Albania"

Strengths and affirmations

1. The Faculty of Informatics and the Department of Business Informatics organises this study program with the commitment of a dedicated staff passionately committed to sharing knowledge.
2. The study program is in high demand among young people, as reflected in the consistently large number of enrolled students.
3. In support of the Internationalization Strategy of the Mediterranean University of Albania, which prioritizes internationalization, the institution has established collaborations with companies to create professional internship programs, develop joint projects, and ensure employment opportunities for students, as well as partnerships with academic and research institutions for knowledge exchange, organization of joint conferences, or opportunities for advanced studies and research projects.
4. The subjects, the curriculum, and the organization of the study program are in line with the formative objectives for this cycle of studies and are similar to those offered by other Higher Education Institutions (HEIs).
5. Good communication between students and faculty, as well as between students and the institution.
6. The institution supports the organization of students in student councils.
7. Academic staff are financially supported by the HEI in their academic and professional development.
8. Mediterranean University of Albania has established effective internal mechanisms for monitoring and continuously improving quality, which also incorporate student involvement.
9. The Mediterranean University of Albania manages the necessary information for students, academic staff, and administrative personnel through an electronic management system that tracks the progress of students from enrollment to graduation.
10. The institution uses Tunitin software to avoid plagiarism in bachelor's and master's thesis projects.

Weaknesses

1. The lack of measurable laboratory hours in credits/teaching hours in the curriculum and in the course syllabuses. (*Standard II.1, Criterion 1*)
2. The lack of recent literature and of joint scientific papers between academic staff and master's students. (*Standard II.4, Criterion 5*)

3. Changes in some administrative units of the HEI are not reflected or unified in institutional regulations. *(Standard V.5, Criterion 1, Standard V.6, Criterion 1)*
4. High number of students in seminar activities. *(Standard IV.2, Criterion 1)*

Recommendations

1. The workload for Laboratory/Projects/Internship activities should be defined in the curriculum and reflected in the course syllabus, at least for core courses.
2. The roles and duties of the academic support staff should be based on the Statute of the Mediterranean University of Albania, Article 59, and the Regulation of the Study Program, Article 11.
3. Institutional regulations should be updated and unified, with the approval date noted in each regulation.
4. For the proper implementation of seminar and laboratory hours, students should be divided into smaller groups, respecting the capacity of the laboratories, in accordance with Decision No. 41, dated 24.1.2018, on the elements of study programs offered by higher education institutions (amended by Decision No. 879, dated 18.12.2019; No. 185, dated 25.3.2021) and Mediterranean University of Albania's, internal regulations.
5. The syllabi should be updated specifically by indicating the academic year for which the syllabus was approved; clarifying the study program and the relevant profile where the course is offered; completing the laboratory hours in line with the curriculum; and completing weekly topics with the corresponding hours for each week according to the division into lectures, seminars, laboratories, and course assignments.
6. The recommended literature in the course syllabi should be updated with publications from recent years and these titles should be added to enrich the library's collection.
7. Collaboration between students and academic staff should be encouraged, as well as their joint participation in conferences, projects, or publications in journals.
8. The institution should define rules for publishing grades to students, appeals related to exam rule violations and the procedure for appealing results.
9. The official website should be enhanced with regularly updated and easily accessible information, such as institutional regulations, guides, the library, admission criteria/quotas/transfers for each study program, etc.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

